



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 18. 4. 2012**

TRANSKRIPT

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE 18. 04. 2012.
GODINE**

**PRILL – APRIL
2012**

Mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit i zhvilloi punimet me këtë

Rend të ditës:

- Debat parlamentar lidhur me gjendjen në veri të Kosovës.

Vanredna sednica Skupštine radila je sa sledecim

Dnevni redom:

- Parlamentarna debata u vezi sa stanjem na severu Kosova.

E mërkurë, më 18. 4. 2012

Drejton seancën kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,

I hap punimet e mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, me kërkesën e mbi 40 deputetëve, sipas rendit të ditës të miratuar nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare.

Prezentë në sallë janë 83 deputetë, do të thotë mund t'ia fillojmë punës.

Fillojmë me pikën e parë dhe të vetme të rendit të ditës:

Debat parlamentar lidhur me gjendjen në veri të Kosovës

Në bazë të nenit 38, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, grupi prej 40 deputetësh- nënshkrues, ka parashtruar në Kuvend, kërkesën për mbledhje të jashtëzakonshme për të debatuar lidhur me gjendjen në veri të Kosovës.

Ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputetin Adem Grabovci, që në emër të nënshkruesve të arsyetojë kërkesën për debat. Deputet e ke fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeverisës,

Kolegë të nderuar,

Në bazë të nenit 69.4 e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 38.2. (c) të Rregullores së Kuvendit, ne deputetët e nënshkruar kërkojmë që Kuvendi të mbajë seancë të jashtëzakonshme, të mërkurën, pra sot më datën 18 prill 2012, në orën 14:00.

A r s y e t i m

Situata në veri të vendit tani e 13 vjet ka qenë e rënduar. Sulmi kriminal mbi familjen Haradinaj është edhe një goditje e re ndaj shtetit të Kosovës, ndaj demokracisë dhe ndaj parimit të lirisë dhe të drejtave të njeriut.

Situata në veri po kërcënon dhe cenon rendin ligjor dhe kushtetues të Kosovës e pa dyshim kjo godet rënd edhe autoritetin ndërkombëtar në Kosovë.

Andaj, kërkojmë që sot të debatohet në këtë seancë të jashtëzakonshme për hapat e mëtutjeshëm të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe mekanizmave të sigurisë ndërkombëtare, që gjendja e sigurisë në veri të vendit të futet nën kontroll për t'i siguruar qytetarët tanë, pa dallim etnie, të cilët jetojnë në këtë pjesë të Republikës së Kosovës.

Propozim në cilësinë e propozuesve të seancës së jashtëzakonshme, pas debatit, në bashkëpunim me shefat e grupeve, do ta harmonizojmë tekstin me rekomandime të cilat në fund të seancës do të adresohen për votim dhe miratim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Qeverisë, fjalën e ka ministri i Punëve të Brendshme, zoti Bajram Rexhepi.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Faleminderit!

I nderuar kryetar i Parlamentit,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Situata e përgjithshme e sigurisë në Republikën e Kosovës vlerësohet e qetë, me përjashtim të veriut të vendit, ku situata e përgjithshme mbetet e tensionuar nga aspekti politik dhe i sigurisë. Si do qoftë, përkundër tensionimit të situatës si rezultat i veprimeve të grupeve të organizuara kriminale serbe, në mbështetjen e strukturave ilegale, në pjesën veriore të vendit gjendja po mbahet nën kontroll të institucioneve përgjegjëse të sigurisë si Policia e Kosovës, EULEX-si dhe KFOR-i, të cilët janë angazhuar në ruajtjen e rendit publik dhe mbrojtjes së jetës dhe pronës së qytetarëve në atë pjesë të vendit.

Pa dyshim se përgjegjësi i drejtpërdrejtë për tensionimin e fundit të situatës në veriun e vendit janë institucionet e Serbisë, e cila e kapluar nga ethet zgjedhore po dëshmon edhe një herë orientimin dhe mentalitetin agresor të shtetit serb ndaj Republikës së Kosovës, përmes veprimeve joligjore dhe politike si kidnapimi i dy zyrtarëve policorë të Policisë së Kosovës brenda territorit të Republikës së Kosovës, arrestimi i katër qytetarëve të Republikës së Kosovës, moszbatimi i marrëveshjeve të arritura në Bruksel e të tjera, të nxitura nga ministri i Punëve të Brendshme të Serbisë, i cili me plot fanatizëm po dëshmohet si trashëgimtar i politikës agresore të Millosheviqit.

Tensionimit të situatës po i kontribuojnë edhe vizitat e liderëve politikë serbë nga Beogradi të cilët përmes rrugëve alternative po hyjnë ilegalisht në territorin e Republikës së Kosovës, për të zhvilluar fushatën elektorale në pjesën veriore të vendit.

Është obligim i KFOR-it që t'i mbyllë të gjitha rrugët alternative të vijës së gjelbër të kufirit mes Republikës së Kosovës dhe Serbisë për të parandaluar hyrjen e grupeve ekstremiste dhe kriminale në territorin e Republikës së Kosovës. Marrëveshja e 16 shtatorit ende është në fuqi ku kjo kompetencë i takon KFOR-it.

Më lejoni t' ju informoj në mënyrë kronologjike lidhur me zhvillimet e fundit në pjesën veriore të vendit.

Më datën 8 prill 2012, në orën 1:21 në Qendrën Policore Komunikuese Rajonale është pranuar informata nga një qytetar serb se në lagjen “Tre rrokaqiejt” në pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës, është dëgjuar një shpërthim detonim, më pas në këtë qendër kanë arritur informatat edhe nga burimet tjera të cilat kanë raportuar për të njëjtin shpërthim. Kjo informatë menjëherë është përcjell në bazën e Stacionit policor të veriut në Mitrovicë nga të cilët është kërkuar që të verifikojnë informatën. Në atë lokacion ka arritur shumë shpejtë një njësi policore e Stacionit policor të veriut të cilët kanë raportuar se ka ndodhur një shpërthim dhe se ka persona të lënduar për çka është njoftuar edhe emergjenca.

Automjeti i ndihmës së shpejtë nga pjesa jugore në vendngjarje ka arritur në orën 1:47 minuta dhe me te është bërë transporti i të lënduarve për në Spitalin e Mitrovicës në jug të qytetit.

Si pasojë e këtij shpërthimi në vend të ngjarjes në banesën e tij ka mbetur i vdekur kryefamiljari Selver Zeqir Haradinaj, 38- vjeçar, kurse lëndime të lehta trupore kanë marrë dy fëmijët e tij të moshës 7- vjeçare si dhe fëmija i tretë i moshës 12 - vjeçare, të cilët ishin transportuar për në spital.

Në vendin e ngjarjes kanë dalë njësitet e Stacionit policor në veri të Mitrovicës, njësitet nga Stacioni policor jugor të cilët kanë shkuar në asistim, Njësiti i hetimeve dhe krim-teknikës rajonale të cilët njësi kanë kryer hetimet në vendin e ngjarjes. Më pas në lokacion ka arritur edhe Njësiti i mjekësisë ligjore për ta konfirmuar dhe marrë për obduksion viktimën e rastit. Mjekësia ligjore me viktimën është larguar nga vendi i ngjarjes në ora 4:34 minuta.

Në vendngjarje ka shkuar edhe njësia e IEDD, pra është njësi e policisë për deminim e cila ka marrë mostrat e nevojshme të materies së shfrytëzuar në këtë rast. Sipas zyrtarëve të kësaj njësie dyshohet se në këtë rast është shfrytëzuar një sasi rreth 500 gram të eksplozivit. Me kërkesë nga Drejtoria Rajonale Policore e Mitrovicës, nga niveli qendror është aprovuar mbështetja me togje të njësive speciale operative edhe nga rajonet tjera policore, dhe që nga kjo ditë në Mitrovicë kemi në gatishmëri në bazën e Njësive speciale operative një tog shtesë.

Më datën 9.4.2012 rreth orës 12:25 në lagjen “Tre rrokaqiejt” me urdhër të drejtorit rajonal, në Mitrovicë, është vendosur kabina për nevojë të zyrtarëve policorë të cilët ishin statik në atë lokacion.

Rreth orës 12:50 është pranuar informacioni se në pjesën veriore është lëshuar sirena e cila shfrytëzohet për t'i mbledhur bandat kriminale dhe atë pjesë dhe më pas një grup prej rreth 200 personave kanë shkuar në drejtim të lagjes se “Tre rrokaqiejve” ku është vendosur më parë kontejneri i policisë dhe në ora 12:55 kur këto banda kriminale kanë arritur atje, kanë filluar demolimin e atij kontejneri. Për shkaqe sigurie patrulla statike e cila ishte në sigurim në atë lokacion është tërhequr nga ai vend. Ky vandalizëm ka zgjatur 15 deri 20 minuta dhe pas largimit të tyre patrulla policore është udhëzuar që të kthehet prapë në lokacion.

Me qëllim të shtimit të masave të sigurisë nga data 10.4.2012, dy pikat statike janë përforcuar me zyrtarë policorë dhe gjatë gjithë kohës ka nga tre zyrtarë policorë në lagjen “Tre rrokaqiej” dhe në lagjen “Kodra e Minatorëve” si dhe ka patrullime në këmbë.

Rasti i vrasjes së qytetarit Selver Haradinaj është kualifikuar si akt terrorist dhe është duke u hetuar nga njësi antiterrorist i Policisë së Kosovës e cila njësi është duke u përkrahur nga hetuesit rajonal dhe nga Taks-Forca e EULEX-it.

Sa i përket rastit të dëmtimit të pronës së policisë së kontejnerit është iniciuar rasti në Stacionin policor të veriut dhe është me rëndësi të ceket se kemi siguruar material të mjaftueshëm në identifikimin e personave që kanë marrë pjesë në dëmtimin e kësaj prone.

Masat e ndërmarra- Pas takimit të zhvilluar me kërkesë të kryeministrit me partnerët ndërkombëtarë ditëve të fundit në koordinim me KFOR-in dhe EULEX-in, kemi shtuar prezencën në lagjet e banuara me popullatë të përzier. Njësitë speciale operative të Policisë së Kosovës, të rajonit të Mitrovicës dhe ato të dislokuara nga rajonet tjera policore kanë ngritur nivelin e gatishmërisë.

Policia e Kosovës ka kapacitete operative dhe autorizime policore për t'i mbrojtur me të gjitha mjetet në dispozicion qytetarët të cilët jetojnë në pjesën veriore të vendit.

Parimisht ne jemi në favor të koordinimit të veprimeve me KFOR-in dhe EULEX-in, por në rast se cenohet siguria e qytetarëve tanë në pjesën veriore të vendit dhe nuk ka reagim të duhur nga KFOR-i dhe EULEX-i, atëherë ne nuk do të hezitojmë të veprojmë.

Po ashtu përkundër deklarimeve të zyrtarëve të Beogradit se nuk do të mbahen zgjedhjet lokale në territorin e Republikës së Kosovës, strukturat ilegale në pjesën veriore të vendit do të bëjnë përpjekje për mbajtjen e tyre dhe në këtë rast Policia e Kosovës, do të veprojë me të gjitha mjetet kushtetuese në zbatim të vendimeve të institucioneve të Republikës së Kosovës të cilat i konsiderojnë këto zgjedhje si ilegale. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e kreu fjalën e vet.

E ka fjalën kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputeti Ismet Beqiri.

Ademi e ka kryer, unë i thashë Ismet Beqirit.

ISMET BEQIRI: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në fillim të fjalës time, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, iu shprehim ngushëllimet tona familjes së Selver Haradinaj, i vrarë në një akt terrorist para disa ditëve, konkretisht më 8 prill.

Zonja dhe zotërinj,

Gjendja në veriun e Kosovës vazhdon të jetë e rëndë dhe të përkeqësohet edhe më tej.

LDK-ja ka ndjekur dhe po ndjek me shqetësim zhvillimet e fundit në veri të vendit duke dënuar fuqishëm veprimet e dhunshme të ekstremistëve serbë.

Të nderuar kolegë,

Edhe më 27 tetor, mes tjerash, të vitit të kaluar kemi mbajtur një seancë, interpelancë lidhur me gjendjen në veri të vendit, asgjë nuk ka ndryshuar. Mund të thuhet është përkeqësuar situata edhe më shumë, në shumë aspekte, veçmas atë të sigurisë së qytetarëve tanë që jetojnë në atë pjesë të Kosovës.

Për Lidhjen Demokratike të Kosovës ka disa arsye pse vazhdon të jetë kjo gjendje e tillë. Kjo pjesë e vendit tonë vazhdon të jetë jashtë sovranitetit të shtetit të Kosovës, atje vazhdon sundimi i anarkisë, krimit të organizuar, korrupsionit, vazhdon vrasja dhe terrorizimi i shqiptarëve, vazhdon mosfunksionimi i shtetit ligjor të Kosovës, vazhdon mos funksionimi ashtu siç duhet edhe i pikave doganore, vazhdojnë të gjitha veprimet antiligjore dhe antishtetërore e po thuaj se të gjitha kanë një adresë, Beogradin dhe strukturat shtetërore të tij që janë krijues, financues, implementues të gjitha këqijave që po i ndodhin Kosovës.

Zonja dhe zotërinj,

Qeveria e Kosovës, por edhe përgjegjësit ndërkombëtarë për siguri dhe sundim të ligjit, pa dyshim që kanë pjesën e vet të madhe të përgjegjësisë për gjendjen në veri të vendit. LDK-ja përkujton edhe një fakt se jo vetëm në veri, por edhe në pjesët tjera të Kosovës, ende funksionojnë struktura ilegale, gjegjësisht paralele serbe të financuara nga Beogradi.

Të nderuar kolegë deputetë,

Situata në veri të vendit as për se afërmi s'është drejt përmirësimit. Të gjithë ne pa dyshim edhe opozitë edhe pozitë, gjithë qytetarët e Kosovës përkrahen aksionin e 25 korrikut, me gjithë lëshimet që ishin evidente gjatë atij aksioni, sepse dëshira, por edhe obligimi ynë ka qenë dhe mbetet shtrirja e sovranitetit në atë pjesë të vendit. Por, fatkeqësisht, pasoi tërheqja nga veprimet e mëtejme të vendosura të Qeverisë sonë, veprime këto që do të duhej të ishin dhe të jenë të koordinuara me faktorin ndërkombëtar. Atje ndodhën shumë veprime antiligjore dhe antishtetërore.

Duke mos dashur t'i përsërisim të gjitha, po themi se pas zhvillimeve të këqija, Qeveria e Kosovës vazhdoi të ashtuquajturat bisedime teknike e që në fakt për ne kanë qenë dhe u dëshmuar se janë politike. Këto bisedime sikur inkurajuan Beogradin dhe strukturat ilegale dhe kriminale të tyre në Kosovë, që të janë edhe më aktivë, më rrënues karshi shtetit të Kosovës.

Nga vrasja e policit të Kosovës, heroit Enver Zymberi: djegëja e pikave doganore, sulmet ndaj KFOR-it, vendosja e barrikadave, sulmet ndaj qytetarëve dhe pronës së tyre, krimi i organizuar dhe kontrabanda, fitimi i statusit të kandidatit për Serbinë, ishin disa nga rezultatet e ashtuquajtura të këtyre bisedimeve.

Të nderuar kolegë deputetë,

Kemi qenë dhe jemi të dialogohet, por jo kështu, jo me këtë çmim, jo me këtë rrezikim të vazhdueshëm të jetës së qytetarëve tanë. Ne duhet t'i kemi qëndrimet tona të qarta vepruese, ne nuk duhet të jemi vetëm vrojtues, vajtues dhe vëzhgues i zhvillimeve aktuale në veri të Kosovës,

por edhe krijues të politikave dhe strategjisë tonë qartë dhe të implementojmë atë që e kemi obligim, Kushtetutën e vendit tonë.

Lidhja Demokratike e Kosovës, rithekson edhe një herë se bisedimet me Serbinë, jo që ka ndihmuar, por kanë keqësuar gjendjen në vendin tonë veçmas në veri. Asgjë nuk po implementohet nga të ashtuquajturat konkluzat, përkundrazi po na arrestohen: policë, qytetarë, aktivistë, siç është zoti Abazi, luftëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, sigurisht që pyesim Qeverinë, kryeministrin e Kosovës, zonjën Tahiri, a janë këto shpërblime për kooperativitetin tonë, pse jo edhe ne jemi në këto bisedime?

Të nderuar kolegë deputetë,

LDK-ja konsideron se janë bërë një mori gabimesh nga ana e Qeverisë sonë në raport me veriun e vendit.

Veriu dhe situata e tërësishme në Kosovë, nuk lenë hapësirë për komoditet dhe neglizhencë. Ajo që për ne është tërësisht e papranueshme është tendenca që në çfarëdo forme të ketë përfitime, marketing politik nga kushdo qoftë, veçmas nga ata që i bëjnë elozhe edhe Qeverisë edhe të tjerëve për gjendjen në vend, me theks të veçantë në veri. Nuk ka vend për justifikim të askujt, për atë që po ndodhë në veri. Atje çdo ditë luftohet për mbijetesë të qytetarëve: mbijetesë fizike, politike, ekonomike.

Veriu, qytetarët shqiptarë të asaj pjese të Kosovës kanë nevojë për mbrojtje: siguri, sundim të ligjit, ndihmë ekonomike, kanë nevojë të shohin dorën e pushtetit, shtetit të Kosovës. Qeveria e Kosovës, koalicioni qeverisës nuk duhet të kërkojnë justifikime, ata dhe të gjithë të tjerët, pse jo edhe ne e kemi borxh të gjejmë rrugëzgjidhje, por pa dyshim që kjo barrë i bie, barrë kryesore e Qeverisë, sepse e kanë votën, e kanë marrë përgjegjësinë dhe sigurisht edhe prezencën ndërkombëtare në Kosovë, sepse konsiderojmë se në këtë drejtim është bërë fare pak, të mos themi asgjë, situata dhe zhvillimet po udhëheqin me institucionet tona. Veprimet tona janë ad-hoc, jo vizionare, jo strategjike, jo vepruese dhe jo rezultative. Vetëm me strategji të qartë, veprime këmbëngulëse, bashkëpunim, me prezencën ndërkombëtare, mund të kemi rezultate, në të kundërtën situata jo që do të përmirësohet, por ajo mund edhe të keqësohet. Qeveria e Kosovës e ka mundësinë, duhet ta ketë edhe gatishmërinë në kryerjen e obligimeve të saja që dalin nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Ne edhe më herët kemi debatuar, nxjerr rezoluta, por kanë munguar rezultatet. Duhet finalisht kaluar nga fjalë të mëdha e shpeshherë demagogjike në veprime konkrete dhe rezultate.

Qeveria e Kosovës, obligimet e saja kushtetuese i ka të përcaktuara qartë, por rezultatet mungojnë, ato obligime nuk po kryhen.

LDK-ja vlerëson se nuk janë qytetarët ata që duhet ta mbrojnë veten e tyre, familjet e tyre, as në veri, as në pjesë të tjera të vendit. Ky është obligim i institucioneve tona të sigurisë, veçmas të Policisë së Kosovës dhe prezencës ndërkombëtare siç është EULEX-si dhe KFOR-i, por sigurisht kjo nuk bëhet me dy policë dhe një kontejner në raste të tilla, vetëm mund të viktimizojmë edhe policët tanë dhe asgjë më tepër. Po ashtu i bëjmë thirrje edhe faktorëve relevant ndërkombëtarë që

të jenë më veprues, të bëjnë presion atje ku edhe duhet, në Beogradin, në mënyrë që të ndërpritet veprimi i mëtejshëm i strukturave ilegale dhe kriminale në Kosovë, veçmas në veri të vendit. Në këtë rast, askush nuk mund të lirohet nga përgjegjësia dhe obligimet e mandatuara, Qeveria e as prezenca ndërkombëtare në Kosovë. Ne besojmë fuqishëm që edhe gatishmërinë e shteteve mike siç janë SHBA-të dhe disa nga shtetet e fuqishme të Bashkimit Evropian, Qeveria jonë nuk po dinë as ta shfrytëzojë dhe as ta kapitalizojë ashtu siç duhet.

Shtrohen disa pyetje që do të duhej dhënë përgjigje nga ana e Qeverisë. Çka është bërë gjer më tani në implementimin e pakos së Ahtisarit? Ku jemi me formimin e komunës së re që parashihet, cila është strategjia e Qeverisë për këto veprime dhe veprime tjera në veri të vendit? Cili është bashkëpunimi me ata që janë përgjegjës për sigurinë në këtë pjesë të vendit? Cilat janë afatet dhe a ka fare afate për vendosje të rendit dhe ligjit në veri të Kosovës, a po shkojmë drejtë bisedimeve politike për veriun? Pse Qeveria vazhdon të bëhet sikur nuk di gjë, ku gjithë faktorët relevantë ndërkombëtarë po e përsërisin çdo ditë se një proces i ri i bisedimesh politike për veriun e Kosovës është i pashmangshëm. A do të vazhdojë kjo Qeveri të bëjë koncesione të reja në dëm të interesave të vendit ashtu siç ka bërë me lehtësi gjerë më tani?

Të nderuar kolegë deputetë,

Konsiderojmë si Lidhje Demokratike e Kosovës që duhen ndërmarrë disa veprime shumë urgjente. Qeveria e Kosovës duhet të marrë veprim konkret në kthimin e gjykatave dhe institucioneve tjera në veri të vendit. Qeveria e Kosovës dhe prezenca ndërkombëtare të ndërmarrin veprime konkrete mbrojtjen e jetës së qytetarëve dhe qarkullimin e lirë në veri të Kosovës. Të bëhet presion që të lirohen të burgosurit e arrestuar nga xhandarmëria serbe. institucionet përgjegjëse vendore e ndërkombëtare. Policia e Kosovës, EULEX-si t'i arrestojnë kriminelët e veriut dhe t'i vejnë para organeve të drejtësisë. Qeveria e Kosovës t'i ndjekë dhe t'i nxjerr para ligjit gjithë bashkëpunëtorët e ashtuquajtur ekonomik dhe të tjerë që bashkëpunojnë me kriminelët e veriut. Qeveria e Kosovës dhe prezenca ndërkombëtare e sigurisë dhe drejtësisë, Policia e Kosovës, EULEX-si, KFOR-i, duhet të ushtrojnë detyrat e tyre sipas mandatit që kanë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Në emër të “Vetëvendosjes”, kryetari i Grupit, deputeti Visar Ymeri, e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Sot janë bërë 11 ditë nga sulmi terrorist i strukturave ilegale e armiqësore të Serbisë ndaj familjes së Selver Haradinajt të “Tre rrokaqiejt” buzë Ibrit në Mitrovicë. Dhe tash 11 ditë pas, ky Kuvend i Republikës së Kosovës u mblodh për ta diskutuar gjendjen në veri, në një seancë të cilën kërkuesit e saj e quajtën të jashtëzakonshme. Por, kisha dashur të pyes këta se çfarë jashtëzakonshmërie është ajo kur nuk ka urgjencë në të?

Në një situatë të jashtëzakonshme veprimi bëhet urgjent, ndërkohë që urgjenca e një shtate e bën atë të jashtëzakonshme. Pra, njëra pa tjetrën nuk shkojnë dhe nuk mund të shkojnë, por ja që për paraqitësit e kësaj kërkesë për seancë të jashtëzakonshme gjendja në veri të vendit nuk e paska

elementin e urgjencës, që i bie që ajo është e zakonshme. Pra, që vrasjet dhe dëbimet e shqiptarëve nga veriu i Kosovës është një gjë e zakonshme. Kështu po na thonë grupet parlamentare nënshkruese të kësaj kërkesë për këtë seancë të sotme, nënshkrimet për të cilën i kanë mbledhur qysh të premtën, para 6 ditëve dhe e kanë thirrur seancën për sot.

Por kështu është sjellë edhe ekzekutivi i vendit. Në kohën kur strukturat ilegale e armiqësore të Serbisë i vrisnin dhe dëbonin shqiptarët nga veriu, kryeministri Hashim Thaçi mbante ligjërata nëpër universitete të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Asnjëherë nuk u denjua të mendojë se duhet të kthehet në vend dhe të jetë në krye të detyrës të cilën e ka uzurpuar, pra që të veprojë sikur kryeministër i vendit. Kjo papërgjegjësi nuk ka se si të arsyetohet, përveç nëse edhe ky si deputetët e Grupit Parlamentar të partisë së tij, e sheh vrasjen dhe dëbimin e shqiptarëve sikur diçka të zakonshme. E zakonshmja e dimë të gjithë është e pritshme, diçka të cilën lehtë mund ta paramendojmë se do të ndodh. E pra, a e kemi ditur kryeministri se një gjë e tillë do të mund të ndodhte? Se një gjë e tillë na e konfirmoi pak a shumë edhe Bajram Rexhepi, këtë mendësi të këtij ekzekutivi.

Ministri i Punëve të Brendshme në deklarimin e tij sot këtu në Kuvend, tha se gjendja në veri është e tensionuar, por nën kontroll, dhe pastaj na tregoi se si politikanët serbë hynë ilegalisht në territorin e Kosovës, se si këta paskan marrë informata se Selver Haradinaj është vra dhe familja e tij është plagosur, këta po ditkan për krime që po i kryekan strukturat ilegale të Serbisë të gjitha i raportoj këtu nën vallon e kontrollit, pra nga tha që e kemi situatën nën kontroll, që i bie që të gjitha këto paskan ndodhur në një situatë tashmë të kontrolluar, apo jo.

Po të kishin qenë të sinqertë deputetët, por edhe ekzekutivi dhe po ta kishin menduar vërtet se situata atje është e jashtëzakonshme, atëherë do ta nënshkruanin kërkesën tonë për seancë të jashtëzakonshme, me ç'rast do ta mundësonin mbajtjen e saj me urgjencë për këtë seancë të cilin ne insistonim që të mbahej javën e kaluar, pra menjëherë pasi ndodhën këto raste të sulmeve terroriste.

Por këtë, siç e dini të gjithë, nuk e bën. Kjo kërkesë e tyre për sot bëhet edhe më absurde kur kemi parasysh se këta deputetë janë nga koalicioni qeverisës dhe të partisë së kryeministrit. E po të kishte qenë serioz dhe i sinqertë, edhe ky pra kryeministri deri tash do të ndërmernte hapa për ta mbrojtur integritetin territorial dhe ushtruar sovranitetin shtetëror në tërë Kosovën në tërë territorin e vetë Ky kurrë nuk e bëri një gjë të tillë, madje edhe këtë seancë të jashtëzakonshme do të kishte mund ta thërrasë vetë se e ka të drejtë me rregullore, por as këtë kurrë nuk e bëri.

Po na thuhet se veriu në njëfarë forme funksionon kështu siç është që prej vitit 1999. Mirëpo nëse kthehemi pak në histori, do ta shohim se tërheqja e institucioneve të Kosovës nga atje është bërë gradualisht dhe me hapa. Pra, sikur të ketë qenë e planifikuar.

Në ditët e para të hyrjes së forcave të KFOR-it në Kosovë, veriu i Kosovës nuk ka pasur struktura të Serbisë të organizuara atje. Deri në vitin 2000 shqiptarët në pjesën veriore të qytetit kanë qenë duke jetuar në shtëpitë e tyre dhe banesat e tyre, dhe natyrisht kanë qenë shumicë.

Spitali i Mitrovicës po ashtu ka qenë në duart tona deri vonë. Gjykatat kanë funksionuar deri në vitin 2000. Doganierët e Kosovës kanë qenë në pikat kufitare me Serbinë deri në vitin 2008. Sot nuk e kemi asnjë prej këtyre institucioneve që funksionojnë në atë pjesë, pra e kemi një tërheqje graduale me hapa të paramenduar të institucioneve të Kosovës nga atje.

E tërë kjo tërheqje, dhe një pjesë e madhe e krimeve në veri, kanë ndodhur në kohën kur Kosova thoshte se ka institucione dhe thoshte se e është e lirë. Një pjesë e konsiderueshme e tyre ka ndodhur në Kosovën me të njëjtin kryeministër, pra me Hashim Thaçin. Tash e katër vjet e gjysmë të drejtimit të qeverisë nga ai, strukturat ilegale të Serbisë janë toleruar vazhdimisht të veprojnë, terrorizojnë, vrasin, dhunojnë e plaçkitin çdo gjë shtetërore, publike e private në atë pjesë të vendit, njëllë sikur në kohën e qeverive të mëparshme. Tash e katër vjet e gjysmë kjo qeveri e ka përkeqësuar çdo gjë në të cilën ka prekur, por edhe ato aspekte ku ajo nuk ka vepruar fare. E tash deputetët e saj na thërrasin në seancë, për ta zëvendësuar kështu mungesën e veprimi qeveritar e institucional atje.

Qysh në shtator të vitit 2008, pra para më shumë se tri vjetëve, lëvizja “Vetëvendosje” pat bërë një propozim me disa hapa të bashkërenduar për ta bërë Kosovën shtet sovran e me integritet territorial. Në vijim po e shfrytëzoj rastin t’i përmend disa më kryesoret prej tyre.

Pra nën 1- FSK duhet të shpallet dhe bëhet ushtri. Pastaj, menjëherë të iniciohet marrëveshja SOFA me NATO-n.

Në veri duhet të ketë një prezencë të shtuar të policisë për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme atje. Një bazë e Njesisë Speciale të Policisë së Kosovës duhet të jetë e vendosur në Lagjen e Boshnjakëve, në ish bazën e KFOR-it, përkatësisht ish remontin ushtarak. Dy baza të tjera të njesisë speciale, së bashku edhe me forcat ushtarake, duhet të jenë në afërsi të pikave kufitare 1 dhe 31.

Kosova duhet të krijojë marrëdhënie të fuqishme bilaterale me shtetet e veçanta që na e kanë njohur pavarësinë, e posaçërisht me Shqipërinë, ShBA-të, shtetet kryesore të BE-së, Turqinë e kështu me radhë.

Duhet të ndërpriten përfundimisht dhe zyrtarisht këto bisedime që po zhvillohen në Bruksel me Serbinë, e të cilat, siç e dimë, janë bisedime pa kushte për Serbinë dhe për çështje të brendshme të

Kosovës. Me këto bisedime nuk forcohet pavarësia e Kosovës prej Serbisë, por forcohet pavarësia e veriut të Kosovës prej Kosovës.

Duhet të vihen në shënjestër burimet financiare të strukturave ilegale dhe armiqësore të Serbisë. Duhet gjurmuar dhe duhet prerë financimi i tyre nga Serbia dhe nga krimi i organizuar e bizneset informale. Duhet përndjekur dhe arrestuar e dënuar pjesëtarët e strukturave ilegale për shkak të historikut të bujshëm kriminal dhe armiqësor që ato i kanë pasur prejse veprojnë në Kosovë.

Nuk mund të ketë paqe të qëndrueshme pa reciprocitet e simetri të drejtave të serbëve në Kosovë, me shqiptarët në Serbi. Shqipëria dhe Kosova bashkërisht duhet të angazhohen për shqiptarët kudo që ata janë e posaçërisht për ata në Preshevë, Medvegje e Bujanoc. Arsyeja kryesore pse Serbia e ka synuar decentralizimin në Anamoravë është që ta hedhë farën e ndarjes dhe izolimit të asaj pjese, pra të luginës së Preshevës prej Kosovës.

Qeveritë dhe kryeministrat e pasluftës, janë munduar t'i integrojnë serbët duke iu dhënë ose premtuar mijëra euro kesh, duke iu falur traktorë apo duke ua ruajtur pagat edhe kur ata punonin për Serbinë. Zgjidhja është krejtësisht ndryshe, jo para e privilegje, por zhvillim arsimor e ekonomik dhe barazi para ligjit, jo bisedime me Serbinë e strukturat e saj, por integritet territorial për vendin e sovranitet për shtetin tonë.

Rivitalizimi i “Trepçës”, funksionalizimi i saj do të rezultonte me punësimin e rreth 8.000 personave. Kjo do të kontribuonte në bashkimin e qytetit sepse ndarja në Ibër e ka lënë minierën e Stan-Tërgut në njërin anë, ndërsa shkritoren në anën tjetër pra në Zveçan. Kështu, Mitrovica u shndërrua në qytetin më të varfër dhe ajo është i vetmi qytet në Kosovë të cilit i është zvogëluar popullsia përgjatë viteve.

Ofrimi i bursave për shqiptarët dhe serbët nga veriu për në shkollat e mesme dhe Universitetin në Prishtinë.

Investim në Spitalin e Prishtinës dhe atë në jug të Mitrovicës, në mënyrë që aty të ofrohen shërbime më të mira shëndetësore.

Forcimi i fshatrave të shqiptarëve dhe lagjeve të Mitrovicës, të banuara me shqiptarë në veri duke ofruar mjete për rindërtimin e shtëpive, infrastrukturë të mirë, transport publik falas për në jug të Mitrovicës dhe anasjelltas tri herë në ditë, lehtësim në punësim, lehtësim për regjistrim në Universitet e masa tjera.

Vetëm me 3 dhe 4 shkurt të vitit 2000, 11 shqiptarë janë vrarë, me dhjetëra të tjerë janë keqtrajtuar ose lënduar ndërsa 1.564 familje me 11.364 anëtarë janë dëbuar nga pjesa veriore e Mitrovicës. Secili shqiptar i dëbuar duhet të kërkojë të kthehet në pronën e vet në veri dhe njëkohësisht të

organizohen dhe mobilizohen për këtë. Ata që nuk duan, duhet ta thonë hapur këtë dhe t'ua shesin të tjerëve pasurinë, atyre që duan të kthehen atje. Qeveria duhet ta ndihmojë dhe mbështes këtë me një program të veçantë.

Nuk duhet lejuar që Qeveria e Serbisë t'i blejë pronat e shqiptarëve në veri. Të gjithë shqiptarët që janë detyruar t'i shesin pronat e tyre, ato duhet t'i blejë Qeveria e Kosovës. Serbët do të mund të integroheshin në Kosovë, duke pasur parasysh që integrimi ndodh jo pse është dëshirë, por pse nevojë, mirëpo kjo Qeveri as nuk mundet as nuk bënë t'i bëjë këto hapa,

Kjo qeveri është e korruptuar dhe e shantazhuar dhe është pa legjitimitet demokratik e kredibilitet politik. Kjo qeveri e ka dëshmuar vazhdimisht dhe aktualisht se nuk është as serioze e as e vendosur. Edhe kur vendos ta bëjë një të mirë të vogël, ajo i bën edhe shumë të këqija të mëdha me të cilat situatën e rëndë vetëm se e rëndon dhe e përkeqëson. Kjo qeveri e cila i ndërsen deputetët e vet kundër reciprocitetit, pra barazisë me Serbinë, dhe e cila kategorikisht e kundërshton zbatimin e vendimit të Kuvendit, që obligon reciprocitet, nuk është një qeveri e cila mund t'i kundërvihet Serbisë apo strukturave ilegale të saj në Kosovë. Kjo qeveri e ka vetëm një mënyrë për ta shpëtuar Kosovën, kjo mënyrë është dorëheqja e saj. Shpëtimi edhe i qeverisë edhe i Kosovës është i pamundshëm, e Kosova duhet domosdo të shpëtohet që nënkupton

KRYETARI: Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, e ka fjalën Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Mendoj se nuk do mëndë se përpos problemeve që i ka Kosova në veri, Kosova ka problem gjithkund në çdo sferë të jetës, në çdo aspekt dhe veriu i Kosovës është reflektim i asaj që Qeveria e Kosovës ka arritur ta bëjë për katër vjet me gjithçka që ka prekur, me gjithçka me të cilën është marrë që do të thotë absolutisht me gjithçka, me ekonomi, me sundim të ligjit, me korrupsion, me rend, me ndërtim të ideve për zhvillim, në çfarëdo aspekti ka dështuar. Ka bërë universitete fals, ka bërë institucione fals, e ka zhveshur Kosovën prej mundësisë për t'u marrë me vetveten, e ka zhveshur Kosovën edhe prej mundësisë të merret me veriun.

Nëse dëgjoni ministrin e Punëve të Brendshme sot ju shihni se ai na lexon neve raportin e Policisë, thuaj ti se ne jemi këtu Drejtoria e Përgjithshme e Policisë dhe duhet ta dimë se çka po ndodhë. Ne nuk jemi Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, ne jemi deputetë të Kuvendit të Kosovës, përfaqësues të popullit dhe ministri ka qenë dashur në vend se të na lexojë raportin, të na tregojë - cilat janë masat që i ka marrë për ta ndryshuar gjendjen në veri të Kosovës, cilat janë nevojat që i ka qeveria ekstra, përpos atyre që u ka dhënë deri më tani, qoftë me buxhet, qoftë me ligje, Kosova? Por ministri nuk e ka asnjë ide asisoj edhe nuk ka qysh ta ketë se një gjë të tillë nuk ia kërkon shefi i vetë. Kultura e punës e kësaj qeverie është diçka që e kemi përmendur në vazhdimësi këtu, kultura e punës së Qeverisë së Kosovës është e tillë që krejt energjitë i shpenzon të kamuflojë problemin, me ju qitë hi syve qytetarëve dhe asnjë minutë të vetin të punës nuk e shpenzon që realisht të gjejë zgjidhje.

Sipas kësaj Qeveria për gjendjen në veri gjithkush ka faj, përpos Qeverisë së Kosovës, kanë faj Serbia, që do të kthehem pak te kjo punë, ka faj bashkësia ndërkombëtare, kanë faj strukturat paralele, ka një herë ka faj edhe opozita, por Qeveria kur nuk ka faj për gjendjen e krijuar në veri.

Thashë edhe një herë, kjo mënyrë e punës, kjo qasje, kjo mënyrë e të menduarit e ka zhveshur Kosovën edhe prej mundësisë me u marr në veri, dhe u tha më përpara, do t'i them edhe unë në fund, vërtet ekziston vetëm një mënyrë për të filluar me i zgjedh problemet në veri.

Akuzimi i Serbisë për problemet në territorin tonë është në mënyrë indirekte pranim i paaftësisë për t'u marrë me ato probleme, është indirekt pranim i paaftësisë për të ndërtuar shtet dhe institucione të afta shtetërore për t'u marrë me problemin në veri.

Akuzimi i bashkësisë ndërkombëtare për probleme në veri, është implicit pranim i faktit që Qeveria ka dështuar t'ua mbushë mendjen se është e aftë për t'i zgjidhur problemet në veri, domethënë kemi dështim, dështim, dështim.

Përkundër kërkesave të Aleancës që rrafsh katër vjet që në kohën kur janë mbajtur zgjedhjet lokale të Serbisë të parat pas pavarësisë dhe kur jenë djegur pikat tona kufitare, që Qeveria të ketë plan, Qeveria ka dështuar totalisht jo vetëm të prodhojë plan se është totalisht e paaftë, po ka dështuar edhe të gjenerojë ndonjë ide normale për ta zgjidhur problemin e veriut në mënyrë normale.

Po ju përkujtoj 6 pikëshin, vetëm pak. Sot gjendja në veri është më e keqe se para katër vjetëve, definitivisht më e keqe asnjë element i jetës atje jo vetëm për shqiptarët që do të kthehen prapë, por as për vetë serbët nuk është më mirë se që ka qenë para katër vjetëve kur kjo qeveri ka ardhur në pushtet duke premtuar se ka për t'i zgjidhur problemet, duke premtuar se ka për ta integruar veriun. Siguria është më e keqe, sundimi i ligjit ka degraduar totalisht, veriu është edhe më pak i integruar se që ka qenë në vitin 2008, në fillim shembull ta marrim, strukturat paralele edhe më të forta edhe më të sigurta në vetveten.

Atje ka edhe më pak shqiptarë, vënia veshin kësaj pune, në veri të Kosovës ka edhe më pak shqiptarë edhe kur e dëgjoj ministrin e Punëve të Brendshme me porosi të kryeministrit na thotë se nëse nuk ndërhyjnë KFOR-i dhe EULEX-si do të ndërhyjnë Qeveria e Kosovës, mund t'i them - kur, a doni të ndërhyjnë në atë moment kur nuk mbet asnjë shqiptar në veri?

Po ju përsëris, deputetë të nderuar të Kuvendit të Kosovës, pa dashur t'i fye deputetët serbë të Kuvendit të Kosovës, në veri të Kosovës ka më pak shqiptarë se që ka pasur në vitin 2008, ndërsa në të gjitha viset e Kosovës tjera ka më shumë serbë se që ka pasur në vitin 2008.

Ata qytetarë të Kosovës, shqiptarë që kanë mbetur në veri janë edhe më pak të sigurt, domethënë edhe ata që kanë mbetur, pak sa kanë mbetur janë edhe më të pasigurt se që kanë qenë në vitin 2008 e mos të flasim për më herët. Dhe, kjo Qeveri dy herë ka ardhur në pushtet duke premtuar ekaktesisht të kundërtën.

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Unë ju kam propozuar grupeve parlamentare jo formalisht që sot deputetët e opozitës të mos flasin vetëm ta dëgjojnë PDK-në dhe qeverinë se çka kanë të thonë për veri, edhe singërisht i kam lutur, ata kanë dashur të flas jo për një arsye tjetër, por jam absolutisht i bindur se kanë shumë çka me thanë për veri, kanë shumë çka për të thënë për atë që ka ndodhur në veri, kanë shumë çka me thanë për atë çka ka ndodhur në veri, kanë shumëçka për të thanë për dështime totale të Kosovës e kjo do të thotë të Qeverisë së Kosovës se ajo i ka mundësitë buxhetin edhe mjetet për të qeverisur.

Sidoqoftë edhe një herë po ju them jam jashtëzakonisht i interesuar, me singëritet të dëgjojë çka ka të na thotë PDK-ja katër vjet pas ardhjes në pushtet dhe çka ka të na thotë Qeveria e Kosovës, me në krye zotin Thaçi, katër vjet pas ardhjes në pushtet për sukseset e veta në veri, për premtimet që ia ka bërë popullit të Kosovës dhe për ato premtime të cilat nuk i ka mbajtur.

Aleanca është jashtëzakonisht shumë e interesuar dhe ju premtova se do t'ju them, ne kemi propozuar plan dikur, ne kemi kërkuar që Qeveria të hartojë plan, por tani kemi ardhur në pozitë të identifikojmë vetëm hapin e parë drejt zgjidhjes së problemit në veri. Ai hap i parë u tha nga një parafolës me singëritetin më të madh po ju them është kjo Qeveri të nisë t'i mbledh letrat edhe plaçkat, të lëshojë rrugë se është duke e sakatuar Kosovën. Ju kam thënë një herë, po ju them edhe një herë, me këtë qeveri në pushtet, Kosova po shkon drejt zhbërjes së asaj që e ka bërë me shumë mund për gati një shekull. Faleminderit!

Drejton seancën, nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Xhavit Haliti

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, kryetarja e Grupit Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Përshëndetje për kryeministrin dhe për gjithë Kabinetin qeveritar,

Duke marrë parasysh se në seancën e kaluar kishim një kërkesë që të mbahet një seancë e jashtëzakonshme për arsye që kryeministri dhe gjithë Kabineti qeveritar, këtu e kam përkrahur edhe partinë opozitare “Vetëvendosja” që në seancë të jashtëzakonshme të jetë ekzekutivi i vendit. të gjithë jemi në dijeni si është situata në Mitrovicë, të lutem dëgjo kur të flas.

Të gjithë jemi të informuar se është situata e sigurisë në Mitrovicë dhe situata e zhvillimit ekonomik. Duke marrë parasysh që 12 vjet pas lufte të gjitha partitë që kanë qenë në pushtet dhe ky koalicion qeveritar s'duhet të thuhet se Kosova dhe pjesa veriore e Kosovës është vetëm e kësaj qeverie apo vetëm e PDK-së apo vetëm e kryeministrit Thaçi, duhet të thuhet se Kosova është e përbashkët për të gjitha subjektet politike dhe në rast se etiketohet Kosova, atëherë etiketohemi të gjitha subjektet politike.

Të gjejmë një gjuhë të përbashkët, të punojmë të gjithë që pjesa veriore e Kosovës, pavarësisht a është pjesa e Mitrovicës a cila do pjesë tjetër e Kosovës nesër që do të përballet me probleme, të kemi një gjuhë të përbashkët si subjekte politike.

Edhe një herë inkurajoj Qeverinë e Kosovës, bashkësinë ndërkombëtare, NATO-në, BE-në, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe EULEX-in, i cili e ka rastin e monitorimit të gjyqësorit në Kosovë, të shtrijë rendin dhe ligjin në pjesën veriore të Kosovës, për arsye se ne kemi pranuar pakon e

presidentit Ahttisari për pavarësinë e Kosovës dhe pakoja e presidentit Ahttisari duhet të zbatohet edhe në pjesën veriore të Kosovës.

Toleromi i madh i strukturave paralele, bllokimin e lëvizjes së lirë të qytetarëve dhe lëvizjes së mallrave në mënyrë të rregullt, mirëpo ato nuk kanë shkuar në mënyrë të rregullt edhe pas bisedimeve teknike, po kanë shkua në mënyrë ilegale, atëherë kërkohet një masë shtesë edhe nga Qeveria edhe nga faktorët ndërkombëtarë që janë në Kosovë, të cilët na kanë përkrahur edhe për shpalljen e pavarësisë së Kosovës dhe deri më tani që situata në veri të qetësohet, të zbatohet plani i Ahttisarit dhe zgjedhjet në komunat veriore të zbatohen në atë plan.

Kërkoj edhe një herë nga Qeveria, këtu jo si parti në pushtet, mirëpo si qytetare e Kosovës dhe si deputete brenda këtij Kuvendi, së bashku me KFOR-in, me EULEX-in, me NATO-n që rasti i qytetarit Selver Haradinaj dhe i policit të vrarë dhe arrestimi i disa qytetarëve tanë pa kurrfarë kontesti që të zbardhet edhe nga Qeveria, mirëpo edhe nga faktori ndërkombëtar, se në rast se Qeveria e Serbisë mendon që Kosova, për arsye të bashkësisë ndërkombëtare e pranon çdolloj bisedimi dhe çështja e veriut të Mitrovicës mbetet pengë i bisedimeve të ardhshme, atëherë luajtja e kufijve nuk do t'i kushtojë vetëm Serbisë, por do t'i kushtojë tërë Ballkanit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar i SLS, anëtari i Kryesisë zoti Petar Miletij.

PETAR MILETIĆ: Poštovani podpredsedniče Skupštine Kosova,

Poštovani predsedniče Vlade, i članovi Vlade,

Poštovane kolegice i kolege poslanici,

Nije prvi put da u Skupštini Kosova razgovaramo o problemu severa Kosova. Koliko snažno podržavam tu činjenicu i potrebu da se ovom problemu govori na ovo mestu, toliko me i zabrinjava način na koji se o ovom problemu raspravlja.

Događaji nas prestižu i za to apelujem da danas sa ovog mesta ne šaljemo jeftine poruke u dnevno političke zvrke, mada neki poslanici već to čine, već da zajedno učinimo sve da konačno otpočne proces rešavanja ovog problema.

I suviše često je ova tema korišćenja za slanje snažnih i emotivnih političkih poruka, koja pri tom nisu imale ni cilj ni želju da se ovaj problem reši, već nameru pojedinih političkih predstavnika da na ovoj teškoj temi trenutno političkih profitiraju.

Problem severa Kosova je po svom karakteru duboko politički problem. To što je on i bezbednosti problem samo je manifestacija političkog problema. Bavimo se dakle posledicama koje su po svom karakteru naravno i opasne i nepredvidive.

Problem na severu Kosova ne može rešiti samo policija, već politički predstavnici. Na severu Kosova postoji Kosovska Policija, EULEX-s Policija i KFOR. Dakle ne manjka ljudi koji se bave bezbednošću pa ipak imamo bezbednosti problem, zašto je to tako, .. ovo zato što se ovde radi o nerešenom i dugo zapostavljenom političkom problemu, bezbednosti problem je kao što već rekoh samo njegova manifestacija.

Svako jednostrano gledanje na ovaj problem ignorisanje realnosti i argumenata oštro su prostravljeni strana samo odlaže i otežava konačno rešenje. Ne treba ignorisati ni razlike u percepciji budućnosti ni u doživljaju teške prošlosti. Treba međutim strplivo raditi na pronalaženju rešenja za zajedničke probleme jer je mnogo više zajedničkih nego odvojenih problema.

Mislim da ovo mora biti početna tačka za rešavanje ne samo problema na severu Kosova, već i istorijsko pomirenje i suživota Srba i Albanaca.

Na nama poslanicima u ovom domu je veliko odgovornost da nijednom rečju ili odlukom dodatno ne pogoršamo stanje na terenu. Takođe Vlada Kosova mora demonstrirati političku zrelost i odgovornost po gotovo u trenutku kada je Beograd raspisao izbore u nameri da ih održi i na Kosovu. I ako raduju jučerašnji prvi signali o mogućnosti pronalaženju rešenja za nastalu situaciju ta odluka je već izazvala reakcije koji su podigle tenzije.

Pomoć međunarodne zajednice za to nije samo dobrodošla ona je i neophodna. Briselski dogovori u sve svoje manjkavosti pokazali su da je uz prisustvom međunarodnih autoriteta moguće nalaziti rešenja na izgled nepremostivih razlika. Zašto ne bih ovaj put poučeni dešavanjima iz prošlosti išli u susret problemu i uz pomoć naših prijatelja iz Evrope, iz Sjednih Američkih Država pokušali da nađemo minimum zajedničkih interesa.

Ne vidim razlog da mi ovde na terenu sami ne pokrenemo inicijative za rešavanje naših problema. Ako bi sami preuzimali inicijative i razmenjivali ideje za rešavanje osetljivih političkih tema sa svim relevantnim faktorima na severu Kosova i onda koristili međunarodnu pomoć koje nam se nudi našim partnerima iz razvijenih demokratija pokazali bih da smo odgovorni ljudi koji s vataju trenutak u kome žive i procese koji su neminovnih. Osim toga poslali bi svima još jednu snažnu poruku, poruku da želimo da utičemo na naše živote svog nas samih, a ne za to što su to uslovi koji se stavljaju pred nas kako bi postali deo evropske porodice i civilizovanog sveta. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

“6+”- nuk është paraqitur askush, Albert Kinolli.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë,

Nuk do mend se sot jemi duke diskutuar apo debatuar për një pikë të rëndësie të veçantë e cila është shumë shqetësuese jo vetëm për qytetarët e Republikës së Kosovës të cilët jetojnë në pjesën veriore të vendit, gjegjësisht Mitrovicën veriore, por edhe problematike dhe enigmatike për gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës si dhe institucionet tona.

Sot edhe 13 vjet pas konfliktit në Kosovën e lirë dhe të pavarur, kidnapohen policët e Republikës së Kosovës në detyrë, vriten policët e Republikës së Kosovës duke kryer detyrën e tyre dhe duke qenë në shërbim të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, barikadohen rrugët, digjen pikët kufitare, vriten qytetarët e Republikës së Kosovës. E siç shihet nuk mjafton gjithë ky destruktivitet e tani dëshirojnë që edhe zgjedhjet e tyre t'i organizojnë në Republikën e Kosovës duke cenuar dhe shkelur integritetin territorial dhe sovranitetin e mbi të gjitha e kanë guximin që radikalët dhe

ekstremistët të vijnë në veri të vendit dhe të bëjnë fushata elektorale duke tensionuar edhe më shumë situatën e elektrizuar.

Mirëpo për çudi, shumica e raporteve të cilat vijnë nga miqtë tanë ndërkombëtarë flasin se duhet Qeveria e Kosovës të bëjë një plan gjithëpërfshirës, duhet punohet më shumë në mënyrë që të integrohet veriu i vendit e përkundër faktit se Qeveria jonë është munduar dhe po mundohet që me diplomaci dhe me konstruktivitet duke infestuar miliona euro të arrijë këtë qëllim, për çudi nuk arriti ndonjë përshtypje të veçantë të tërheqë vëmendjen e ndërkombëtarëve. Andaj, edhe njëherë shfrytëzoj rastin t'ju përkujtoj të gjithë atyre që nganjëherë ndoshta po harrojnë faktin dhe realitetin e ri të krijuar në Kosovë, se Kosova është shtet i pavarur, demokratik dhe sovran, i pranuar përafërsisht nga 90 shtete të botës, konfirmuar nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, me mundësi të barabarta për afirmim për të gjitha komunitetet.

Në fund si deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, ftoj KFOR-in dhe EULEX-in që t'i kryejë obligimet dhe detyrat e veta konform mandatit, të cilin e ka, siguri për të gjithë dhe sundim të rendit dhe të ligjit në koordinim e bashkëpunim me Policinë e Republikës së Kosovës dhe institucionet e Republikës së Kosovës, në mënyrë që të vendoset rendi dhe ligji, lëvizja e lirë, të ndalohet dhuna, të vihet situata në kontroll dhe mbi të gjitha të mos provokohet më durimi i qytetarëve, të cilëve edhe ashtu i është provokuar shumë herë durimi deri më tani. Duke shpresuar se ngjarjet dhe skenat, të cilat vetëm e tensionojnë situatën dhe shkaktojnë urrejtje ndëretnike do të tejkalohen me angazhimin maksimal dhe vendosmërinë maksimale të organizmave, të cilat kanë mandat dhe obligim për të bërë një gjë të tillë, siç janë KFOR-i dhe EULEX-i.

Dhe, krejt në fund si Grup Parlamentar "6+" mendojmë se zgjidhja e vetme për veriun e vendit është pakoja e presidentit Ahhtisari e cila garanton paqe, tolerancë ndëretnike, bashkëjetesë, integrim të plotë të gjitha komuniteteve, mirëpo të kuptojmë drejt, pa plus dhe pa minus.

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka zëvendëskryeministri zoti Kuçi.

ZËVENDESKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit!

I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

Zoti kryeministër,

Anëtarë të Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që edhe unë të marrë pjesë në këtë debat, të cilin njëkohësisht do t'i shpreh disa qëndrime të Qeverisë jo vetëm mbi atë se çfarë është gjendja, por mbi më shumë në atë se çfarë duhet të ndërmarrim në të ardhmen.

Unë personalisht edhe Qeveria e Kosovës e kupton e këtë debat si pjesë e politikës së bashkuar që duhet ta kemi të gjithë në Kosovë, qoftë ata që janë në pozitë apo në opozitë, por ndoshta edhe si pjesë e politikës së bashkuar që duhet ta ketë edhe politika edhe qytetarët e Kosovës, pa dallim etnie me bashkësinë ndërkombëtare. Natyrisht që nuk është objektiv i garës politike që mund të jetë një debat i tillë, por e kuptojmë logjikën politike dhe demokratike që mund të jetë pjesë e debatit edhe për garë politike brendapërbrenda Kosovës.

Për atë që pajtohem gjithë ne, besoj duhet të pajtohem që si të punojmë që të mos jetë pjesë e garës politike për Serbinë, pjesa e veriut të Kosovës. Dhe, fatkeqësisht sot është pjesë e garës politike edhe për Serbinë. Natyrisht, që këtu kur flasim sot edhe unë edhe ju të tjerët të gjithë ne këtu kemi parasysh jo vetëm konstatimin e gjendjes si shumë të rëndë për shkak të rendit Kushtetues që është jashtë saj dhe efektivitetit të sovranitetit që s'po mund ta ushtrojmë si duhet, por mbi të gjitha edhe për kohë gjatësinë që e ka pasur për mbi 13 vjet. Besoj, që nuk është shumë në domenin tonë të japim vlerësime morale apo kategorizime sinqeritet ose jo sinqeritet, ose në vlerësime tjera kush e ka fajin para dy vjet, pesë vjet ose tani, por besoj secili duhet të koncentrohemi adresantëve sot dhe mbi të gjitha atyre, të cilët presim që ta bëjmë zgjidhjen me ta. Ndoshta, fillimisht duhet të kemi parasysh qytetarët tanë.

Sot, këtu janë të besoj të vëmendshëm, qytetarët tanë shumicë shqiptarët, por janë të vëmendshëm edhe qytetarët serb, në veçanti që jetojnë në atë pjesë të Kosovës. Dhe, unë mendoj që ata janë një prej faktorëve, të cilët mund të kontribuojnë pozitivisht në zgjidhjen e këtij problemi. Të dy palët, edhe qytetarët shqiptarë edhe qytetarët serbë duhet t'u besojnë institucioneve vendore dhe institucioneve ndërkombëtare. Çdo rrugë tjetër jashtë këtyre institucioneve është rrugë që nuk e ndihmon zgjidhjen e problemit, po është rrugë që e konfronton zgjidhjen legale dhe kushtetuese në atë që dikush mund ta ketë qëllimin fisnik, por veprimi mund të jetë ilegal dhe konfrontimi i tillë pastaj nga një qëllim fisnik mund të dalë në një veprim ilegal që konfrontohet, qoftë me institucionet vendore apo ndërkombëtare.

Çështja e dytë ka të bëjë me minoritetin serb dhe këtu duhet të punojmë që ata të kenë një perceptim tjetër për kualitetin e statusit politik që ka Kosova. Katër vitet e fundit nuk e kanë ndryshuar gjendjen në veri, zoti Gjini, për shkak të aktivitetit ose mos aktivitetit të dikujt, por për shkak të perceptimit të tyre për statusin e Kosovës, dhe ky është esenca e problemit. Nëse ne do t'i themi atyre: “urdhëroni, punoni me UNMIK-un, ata s'kanë telashe. Urdhëroni, punoni me institucionet e Republikës së Kosovës” këtu lind problemi. Dhe, ne duhet të punojmë më shumë me ata qytetarë në radhë të parë: KFOR-i, EULEX-i edhe Policia e Kosovës, të dekriminalizojmë atë ambient.

Qytetarët në atë pjesë, të cilët janë shprehur pozitivisht për Kosovën, për statusin e saj ndonjëri që është edhe në sallë është i plagosur, ndonjëri tjetër është edhe i vrarë. Dhe, ne duhet të mos i vëmë në rrezik qytetarët tanë, por duhet të punojmë që ata qytetarë të kenë mbrojtjen e domosdoshme, por fillimisht të dekriminalizohen nga një grup i njerëzve, të cilët në emër të një patriotizmi të rrejshëm të veprojnë si eksponentë të strukturave të Serbisë, por njëkohësisht veprojnë edhe si struktura të organizimit të krimit edhe këta duhet t'i ballafaqojmë.

Çështja e dytë që unë mendoj duhet të bisedojmë është çështja të institucionet dhe të partitë politike. Këtu nuk e shmangu asnjëherë dhe nuk e shmangim përgjegjësinë kryesore që ka Qeveria e Kosovës. Ne këtu duhet të jemi aktiv, duhet të punojmë secili prej nesh dhe duhet të punojmë edhe me partitë politike serbe që janë të integruara, të na i gjejnë njerëzit, kontaktet tona, personat atje që janë të admirueshëm për punën që e bëjmë ne, por duhet edhe faktori ndërkombëtar të vë kontakte dhe tu tregojmë atyre që pakoja e presidentit Ahtisari, Kushtetuta e Kosovës u mjafton për të drejtat e tyre, qoftë etnike, politike, drejtat njerëzore etj. edhe në 2008 kemi pasur enklava. Kemi fituar qasje dhe me fitimin e asaj qasje sot ato enklava nuk ekzistojnë, po janë pjesë e institucioneve të vendit tonë dhe unë besoj që kjo është rruga e zgjidhjes dhe mbi të gjitha nuk

guxojmë t'i frikësojmë qytetarët tanë serbë atje se atje do të ndodh diçka, një rrëmujë, një revolucion i cili pastaj fuqinë goditëse të institucioneve tona nuk do ta kufizojë.

Institucionet e Kosovës do ta kenë fuqinë goditëse ndaj kriminelëve, ndaj njerëzve që identifikohen me kundër ligjin, por jo me qytetarët tanë qoftë serb apo shqiptarë. Po ashtu, institucionet tona, partitë politike duhet të jemi të kujdesshëm me krijimin e ambientit politik dhe veprimet tona legale që mund t'i marrim dhe unë jam i bindur që do t'i marrim për vendosjen e rendit dhe ligjit në koordinim me KFOR-in dhe EULEX-in duhet të jenë në një ambient politik ku ato veprime pastaj qytetarët serb nuk do t'i refuzojnë. Nuk do të jenë ata që mund t'i shohim larg qoftë me ndonjë traktor, kamion apo diçka tjetër si shenjë e ndonjë pastrimi etnik që pastaj bota demokratike e percepton si ndryshe.

Çështje që ne duhet ta diskutojmë dhe faktorë të pashmangshëm janë KFOR-i dhe EULEX-i. Duhet ta pranojmë faktin, në krijimin e ambientit të sigurt KFOR-i dhe EULEX-i e kanë primatin në atë pjesë të Kosovës dhe unë do të thosha e kanë edhe barrën e përgjegjësisë kryesore. Kjo nuk është me ik mandati që ka Policia e Kosovës, por me dokumentet që gjenden në Kosovë ata, qoftë në Rezolutë që e përmend dikush, qoftë me vendimin e Këshillit të Ministrave të 8 shkurtit 2008, qoftë me letrën apo ftesën që kemi bërë ne, ata kanë mandat për krijimin e ambientit të sigurt, për ruajtjen e jetës së qytetarëve, pronave të tyre dhe aktivitetet tjera kundër grupeve kriminale. Dhe, ata i kanë dy telashe që shpesh na vënë edhe neve në konfrontim me atë. Telashja e parë është jo aktiviteti në veri. Ata nuk janë aktiv në veri dhe sot është shancë e mirë që t'i ftojme që të jenë më aktiv në veri. Dhe, e dyta kanë telashe me neutralitetin përballë statusit të Kosovës dhe këtë duhet ta themi dhe, qendrat të vendimmarrjes të tyre në Bruksel shpeshherë u japin mesazhe mikse.

Unë e them publikisht dhe besoj kjo dihet, Qeveria e Kosovës nuk i jep urdhra as KFOR-it as EULEX-it. Ne koordinohemi me ta, bisedojmë me ata, kërkojmë nga ata që të bëjnë veprime, por nuk jemi urdhërdhënësit e tyre. Dhe, këtu duhet ta bëjmë një presion politik ndoshta më të madh, jo vetëm në KFOR dhe EULEX këtu që gjenden, por mbi të gjitha do të thosha në qendrat e vendimmarrjes në Uashington dhe në Bruksel. Çelësi i problemit është në Beograd dhe ky çelës i problemit duhet ta ketë presionin pozitiv nga Uashingtoni dhe Brukseli për të vendosur rendin dhe ligjin në vendin tonë. Kur e them këtë kam parasysh, Uashingtoni dhe Brukseli, Serbia po i ndihmon sipas tyre serbët e Kosovës në atë pjesë dhe unë jam i bindur po i ndihmon kriminelët në atë pjesë jo serbët. Se këto raporte Kosovë-Serbi reflektojnë edhe në marrëdhënie ndëretnike edhe pse ne kemi qenë dhe duhet të jemi të kujdesshëm që çdo raport i keq, çdo incident në raportet Kosovë – Serbi nuk duhet të reflektojë në të drejtat dhe pozitën e qytetarëve serbë të Kosovës.

Ajo çka dua të them është që ne duhet të punojmë më shumë në disa drejtime. E para, në vendosje të rendit dhe ligjit. Vendosja e rendit dhe ligjit ka akter KFOR-i, EULEX-i, Policia e Kosovës dhe këtu forcimi i kufijve të Kosovës, kontrollet e kufijve, zinxhirit komandues në Policinë e Kosovës dhe vendosjes së gjykatave që aspirojnë sistem unik, që aspirojnë ligje të njëjta të aplikueshme në tërë territorin e Republikës dhe që emërimi i gjyqtarëve dhe i prokurorëve bëhet nga Këshilli gjyqësor, respektivisht prokurorial i Kosovës. Kjo janë kushtet tona, ky është vullneti ynë dhe ky do të jetë dhe mbetet qëndrimi ynë i pandryshueshëm. Çka duhet të punojmë në këtë drejtim? Ne kemi emëruar gjyqtarë dhe prokurorë, unë po them që edhe dje Këshilli Prokurorial ka emëruar prokurorë për Mitrovicën. Ata njerëz janë të gatshëm, por ne nuk i dërgojmë pa u krijuar ambient i

sigurt për veprim. Dhe, ambientin e sigurt duhet ta kërkojmë po e them nga aktorët që kanë këtu edhe KFOR-i edhe EULEX-i edhe Policia e Kosovës.

Po ashtu, duhet të punojmë në legjitimitet demokratik. Në atë pjesë të vendit nuk ka zgjedhje demokratike, unë do të thosha kurrë edhe në kohën e Millosheviqit s'ka pasur zgjedhje demokratike edhe pas '99 nuk ka pasur zgjedhje demokratike dhe njerëzit që udhëheqin atje, qoftë që i përfaqësojnë edhe serbët sipas tyre, nuk kanë legjitimitet demokratik. Atje duhet t'i nxjerrim përfaqësuesit demokratik të serbëve të Kosovës, të cilët kalojnë përmes zgjedhjeve të lira demokratike që organizohen nga ne dhe faktori ndërkombëtar prezent në Kosovë. E treta, që është duhet ta implementojmë planin e pakos së Ahhtisarit dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Frika që Kushtetuta e Kosovës nuk është për serbët, nuk është frikë se Kushtetuta e Kosovës më shumë dhe plani i Ahhtisarit, më shumë se sa i ka dhënë të drejta shumicës, ka qenë e kujdesshme si ta barazojë ose ta ekuivalentojë pakicën. Dhe aty ka balancë unë e quaj etnike dhe gjeografike. Balancë etnik në të drejtat dhe nëse shikohen të drejtat me pakon e Ahhtisarit unë besoj që janë shumë më të mëdha, jo vetëm të shqiptarëve në Preshevë, shumë më të mëdha se kudo të minoriteteve apo të pakicave etnike apo sido që i quajmë në gjithë Evropën që sot jetojmë.

Dhe e dyta, duhet të jemi shumë të kujdesshëm në veprimet që i marrim në implementim. Hapat në implementim ne duhet t'i marrim, do të jemi të pandalshëm, kriminelët do të vihen para drejtësisë herët ose vonë e drejtësia mund të jetë më e ngadalshme mund t'i duket dikujt, por një ditë ata do të vihen para drejtësisë. Hetimet që po bëhen jo vetëm për rastin e Selver Haradinaj, por edhe hetimet e tjera, një ditë do t'i ballafaqojmë para drejtësisë dhe drejtësia do të dominojë edhe në raport me Kosovën, në raport edhe me të tjerët dhe askush prej neve nuk duhet t'i frikësohet logjikës se një ditë do të veprojë atje. Për çka jemi të kujdesshëm, besoj pozita dhe opozita, na intereson shumë suksesi dhe çelësi i suksesit është koordinimi në veprimet tona dhe veprimet tona nuk mund ta arrijnë veriun pa u sfiduar, asnjë prej neve s'duhet të krijojë iluzion që do të fitohet autoriteti mbi...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Dhe, një minutë!

HAJREDIN KUÇI: ...Nuk mund të arrijmë sukses në veri pa u sfiduar dhe këtë e dimë, në institucione, në partitë politike, qytetarët, por nuk duhet të sfidohemi nëse nuk e fitojmë garën. Dhe unë besoj që sfida duhet të jetë e koordinuar në mënyrë që rezultati në fund të jetë pozitiv. Faleminderit, për vëmendjen!

KRYESUESI: Faleminderit!

Replikë zoti Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Nja tri çështje për shkak se iu referua fjalës sime zëvendëskryeministri. Katër vjet pasi kanë ardhur në pushtet kanë nis me i identifikuar problemet, por ky identifikim është i njëjtë sikur gazetarët që e bëjnë, në gazetë i lexojnë këto që na thënë edhe krejt kjo është: "blla, blla, blla" veç me fol.

Çështja tjetër është se po akuzohet Beogradi, edhe njëherë po ju them, po Kosova sot në botë duket shumë më keq se Beogradi, për shkak të korrupsionit dhe krimit të organizuar të Qeverisë, e Beogradi duket më mirë, e ata i paskan fajet se ne jemi kështu.

Edhe e treta, unë nuk e di a ka zoti Kuçi problem me amnezinë a çka ka, po të enjten që shkoi, domethënë, para gjashtë dite, në televizion thirri për t' i dërguar forcat policore në veri e sot po na thotë s'bën t' i frikësojmë qytetarët serbë. A është duke mbajtur mend çka po flet, a unë nuk e di? Faleminderit!

KRYESUESI: Hajredin Kuçi, kundër replikë.

HAJREDIN KUÇI: Shiko, zoti Gjini unë mendova që po flet si në Kuvend, por nëse flet si në rrugë, unë edhe unë di të flas si në rrugë edhe pse s'ma lë kultura ime të flas ashtu.

Ajo çka dua të them, memorien e kam bukur të zhvilluar dhe besoj që jam i gatshëm ta mat kapacitetin e inteligjencës. Në anën tjetër mendoj që duhet ta kem parasysh, pyetjen nëse duam ta fajësojmë njëri-tjetrin pse se kreve zoti Gjini kur ke qenë në Qeveri dhe unë sot s'isha marrë me veri? Qysh i ke kryer do punë tjera është dashur ta kryesh edhe atë. Dhe, unë po e them ajo çka është me rëndësi, unë po e them e kam thënë edhe atë ditë dhe besoj merre, unë kam thënë që nuk përjashtohet asnjë veprim... por gjithmonë duhet të jemi të kujdesshëm që nuk duhet t' i trembim qytetarët tanë atje dhe logjikën e dikujt që t' i frikësojmë qytetarët nuk duhet ta përdorim, por logjikën që t' i frikësojmë shkelësit e ligjit duhet ta përdorim. Dhe, kudo që gjenden shkelësit e ligjit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Enver Hoxhaj.

ENVER HOXHAI: Faleminderit!

I nderuar, zoti kryesues,

I nderuar zoti kryeministër,

Zëvendëskryeministra, ministra,

Shumë të respektuar deputetë,

Besoj që zëvendëskryeministri Kuçi i tha dhe elementet kryesore të qasjes së Qeverisë sa i përket veriut.

Unë desha t' i ndaj po ashtu disa elemente të qasjes tonë si Qeveri së bashku me ju. Së pari dua të them që kur sot dëgjoj për sulmet e ashpra ndaj Qeverisë së Kosovës, për gjendjen në veri të Kosovës, krijohet një përshtypje se kjo Qeveri e sotme e ka krijuar problemin. Mendoj që kjo nuk është e drejtë. Veriu i Kosovës ka qenë problem i të gjitha qeverive, është problem dhe i kësaj Qeverie, por ne e dimë që Veriu i Kosovës është rezultat i politikës ndërkombëtare pas çlirimit të Kosovës, në qershor të vitit '99 dhe e gjithave mandateve ndërkombëtare që kanë qenë deri më tash të pranishme në Kosovë.

Së dyti, dua të them që padyshim që ka qenë gabim i të gjitha qeverive që është dashur të insistohet më shumë edhe sot mendoj që duhet të insistojë edhe Kuvendi edhe Qeveria në

institucionet tona shumë më shumë. Por, përveç kësaj mendoj që përgjegjësia kryesore për situatën në veri, përveç institucioneve tona, është e KFOR-it, është e EULEX-it dhe ne duhet të insistojmë në partneritet të ngushtë me KFOR-in dhe me EULEX-in për punën që nuk e kanë bërë për disa vite, realisht ta jetësojmë në muajt e ardhshëm.

Së treti, dua të them që kjo Qeveri dallon prej të tjerëve, prej qeverive pararendëse, sidomos me vendimin dhe me faktin që është krijuar me 25 korrik të vitit 2011 dhe që situata që është krijuar në korrik të vitit të kaluar është një situatë ku mbi të gjitha e ka hequr një dilemë në rrafshin ndërkombëtar. Ju e dini që ka pasur debate të shtruara sa i përket pozitës së veriut karshi shtetit të pavarur të Kosovës. Me vendosmërinë e Qeverisë njëherë e përgjithmonë dilemat rreth ndarjes së Kosovës, rreth kufirit të Kosovës, të pjesës veriore janë hequr njëherë e përgjithmonë. Dhe, po ashtu ka pasur debate dhe ka debate sa i përket dialogut teknik. Unë ju lus që jo vetëm ta shihni marrëveshjen për menaxhimin e integruar të kufirit e cila edhe në Bruksel edhe jashtë Evropës, interpretohet si marrëveshje ndërshtetërore për përcaktimin e vijës kufitare, marrëveshje legale.

Dhe nëse ne i kemi parasysh që konflikti për Kosovën dhe lufta për Kosovën që 100 vjet ka qenë një konflikt për territor, kjo marrëveshje njëherë e përgjithmonë e ka qartësuar sovranitetin e brendshëm të Kosovës deri në këto pika kufitare. Një çështje të katërt që dua ta ngrit është që s'ma merr mendja që në 2012 kem nevojë për eufori edhe për emocione, përkundër asaj që situata është shumë e ndjerë në veri. S'ma merr menja që kemi edhe nevojë për zhgënjim se në këto 23 vjet të emancipimit të Kosovës përmes mjeteve politike, përmes mjeteve diplomatike, përmes formave të ndryshme të rezistencës dhe së fundi luftës kem arritur që ta pavarësojmë Kosovën.

Dhe, dua të dal tek çështja 5. Ka pasur debate dhe ka debate a duhet të përdoret forca në veri? Çka nënkupton fjala “përdorim i forcës në veri”? Unë mendoj që gjithë ne duhet të bëjmë përpjekje që të instalojmë institucione demokratike në veri. Nuk duhet të bëjmë përpjekje që përmes kërcimit të forcës, këtu nuk flas për rend dhe ligj, këtu nuk flas për krim të organizuar, por këtu flas për atë se si ta shtrijmë sovranitetin në formë demokratike dhe se si realisht t'i bindim qytetarët e veriut të Kosovës që ta jetësojmë atë se çfarë ne e kemi arritur në vitin 2008-2009 brendapërbrenda territorit të Kosovës.

Mendoj që struktura ilegale-paralele në vitin 2008-2009 ka pasur edhe brenda territorit të Kosovës, prandaj neve na vyen që ta jetësojmë qasjen e njëjtë, planin e njëjtë, është fjala për planin e Ahtisarit dhe ta kem vendosmërinë e njëjtë, durimin e njëjtë, po t'i kemi edhe metodat e njëjta se si ta integrojmë këtë pjesë të Kosovës.

Më lejoni të përfundoj dhe të them që veriu është çështje e interesit kombëtar dhe sigurisë kombëtare dhe në këtë drejtim duhet të kemi koordinim shumë më të ngushtë dhe unë me shumë vëmendje sot do të dëgjoj për të gjitha sugjerimet që do të dalin prej këtij Kuvendi. Por, veriu nuk guxon të jetë një territor dhe një arenë e ballafaqimeve të partive politike në Prishtinë. Për sa i takon veriut duhet ta kenë një preokupim të përbashkët, por në të njëjtën kohë veriu është një problem i Kosovës, por nuk është vetëm i Kosovës. Stabiliteti i brendshëm në Kosovë, por edhe arkitektura e sigurisë, e paqes dhe e stabilitetit në rajon varet prej asaj se si do të adresohet integrimi i veriut. Prandaj, çfarëdo që mendojmë ne duhet ta kemi parasysh një gjë, duhet të jemi të vendosur ta integrojmë veriun dhe çdo integrim duhet të ndodhë edhe me përkrahje të gjitha institucioneve në Prishtinë.

Por, në të njëjtën kohë duhet ta ndërtojmë edhe besimin tek komunitetet pa të cilin besim, besoj që do të kenë vështirësi edhe më tutje që ta integrojmë veriun si të tillë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Vehapi.

IDRIZ VEHAPI: I nderuar, zoti kryesues,

I nderuar, zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Pjesa veriore e Kosovës është bërë vatër e grupeve dhe strukturave kriminale serbe.

Këto struktura kriminale në veri bashkë me segment të Qeverisë serbe dhe disa grupe të opozitës në Serbi, vazhdojnë të hartojnë secili veç e veç plane e strategji që lidhen me krimin, për t'u pasuruar në aspektin material në radhë të parë dhe për të fituar kohë për realizimin e qëllimit të tyre të fundit e i cili është ndarja fizike e kësaj pjese të territorit të Kosovës. Këto struktura kriminale të ndihmuara nga Qeveria serbe e Beogradit, janë duke përdorur mjete dhe strategji nga më të ndryshmet për të sfiduar institucionet e shtetit të Kosovës dhe ato ndërkombëtare, për vënien e rendit dhe ligjit në atë pjesë të vendit duke mos përjashtuar edhe terrorizimin e popullsisë si metodë për realizimin e qëllimeve të tyre.

Kështu ndodhi edhe në rastin e fundit kur u tentua të vritej një familje e tërë me ç' rast humbi jetën kryefamiljari i saj Selver Haradinaj, dhe të gjitha këto po ndodhin në kohën kur Serbia po merr sinjale për të hyrë në Bashkimin Evropian. Për të mos ndodhur këto ngjarje të tilla të frikshme të rezultuar me marrje jetësh të qytetarëve dhe shkatërrimin e pronave të tyre, duhet marrë masa adekuate nga mekanizma përkatës, përgjegjës të sigurisë. Në këtë kontekst organizmat ndërkombëtarë të sigurisë dhe ata monitorues, si: KFOR-i, UNMIK-u dhe së fundi EULEX-i, konform mandatit që kanë dhe duke qenë një mbështetje e institucioneve të Kosovës për vendosjen e ligjshmërisë, do të duhej që në bashkëkoordinim të mos toleronte që në fillim dhe në vazhdimësi veprimin e këtyre strukturave kriminale, të cilat edhe më tej vazhdojnë t'i mbajnë peng të gjithë qytetarët e asaj pjese të vendit duke i penguar ata që t'i kthehen realitetit të ri të krijuar siç ka ndodhur tanimë në pjesë të tjera të shtetit të Kosovës. Kjo mjegullnajë e vazhdueshme duke mos mundësuar vendosjen dhe zbatimin e rendit dhe ligjit, është një konsekuencë që e bën situatën shumë të ndërlikuar dhe skeptike për një zgjidhje të shpejtë.

Kujtojmë, se këto struktura reagimin më të egër e kanë kur hetojnë se po punohet drejt një kontrolli të gjithanshëm, në atë pjesë të vendit e veçmas në pikat doganore duke e parë këtë si një kërcënim të madh për përfitimet e tyre. Prandaj, në këtë gjendje pezull veriu i Kosovës vijon të terrorizohet për interesat të grupeve kriminale dhe atyre të Qeverisë së Serbisë, të cilat përfitojnë nga kjo situatë.

Të nderuar deputetë,

Të gjithë e dinë se karshi kësaj situatë klasa politike kosovare në të gjitha mandatet e qeverisjes ka qenë me mandat të kufizuar për të vendosur stabilitet në këtë pjesë të territorit dhe për t'i bërë funksional të gjithë sektorët institucional atje. Mirëpo, prapëseprapë në kontinuitet janë bërë

përpjekje në fushën e konsolidimit dhe zhvillimit të strukturave të gjyqësisë e sigurisë në atë pjesë. Përveç kësaj, institucionet vendore edhe përkundër problemeve të shumta që ekzistojnë në këtë pjesë, kanë me investuar në shumë projekte që ndërlidhen direkt me jetën e qytetarëve.

Por, përkundër kësaj hapat që ka hedhur Qeveria reflektojnë mënyra të ndryshme të banorët serbë dhe shqiptarë të asaj pjese, në njërën anë dhe tek strukturat kriminale në anën tjetër. Kjo është kështu, sepse qasja e këtyre strukturave kriminale karshi kësaj pjese të vendit, është ndarja e jo integrimi, është konflikti e jo paqja dhe shumë veprime tjera luftënxitëse. Paralajmërimet dhe veprimet e vazhdueshme të këtyre strukturave duke vrarë dhe terrorizuar qytetarët dhe duke sfiduar institucionet e shtetit të Kosovës dhe ato ndërkombëtare të sigurisë janë një shenjë se ata po testojnë fuqinë e tyre për të vazhduar me kontrollin mbi këtë pjesë të vendit. Në anën tjetër, pamundësia për t'i zgjidhur siç duhet veprat penale në atë pjesë vijon të pengojë të drejtën e viktimës për të kërkuar drejtësi. Kjo ka një efekt serioz mbi sundimin e ligjit në rajon dhe dëmton rëndë besimin e qytetarëve në zbatimin e ligjit dhe efikasitetin e sistemit të drejtësisë, por ne duhet besuar se shpejt dhe përfundimisht do t'i thuhet stop anarkisë dhe kaosit edhe në këtë pjesë të vendit duke i zhbërë strukturat kriminale dhe në vend të tyre të vendosen institucionet demokratike, të cilat punën e tyre do ta bazojnë në sundimin e rendit dhe ligjit.

Kjo mund të arrihet përmes një strategjie të përbashkët të institucioneve vendore dhe atyre ndërkombëtare.

Të nderuar deputetë,

Kushtetuta dhe ligjet e Kosovës janë të vetmet autoritete legjitime dhe funksionale në tërë territorin e shtetit tonë dhe ne do të duhej që për mbrojtjen e këtij parimi kushtetues të punojmë kurrë pa u ndalë. Në këtë kontekst çështja e demilitarizimit ose e ndalimit të funksionimit të strukturave paralele në të gjitha fushat në veri të Kosovës, është çështje që ndërlidhet me Kushtetutën. Të gjitha këto duhet të kryhen në bashkëpunim me mekanizma relevantë ndërkombëtarë, të cilët kanë punuar dhe punojnë në procesin e shtet formimit dhe shtet ndërtimit të Republikës së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Zoti Hamiti e ka kërkuar fjalën. Osmani.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryesues që me sharm po e udhëheq mbledhjen.

Zotni kryeministër,

Ministra të Qeverisë së Republikës së Kosovës,

Kolegë deputetë,

Më së pari unë duhet t'ju them këtu Kabinetit qeveritar dhe kolegëve që nuk e dinë çka bisedohet në Kryesinë e Kuvendit të Republikës së Kosovës, qëkur është paraqitur kërkesa nga "Vetëvendosja" që të bëhet një seancë e jashtëzakonshme, unë kam qenë "kundër" seancës së jashtëzakonshme. Sepse, kam menduar që për këto probleme kemi biseduar kaq shumë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, kemi kaq dokumente të nxjerra që ne mund të bëjmë seancë të zakonshme, veçse do të varet çfarë do të prodhojmë me atë seancë. Mirëpo, nën ndërkohë është partia që krijon shumicën që e ka marrë atë ide, ta quaj unë tash dhe e ka bërë vepër dhe e ka bërë tash partia e dytë, seancë të jashtëzakonshme. Tash unë kam menduar

që dhe tash mendoj kur partia në pushtet ose partitë që krijojnë shumicën në pushtet thërrasin seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës, absolutisht ata kanë për të thënë diçka të jashtëzakonshme, ata kanë për të propozuar diçka e cila është interes i përgjithshëm i vendit dhe e cila duhet të kërkojë pëlqim në Parlament.

Unë e kuptoj edhe sot këtu, edhe para se të fillonte mbledhja, prandaj në mënyrë shumë të kujdesshme u përpoqa të dëgjoj mendimin e shumicës që e ka kërkuar seancën e jashtëzakonshme, çfarëdo të jetë, i cili nuk ishte i artikuluar në emër të kryetarit të Grupit, përveçse një artikulum teknik qysh është thirr mbledhja, prita Qeverinë dhe normalisht dëgjova nënkryetarin e Qeverisë, i cili foli për programin e Qeverisë, për çështjen në fjalë dhe prapë mbas gjithë këto dëgjimeve, prapë nuk jam i bindur që ka qenë e domosdoshme që të thirret dhe të quhet e “jashtëzakonshme”.

Pse? Sepse, unë kam me vete katër dokumente që i ka nxjerrë në një hark kohor prej një viti Kuvendi i Republikës së Kosovës, që kanë të bëjnë ose me raportet me Serbinë, ose me raportet me Serbinë duke e pasur ndërmjet po e quaj unë situatën në veri. Pra, i pari është më 10 mars 2011 që ka të bëjë me kërkesën për bisedimet, i dyti është më 28 korrik 2011 që ka të bëjë me çështjen e respektimit të masave të reciprocitetit dhe ka të bëjë me kufijtë në veri, i treti është i 15.2.2012 që ka të bëjë me referendumin jo të ligjshëm në veri, që ju e dini është referendum për mos ta njohur Kosovën dhe i katërti dokument është më 15.3.2012, që ka të bëjë me zgjedhjet joligjore që do t'i bëjë Serbia në Kosovë. Pra, të gjitha këto dokumente në kuptimin e formulimeve nuk kanë vërejtje, të gjitha këto dokumente nëse nuk janë bërë me shumicën e cilësuar me 80 deputetë, por me shumicë janë bërë, bile tri prej tyre janë me 80, që i bie që ka pasur konsensus total në Kuvend nga ana e deputetëve në këto kërkesa.

Pra, çka do të pritsha unë sot? Unë sot do të pritsha që Qeveria të tregojë çfarë është realizuar nga këto katër dokumente, çfarë nuk është bërë dhe do të bëhet prej sot e tutje dhe kërkon votë në Kuvend? Unë mendoj që ka çfarë të diskutohet çfarë është bërë rreth këtyre, por Qeveria nuk e mori mundin deri tash, unë nuk e pashë dhe çka do të bëhet as këtë nuk e pash, veçse dëgjova dy refleksime që kurrë nuk i kam dëgjuar këtu në Kuvend më qartësisht të thëna, njërin nga kolegu i SLS, Miletqi, i cili e tha shkoqur në njëjës: “problem politik është Veriu i Kosovës” tha Miletqi, dhe të tjerat i tha në shumës: ka problem për ujë e për bukë e për tjera. Në këtë formë nuk e tha zëvendëskryeministri Kuçi, po e tha pak të zbutur që pak a shumë është derivat i saj, ekziston perceptimi atje, pra në veri që ky është një problem politik. Atëherë, ne jemi në situatën e ridefinimeve të mëdha të veprimeve politike dhe institucionale, sepse po na tingëllon në vesh ditë e përditë që ky është një problem që do zgjidhur në vazhdim bisedimesh dialogu, bile në nivele të tjera dhe ky tingëllim, herë vjen nga afër, herë vjen nga larg, po duket që po troket këtu dhe ky tingëllim është në kundërshtim me rezolutën e votuar për bisedime që ka kaluar më 10 mars 2011.

Kjo i bie që po u kërkuar kjo dhe po ndodhi, ky Kuvend dhe kjo Qeveri rishtas duhet të mblidhet dhe të diskutojë dhe të debatojë dhe të vendosë për këtë, po meqë jemi këtu unë menjëherë po jap mendimin për bisedimet. Unë mendoj që me Serbinë, bisedime nuk duhet të bëhen më as për veriun, as për jugun, as për lindjen, as për perëndimin, faktikisht për asgjë, sepse ato që janë marrë si konkludime deri tash nuk janë zbatuar asnjëra, nën një, dhe nën dy, pa ndodh këto dhe pa bërë atë që ajo mund ta bëjë fuqishëm, t'i tërheqë strukturat e veta që dikush u thotë “kriminale”, “paralele”- ato janë struktura shtetërore të Serbisë në territor të Kosovës, s'ka çka bisedohet dhe këtu, kjo besoj mund të merret dhe përfundim që sot nga ky Kuvend.

Dialog po, por do kushte, u pa që pa kushte s'mbërrihet gjë, sepse edhe ai që deklarohet nuk ndodh, atëherë Serbia mund të mos i mbajë më strukturat shtetërore të veta në territor të Republikës së Kosovës. E dyta është çështja e kufirit, të definohet ç'është kufi. Ne kemi biseduar edhe Bruksel edhe është thënë: "është bërë një dokument për atë që quhet kontroll i përbashkët i kufijve-menaxhim kontroll" mirëpo, ne na del Cooper i cili thotë, këto ditë thotë: "ngadalë se ai dokument nuk është nënshkruar nga Serbia, nuk është pranuar faktikisht ai". Është një ide interesante, por s'është pranuar. Prandaj, s'ka shanse të zbatohet nëse s'është pranuar- e ka thënë Cooper, këtu nuk është thënë te ne, njëri prej problemeve. Pra, çka është kufi më së pari, kush rri në atë kufi sot? Se kjo është elementare, nëse në kufirin e Kosovës nuk rrinë njësitë që e ruajnë kufirin dhe e cilësojnë si kufi shtetëror, të tjerat janë variacione të biseduarit.

Pra, definimi shtetëror i kufirit të Kosovës dhe kush rri atje. Është çështja e dytë vendimtare e cila i derivon problemet tjera, se po të ruhet kufiri shtetëror në veri gjitha problemet brenda relativizohen dhe bëhen probleme qytetare, nuk bëhen probleme shtetërore, as politike. Unë dëgjova nga ministri një frazë që më gëzoi shumë, Bajram Rexhepi e tha: "Policia e Kosovës ka kapacitete për ta mbrojtur jetën e njerëzve në veri". Bravo! Pse s'po e mbron është pyetja ime? Dhe, s'kam koment më tutje. Është shumë mirë që e ka dhe më ke gëzuar shumë, unë po them- pse atëherë s'mbrohet? Të lutem, edhe një minutë ma fal zoti kryesues ose ma fal dikush, sepse unë dua ta përfundoj këtë ide që e kam për bisedime këtu që jemi sot.

Unë e përgëzoj kryeministrin që ka ardhur prej Amerikës dhe e ka bërë një vizitë të suksesshme institucionale në Amerikë dhe unë i them, jam ai që kam thënë që nuk duhet të bisedohet, as seancë të zakonshme, as të jashtëzakonshme, për të gjitha këto probleme pa e pasur kryeministrin dhe Qeverinë, sepse është ekzekutivi i këtij vendi i cili i ka përgjegjësitë më të mëdha institucionale... (Ndërprerje incizimi nga regjia)

KRYESUESI: Edhe një minutë, ju lutem.

SABRI HAMITI: ... zëvendësin e kryeministrit, Kuçin, kam dëgjuar edhe publikisht deklarin e Kuçit që "do të mund" thotë, të ketë edhe aksione si i 25 korrikut. Unë nuk paragjykoj asgjë, le të ketë aksione të domosdoshme kushtetuese, ligjore të gjitha, veçse le të maten dhe ajo që e tha ky unë mund ta përkthej, mos të bëhet beteja apo do të na ndodh fitorja, nën një, edhe nën dy mu nga kjo që ka ndodhur deri tash unë jam pak edhe i trimëruar edhe me kryeministrin, sepse nuk ka dhënë sot fjalë të mëdha edhe kjo më trimëron se janë empirikisht 2-3 herë kur kemi dëgjuar fjalë shumë të forta, ne kemi pasur momente jo të mira mbas tyre.

Domethënë, na është përmendur "Molla e Kuqe" ata erdhën te "Dardha e Kuqe" edhe i morën njerëzit... Nuk është në rregull ajo...

(Ndërprerje incizimi nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit!
Fjalën e ka deputetja Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Situata në veri veçanërisht ajo e ditëve të fundit ka merituar një vëmendje më të madhe si nga ana e Kuvendit ashtu edhe nga ana e Qeverisë.

Për vetë fakti që institucionet e Kosovës reagojnë me 10 ditë vonesë është një tregues i seriozitetit të tyre. Si duket këtë lloj serioziteti kanë parasysh edhe ata që e mbajnë të pushtuar atë pjesë të territorit që organizojnë dhe kryejnë akte terroriste, si ai ku mbeti i vrarë Selver Haradinaj, por që për fat fëmijët e tij shpëtuan edhe pse ishin në të njëjtën dhomë me të. Qëllimi ishte për t'i vrarë të gjithë. Ky në fakt është një seriozitet inkurajues për ata që i bëjnë këto krime. Ishte aq cinike sjellja në seancën e shkuar kur deputetët, përfaqësuesit e popullit me vetëdije të plotë injoruan realitetin, një realitet që do të duhej të shtrihej përtej interesave të ngushta partiake, përtej frikës që dikujt i ngjallë dëshirën të fshihet poshtë karrigeve e të heshtë në pritje që dikush tjetër të dalë e të flas i pari.

Për mua është e pakuptueshme e gjithë kjo qasje nga ana e Kuvendit të Kosovës, pasi që për Qeverinë dihet ajo është e deligjitimuar dhe të vetmin interes e ka pushtetin dhe privilegjet. Bile, mund të thuhet se kohët e fundit i kanë interes edhe shëtitjet, sepse vetë kryeministri nuk e ndërpreu as vizitën e fotografimeve në SHBA, ndërsa qytetarët e vendit që udhëheq vriteshin pabesisht dhe braktisnin shtëpitë e tyre.

Nga ana tjetër po kaq i pakuptueshëm mbetet për mua edhe reagimi i disa institucioneve ndërkombëtare këtu në Prishtinë, pas aktit terrorist. Përfaqësuesi i BE-së, ICO-së, OSBE-së, befas e kishin ndjerë veten shumë të emocionuar, të shokuar, të çuditur, e kushedi se çfarë përjetimesh të tjera. Mirëpo, asnjëri prej këtyre përfaqësuesve nuk ua zuri goja të dënojnë aktin e dhunshëm në familjen Haradinaj. Një sinkronizim apo jo mes tyre, por që do të thotë shumë. Para pak ditësh disa gurë u hodhën mbi makinat e një delegacionit të Serbisë, që kalonte në Prishtinë dhe reagimet erdhën nga ta, nga të katër anët. Prit, kur Serbia të ankohet në seancën e Këshillit të Sigurimit në OKB tani për këtë. Bile edhe ndërmjetësuesi i bisedimeve u bë i ashpër në dënimin e aktit, mirëpo si duket vrasësit e shqiptarëve për të nuk janë një motiv i mjaftueshëm për të reaguar.

Këto reagime asimetrike dhe të papërshtatshme të atyre që ne i konsiderojmë faktorë ndërkombëtarë, unë personalisht i shoh si vazhdimësi e një frymë të pasinqertë ndaj Kosovës. Kjo qasje është e hershme, në fakt qëkur u vendos të vihet kufiri i ndarjes shqiptaro – serbe tek Ura mbi lumin Ibër dhe vazhdoi me mbylljen e syve përball gjendjes së anarkisë e theksoj, gjendjes së anarkisë dhe të egër në veri të Kosovës. Egërsia po vjen duke u shtuar dhe me siguri autorët e kësaj situate do të inkurajoheshin edhe më shumë kur veprimet e tyre të paligjshme as nuk do të ndëshkohen e as nuk do të dënohen, qoftë edhe me fjalë.

Gjuha që flasim, të nderuar përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare, ka shumë rëndësi, ndaj gjithsecili le të bëjë kujdes me fjalët që për zgjedh pasi mund të rrënojnë atë që është ndërtuar me jo pak sakrifica në këtë vend. Argumenti tjetër ku dua të ndalem ka të bëjë me atë që unë do ta quaja: “paraliza e institucioneve ndërkombëtare në veri”.

Si pasojë e kësaj paralize, fantazia nacionaliste tashmë është bërë realitet atje. Me vite të tëra është pranuar e paligjshmja si metodë operimi normale. Situata ka shkuar aq larg sa abnormalja është kthyer në normale. Sot atje komandojnë: bandat, mbizotëron anarkia, dhunohet liria e qytetarëve,

funksionojnë struktura paramilitare, rrugët janë të bllokuara nga barrikadat, nuk ka liri lëvizje, vazhdon kontrabanda dhe së fundi kryhen edhe akte terroriste. A thua si do ta kishin menaxhuar secili nga shtetet e Bashkimit Evropian këtë situatë?! A do të lejonin që në shtetet e tyre përkatëse dikush të shpallë anarkinë dhe të marrë ligjin në duart e veta? Përgjigja e kësaj pyetje do të duhej të ishte edhe zgjidhja për situatën në veri të Mitrovicës, asgjë më shumë e asgjë më pak.

Kemi dëgjuar këto ditë deklarata se nuk duhet të përdoret forca në veri, dakord jam, forca nuk është as mjeti i parë dhe as më i miri. Në fakt ajo është e fundit, mirë do të ishte të mos përdorej kurrë, por cila është zgjidhja? Në të vërtetë as Qeveria e Kosovës e as Bashkimi Evropian që ndërmjetëson dialogun, nuk ka një ide për këtë. Shteti nuk mund të ndërtohet përmes tolerimit të krimit dhe as anarkisë. Së paku nga historia nuk më kujtohen ndonjë shembull i tillë, shteti ndërtohet përmes dhënies fuqi, politikave të ndryshme të brendshme dhe të jashtme. Këtë si duket nuk e ka kuptuar ende as Qeveria e Kosovës. Në fakt, ajo flet vetëm sa për spektakël, siç bëri dhe sot këtu. Ne kemi një zëvendëskryeministër që do të hyjë në histori si duket, për durimin e tij ndaj ngjarjeve në veri, bile si duket është më i durueshmi që prej kohës së Skënderbeut, apo jo zoti Kuçi? Çfarë do të duhej të ndodhte tjetër në veri, përveçse të vriten qytetarët e Kosovës që durimi juaj të marrë fund?

Kemi një kryeministër që nuk është në gjendje që prej pesë vjetësh sa është në pushtet të prodhojë një strategji, qoftë edhe të vetme. Po pret nga të tjerët se çfarë do t'i servirin në tavolinë. Kjo nuk quhet ndryshe veçse paaftësi dhe mungesë interesi. Sot Qeveria e Kosovës paguan miliona euro për këshilltarë e konsulentë të huaj, gjoja për projekte. Por, ende nuk i ka shkuar në mendje që këto para t'i shpenzojë në mënyrë më të vlefshme për ta bërë një strategji dalëse nga situata ku është zhytur veriu, pasi nuk ka asnjë problem që nuk ka zgjidhje. Unë nuk besoj që kjo situatë nuk ka zgjidhje, por jam e bindur se mungon vullneti për ta zgjidhur. Pozicioni difensiv është karakteristikë e Qeverisë suaj, zoti Thaçi. Pranimi i gjithçkaje që iu vihet në tavolinë e që zakonisht janë pjesë e presionit që bën shteti serb tek bashkësia ndërkombëtare pasi e krijon realitetin në terren, tashmë është optionsi i vetëm i veprimit tuaj. Vetëm analizoni diskursin e fjalimeve të sotme të bëra nga Qeveria, flet në mënyrën dëshirore, flet në kohën e ardhme: “do të, duhet, mund”. Pse s'i keni bërë deri tani? Dhe, kjo nuk është për të qeshur zoti Thaçi, vrasja e qytetarëve në veri nuk është aspak për të qeshur.

Shikoni se si e keni ulur pazarin për zgjedhjet serbe, tashmë është pajtuar, jeni pajtuar që ato të përgjithshmet dhe zgjedhjet presidenciale të Serbisë të mbahen brenda territorit të Kosovës. Vetëm zgjedhjeve lokale u keni thënë: “jo”. Mirëpo, flisni edhe ju për të drejtën që kanë shtetasit, dyshtetësinë. Pra, kjo e drejtë qenka më e vlefshme se e drejta për sovranitet. Kushtetuta e Kosovës, sipas kësaj Qeverie, por edhe një pjese të bashkësisë ndërkombëtare na qenka një tryezë suedeze. Në logjikën e shtet ndërtimit, por edhe të marrëdhënieve ndërkombëtare, kjo nuk është e pranueshme, mirëpo kjo vlen për ata që i kuptojnë këto koncepte, për ata që nuk i kuptojnë edhe anarkia është normalitet.

Qeveria e Kosovës është në gjendje të shkelë institucionet e vendit, vetëm sepse nuk di ta argumentojë të vërtetën dhe nuk di të ofrojë opsione për zgjidhje dhe e vërteta është se që prej shpalljes së pavarësisë, Kosova nuk po mundet ta realizojë të drejtën për sovranitet që është thelbësore për një hapësirë politike e cila quhet shtet. Faleminderit!

KRYESUESI: Replikë, zoti Kuçi.

HAJREDIN KUÇI: Mbasi ma përmendi emrin zonja deputete Lama, e para fillimisht po them për çështjen e durimit, për këtë epitete nuk e ndej veten keq, por mos po preken LDK-ja. Në anën tjetër, nëse e merr durimin si pafuqi, ndoshta është çështje e perceptimit tuaj, por unë personalisht e marr durimin si mençuri edhe urtësi.

Dhe nëse e vëni në peshore durimin dhe budallakinë, unë e zgjedh të parën. Faleminderit!

KRYESUESI: Kundër replikë, një minutë deputetes Lama.

ALMA LAMA: Ka edhe një option të tretë, zoti Kuçi. Ky padurim është, përkthehet në paaftësi dhe atë e keni dëshmuar deri tani. Fjalë ka plot, mirëpo asgjë. Realiteti është që ju nuk keni bërë asgjë, prandaj thashë: analizoni fjalimet tuaja sot, flisni në kohën e ardhme: “duhet, mund, do të, bëjmë presion” këndej-andej, pse s’e keni bërë deri tani? Jeni në pushtet para shpalljes së pavarësisë, por le ta marrim nga momenti i shpalljes së pavarësisë. Nuk keni ide, pra kjo është ideja dhe s’keni as vullnet.

KRYESUESI: Faleminderit!

Okej, merre fjalën, për replikë zoti Hamiti.

SABRI HAMITI: Zoteni Kuçi, hiç nuk ka vjen keq, as turpërohemi, nëse cilësohemi me durimin. Durimi është aleat i mençurisë, i urtisë. Nuk është asgjë e keqe, fundi i fundit është pak paradoksale, por është edhe moderne, mbrojtja është sulmi më i mirë.

KRYESUESI: Kundër replikë, zoti Kuçi.

HAJREDIN KUÇI: Profesor, të falënderoj shumë, veç më vjen keq pse s’fole para meje t’i tregosh Almës.

KRYESUESI: Edhe njëherë po i lus gazetarët, respektivisht këta që kanë fotoaparartet, mos t’i përdorin me blic në sallë, sepse po na pengojnë. Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Blerim Shala.

BLERIM SHALA: I nderuar, kryesues!

Kabinet i Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

Njëra prej temave kyçe politike në Kosovën e sotme që na shfaqet si komprometuese, si akuzuese, si dëftuese i një tjetër dështimi në këtë politikën kosovare-institucionale, është veriu i Kosovës.

Por, veriu i Kosovës kështu si është sot na flet objektivisht të gjithë neve këtu në Kuvendin e Kosovës, të gjithë politikës kosovare dhe na tregon se çka jemi ne sot si politikanë dhe çfarë bëjmë ne, a nuk bëjmë ne si politikë e Kosovës në ballafaqimin me veriun e Kosovës, ku mbrohet integriteti i Republikës së Kosovës, ku synohet integrimi i kësaj pjese të vendit në rendin

kushtetues e ligjor, ku do të shfaqet së shpejti fati final i propozimit të presidentit Ahhtisari, ku do të kuptohet se çfarë shteti do të jetë në fakt Kosova, ku do të merret vesh a ka fare integritet politika kosovare dhe çfarë çmimi do të paguhet atje për komprometimin e gjithfarshëm politik të Qeverisë së Kosovës?

Se çfarë çmimi do të paguajmë këtu nuk ka dyshim fare, faturat e gabimeve të mëdha që janë bërë atje edhe prej nesh e jo vetëm prej faktorit ndërkombëtar na kanë ardhur tashmë për shlyerje. Do të bëjmë sot kështu debat në Kuvendin e Kosovës, do të flasim duke bërë garë se kush është më i forti këtu në këtë sallë e të gjithë së bashku jemi të dobët atje në veri, do të përpiqemi që mungesën e fuqisë dhe të organizimit shtetëror ta kompensojmë me zjarrminë e fjalëve tona, do të synojmë që mungesën e planeve të qarta se si duhet mbyllur këtë çështje ta zhbëjmë me hapjen e polemikave të çdollojshme politike në vend të racionalitetit dhe pragmatizmit të matur të shihemi të veshur me emocione dhe patetikë të lirë politike.

Po çfarë mund të bëjmë ne në veri dhe për veriun e Kosovës? Para se gjithash mund të flasim të vërtetën për veten dhe për veriun e Kosovës. Veriu, pos tjerash është edhe viktimë e mashtrimeve dhe gënjeshtreve të shumta, iluzione të cilat me bollëk janë prodhuar prej Qeverisë së Kosovës thuaja që nga dita kur Kosova është bërë shtet i pavarur, më 17 shkurt 2008. Qeverisë së Kosovës nuk mund t'i falet dot krijimi i vazhdueshëm i iluzioneve për veriun dhe në veriun e Kosovës. Për shembull, për Qeverinë e sotme deri vonë nuk ka pasur fare problem të veriut të Kosovë, ishte ky një iluzion i madh. Për këtë Qeveri më 25 korrik të vitit të kaluar ka ndodhur integrimi i veriut të Kosovës, është ky një iluzion tjetër i madh.

Për këtë Qeveri, më 15 shtator të vitit të shkuar ka nisur të funksionojë ashtu si duhet kufiri midis Kosovës dhe Serbisë në portat 1 dhe 31, edhe ky është një tjetër iluzion i madh. Kjo Qeveri, sot e kësaj dite temën e veriut e trajton kalimthi, pa një plan të qartë se çka duhet bërë atje, me shumë retorikë pseudopatriotike, me kërcime që po bën pa mbulesë reale, pa ditur se çka në të vërtetë e pret atje kur kjo çështje, siç po na paralajmërohet prej të gjitha anëve, edhe prej atyre që kanë marrë vulën tashmë si miq tonë ndërkombëtarë, do të hapet në tavolinën e bisedimeve politike.

Në një pyetje fare të thjeshtë dhe gjithsesi shumë të rëndë politike, si do ta bëjë kjo Qeveri integrimin e veriut të Kosovës, mund të marrim edhe sot në këtë seancë shumë përgjigje, por asnjëra nuk do të jetë kredibile, e qëndrueshme, e besueshme, shpresëdhënëse. Por në fakt jo vetëm kryeministri dhe ministrat e tij, por edhe shumë prej nesh kemi dëshirë disi t'i ikim përballjes sy më sy me veriun, me gjendjen reale atje, me potencialet ekzistuese të sigurisë dhe të politikës që e kemi, me perspektivën e bisedimeve për këtë pjesë të Kosovës, duke u kapur për parulla politike,

duke e përmendur opsionin e zgjidhjes me forcë, të cilin nuk e kemi aktualisht, duke u kotur disi në bindjen që Perëndimi apo së paku miqtë tanë të mëdhenj që i kemi, do ta bëjnë qarën edhe në këtë rast dhe që pa u dëmtuar fare, do ta vendosim rendin dhe ligjin edhe në këtë pjesë të Kosovës, edhe pse thënë hapur nuk mund të krenohemi që e kemi bërë namin edhe në pjesët tjera të Kosovës, kur bëhet fjala për rendin dhe ligjin.

Me qasjen e tanishme politike të Qeverisë së Kosovës, të institucioneve qendrore të vendit në përgjithësi, të politikës kosovare në përgjithësi, ne do ta vulosim humbjen e veriut, do të dëmtojmë pariparueshëm tërësinë funksionale të shtetit të Kosovës, qoftë edhe nëse do ta ruajmë

tërësinë territoriale të Republikës së Kosovës, do ta sjellim shtetin e Kosovës rreth humnerës në përcjellje të korit që do të vazhdojë t'i këndojë himne dështimit të madh politik.

Veriun e kemi secili prej nesh në ndërgjegjen tonë. Të gjithë ne në këtë politikën kosovare, e kemi si obligim dhe si detyrim të gjithë ne që besojmë në ardhmërinë e shtetit të Kosovës, por pa huqur assesi konkludimin që si përgjegjësi sipërore veriun e ka Qeveria e Kosovës, e cila qysh u pa edhe sot nuk e ka ndërmend të merret me të vërtetën e veriut, por me imazhin e vet të rrem për veriun dhe për Kosovën. Ju faleminderit!

KRYESUSI: Ju faleminderit!

Deputeti Gëzim Kelmendi e ka fjalën.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolege dhe kolegë deputetë,

Padyshim që situata aktuale në veriun e Kosovës, konkretisht Mitrovicës është shqetësuese, për të gjithë qytetarët e Kosovës. Aktet e fundit terroriste në fillim, në muajin korrik që pasohen me vrasjen e policit të Njësisë Speciale, Enver Zymberi dhe pastaj djegia e pikave kufitare, dhuna e vazhdueshme atje dhe së fundi vrasja në mënyrën më të ulët dhe më trishtuese për vet familjen e tij e shqiptarit Selver Haradinaj, të japin të kuptojmë se kemi të bëjmë me grupe terroriste të organizuara mirë, me banda kriminale që strategjitë e tyre kanë jo vetëm dëbimin e shqiptarëve, por edhe të gjithë komuniteteve tjera joserbe atje, duke përfshirë edhe boshnjakët, turqit dhe hashkallitë, egjiptasit dhe të tjerë, që një fund do të ketë një rezultat pastrimin etnik të asaj ane çka edhe rezulton vetëm në shifra statistikore, në kohë të fundit që vërejmë një numër shumë të vogël proporcional në krahasim mes shqiptarëve dhe serbëve që jetojnë në atë anë.

Duhet të jemi realist se kjo situatë në veriun e Kosovës nuk i përshtatet askujt dhe askush nuk e dëshiron. Njëherit, të gjithë e dimë që në këtë pjesë të Kosovës nuk po respektohet Kushtetuta e Kosovës, nuk po respektohet sovraniteti i Kosovës, integriteti territorial, nuk po respektohen institucionet policore dhe institucionet doganore të Kosovës, çka do të thotë se kemi mungesë të respektimit të rendit dhe të ligjit. Njëherit shkalla e pasigurisë ka kaluar çdo nivel.

Qytetarët jo serbë të asaj ane, janë duke përjetuar atë çka ne para viteve '99 e kemi përjetuar. Por, duhet ta pranojmë edhe një fakt se aktualisht ne ende jemi të pafuqishëm në zbatimin e rendit dhe të sigurisë në atë anë, ende jemi të pafuqishëm në zbatimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, andaj përgjegjësie në atë anë, pjesë të Kosovës bie mbi të gjithë neve si qytetarë të Kosovës jo vetëm mbi një parti apo mbi një qeveri të caktuar. Njëherit duhet të jemi më koshient, më syçelë për ballë të gjitha këtyre sulmeve të orkestruara dhe kriminale që shpeshherë po e kanë mbështetjen e strukturave udhëheqësve të Beogradit dhe në veçanti të ministrit të Punëve të Brendshme, i cili me mburrje edhe me një nostalgji për ish- regjimin e Millosheviqit, krenohet me arrestimet e fundit ndaj shqiptarëve të Kosovës, si masë reciprociteti ku së fundi pasuan edhe me arrestimin në vetë tokën e Kosovës të dy pjesëtarë të Policisë së Kosovës.

Ne nuk bëjmë dhe nuk guxojmë që në asnjë moment të bimë në nivelin e tyre për faktin se ne e kemi zgjidhur një rrugë, rruga jonë është e qartë, rruga jonë është integrimi në Bashkimin Evropian, për këtë kemi edhe mbështetjen e miqve ndërkombëtarë. Për atë arsë çdo akt i ulët i cili ngjason me aktet e Serbisë, vetëm do të na degradojë dhe do të na stopoj mbrapa nga jemi nisur. Por një gjë, në anën tjetër duhet ta kemi parasysh se nuk bënë të jemi latent, të lejojmë veten të bimë në gjumë se tjetërkush punon për aktin tonë dhe për ardhmërinë tonë, por duhet që me mençuri edhe në koordinim me miqtë tanë ndërkombëtarë, të kontribuojmë në zgjidhjen e kësaj krize politike.

E them politike, nga se çështja e veriut, është çështje politike. Njëherit duhet t'i japim një mesazh të qartë se problemi i Mitrovicës nuk është vetëm problem i Kosovës, por është problem kombëtar bile- bile problem ndërkombëtar. Unë mirëpres që nga kjo seancë të nxjerrim një përfundim, një mesazh të qartë për të gjithë ata që mendojnë ta sfidojnë rendin dhe sigurinë në atë pjesë veriore të Kosovës, se pjesën veriore, konkretisht, veriu i Mitrovicës ka qenë, është dhe do të jetë pjesë e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Deputeti Goran Marinković e ka fjalën.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Poštovani premijeru,

Poštovani poslanici,

Kada govorimo o problemu severa, moramo biti realni u oceni stanja koje sada imamo na terenu. Ja kao poslanik osuđujem svaki teroristički čin i duboko žalim za poginulim Seleverom Haradinaj i za ranjavanje njegovoj deci, i smatram da je to teroristički i kukavički čin, ali moramo biti realni i reći da ne možemo prejudicirati ko je počinio, koji je bio motiv i trba sačekati kraj istrage koje vodi KPAS i EULEX.

Neki poslanici sa ove govornice, lako okrivljuju jednu stranu, to jest Srbi. Govore kako postoje srpske bande, kako one rade razna kriminalna dela, ali gospodo poslanici, da li bi postojale te bande da nemaju i albanske bandi?

Poštovani poslanici,

Lako je okriviti nekog, lako je reći da je za sve kriv neko drugi, ali kao i uvek moramo se zamisliti da li je to tako.

Poštovana gospodo poslanici, sever Kosova, sa svim svojim problemima je se stavljao pod tepih punih 13. godina, i svi znamo da tamo ima puno problema, ali moramo znati da postoje puno poštenih ljudi koji tamo žive. Dali se sa ove govornice treba da im pošaljemo samo ratno huškačke poruke, pretnje policijom, specijalnim jedinicama i sve za rad skupljanja dnevnog političkih poena? Jer treba sa ve govornice da idu poruke mira, poruke napretka, poruke nade. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Fjalën e ka ministri i Forcës së Sigurisë, zoti Agim Çeku.

AGIM ÇEKU: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Edhe pse FSK-ja ka një mandat krejtësisht tjetër, e ndiejmë veten edhe ne si FSK, por edhe unë si ministër pjesë të arkitekturës të sigurisë dhe e pash të arsyeshme që edhe unë ta jap një kontribut në këtë debat shumë të rëndësishëm për një problem jashtëzakonisht të rëndësishëm të Kosovës.

Sa i përket situatës së sigurisë në Kosovë, situata e sigurisë në përgjithësi definohet, mos të mbaj ligjëratë këtu, për në disa kategori: e qetë, e brishtë, e tensionuar dhe stabile. Ne prej vitit 1989 kur nuk kemi pasur situatë stabile dhe as nuk mund askush të deklarojë se kemi situatë stabile përderisa kemi kaq shumë sfida të sigurisë dhe kaq të mëdha siç është veriu i Kosovës, por gjithmonë kemi pasur të tensionuar, të brishtë apo në aspektin ditor edhe të qetë.

Ka shumë faktorë pse e kemi situatën e tillë, ka shumë faktorë që pse 13 vjet sfida më e madhe e Kosovës ka mbetur veriu, por duhet ta themi se faktori kryesor dhe përgjegjësi kryesor dhe misionin kryesor e ka pasur bashkësia ndërkombëtare që Kosova të jetë e tërë dhe, edhe pushteti i UNMIK-ut edhe mandati misioni i KFOR-it të funksionojë në tërë territorin e Kosovës. Ne e kemi filluar shumë vonë, në vitin 2000-2001, që të krijojmë kapacitetet tona edhe të Qeverisë edhe kapacitete të sigurisë kohë pas kohe, kurse tërë kohën ata e kanë pasur mandatin dhe përgjegjësit kryesorë janë ata, sepse kjo ka ndodhur për shumë arsye. Arsyeja e parë: mungesa e vullnetit politik, mungesë është edhe e kapaciteteve të tyre, e agjenda të ndryshme politike, strategjike në përgjithësi, agjenda të ndryshme kombëtare të disa vendeve që kanë qenë prezente atje, doktrinat e ndryshme ushtarake për operacionet paqeruajtëse, disa vende doktrina e tyre është integrimi i komuniteteve, jo vetëm ruajtja e paqes. Disa vende, doktrina e tyre paqeruajtëse është shmangia e konfliktit të palëve në konflikt dhe asgjë tjetër.

Dhe, vende të tilla: Ibri, Ura e Ibrit iu ka ardhur si, apo e kanë zgjedhur si mundësi shumë të mirë për të implementuar doktrinat e tyre apo agjendat e tyre. Por, sidoqoftë kjo nuk është arsyetim, është vendi ynë, ne kemi kompetencat, e kemi obligimin, e kemi obligimin kushtetues dhe duhet ne tani të ballafaqohemi me këtë situatë, por duhet të jemi realist t'i marrim të gjitha parasysh.

Jam pjesë e Kabinetit qeveritar edhe po e shoh këtu, po them nuk kemi ide, nuk kemi plan, nuk diskutohemi drejtpërdrejtë e unë po ju them këtu që si anëtar i Kabinetit qeveritar, kemi ide, diskutohen ide, hidhen ide, hartohen plane dhe janë dëshmitarë se Qeveria ka ide, ka plane, ka projekte se si të ballafaqohet, do ta zgjidhë këtë sfidë më të madhe. Jam kontribuues edhe vetë i këtyre ideve dhe jam përgjegjës për implementimin e tyre.

Është çështje me rëndësi dhe jo çdo herë mund të thuhet të gjitha, por ajo që është me rëndësi dhe mendoj që duhet ta themi është që, ne e kemi një strategji. E para është që ta ruajmë vendosmërinë tonë për veriu dhe të luftojmë për konsensus të gjerë. Jemi të vendosur që veriu është pjesë e Kosovës, jemi të vendosur që nuk ka status special, jemi të vendosur që nuk ka ndryshim të kufijve dhe këtë vendosmëri e ruajmë dhe e theksojmë në çdo moment.

E dyta, jemi të vendosur që nuk ka ofertë tjetër përpos të Ahtisarit, por jemi si qeveri duke punuar me plan për implementimin e pakos së Ahtisarit. Nuk ka ofertë tjetër. Hapi i dytë i joni është se si ta implementojmë dhe jemi duke punuar në këtë drejtim dhe jemi duke ... të kemi, ta artikulojmë këtë ofertë më mirë planin e Ahtisarit, dhe këtë në disa rrafsh: në rrafshin e parë, rrafshin diplomatik dhe jemi duke punuar në këtë drejtim, se e tha edhe zëvendëskryeministri se çelësi është në Beograd. Jemi duke punuar me kapacitetet që i kemi, me partnerët miqtë tanë të shumtë që i kemi, në presion ndaj Beogradit, se Beogradi të heqë dorë nga kontrolli apo nga strukturat paralele të kësaj.

Jemi duke punuar në rrafshin diplomatik dhe gjithashtu edhe me NATO-n, NATO-ja me KFOR-in, kështu që KFOR-i ka plane të ndryshme për redukim të trupave të tyre. Ne jemi duke bërë vazhdimisht të qartë se ky redukim nuk duhet të bëhet në bazë të një kalendari të paraparë më herët, por në bazë të kushteve që duhet të plotësohen këtu dhe ato kushte i kemi cekur shumë qartë, janë gjashtë. E para është situata anë veri, e dyta është definimi i kufirit me Serbinë dhe garantimi i kufijve, e treta është ndërtimi i kapaciteteve ushtarake të Kosovës apo FSK-së e tjerë e tjerë, por janë të sakta, janë gjashtë kushte që ne i themi, reduktimi duhet të jetë i tillë.

Tjetër, në rrafshin politik kemi plane konkrete se si të punojmë në këtë rrafsh për implemetimin e pakos të Ahtisarit, në radhë të parë duke i mbështetur bashkëpunëtorët tanë, miqtë tanë që janë në Parlament, komunitetin e tyre, dhe komuniteti i tyre të shohë një benifit shumë të madh për integrim në Kosovë do të shehë Kosova kujdeset më shumë për ta, tjetër duke e ndërtuar apo duke i emëruar edhe koordinatorë të ndryshëm të besuar të ndryshëm për komunat e të tjerëve të Qeverisë e shumë e shumë ide tjera.

Në rrafshin ekonomik, sidomos në rrafshin ekonomik projekte të ndryshme, lehtësira të ndryshme, ndoshta trajtim i këtyre zonave si zona të kujdesit të veçantë të Qeverisë. Jemi duke menduar se nuk është e drejtë që një doganier që është në Jarinë apo Brnjak të ketë pagën e njëjtë sikur doganieri në Vërmnicë apo në Elez Han, apo një gjykatës që punon atje, apo një polic që punon atje, që është lojal ndaj Qeverisë, duhet të jetë trajtuar ndryshe. Këtë jemi duke e kërkuar bazën ligjore për këtë. Jemi duke e trajtuar lehtësira të ndryshme për investime, për ndërtime të shtëpive, bizneseve në atë kohë që qytetarët tanë të Kosovës, çfarëdo nacionaliteti që janë, që janë lojal ndaj Kosovës, që kërkojnë ndihmën e Kosovës, Kosova t'ju ndihmojë që ata mund të jetojnë atje.

Jemi në rrafshin e sigurisë, në rrafshin juridik, jemi duke hartuar masat e sigurisë, jemi duke menduar në rrafsh juridik, duk identifikuar qartë ata që duhet sot ose nesër të përgjigjen para organeve të drejtësisë të Republikës së Kosovës. Në rrafshin kulturor, në rrafshin medial, në rrafshin e shoqërisë civile, dëshirojmë që çdokush në këtë vend duke u udhëhequr nga Qeveria që ta ketë rolin e vet në implementimin e pakos së Ahtisarit, jo në hartimin apo diskutimin e një oferte te re të Kosovës. Domethënë, ky është veprimi i dytë strategjikë, implementimi i pakos së Ahtisarit.

E trata, ai është që të jemi gjithmonë kërkuar dhe koordinues me faktorin ndërkombëtar, në radhë të parë me KFOR-in dhe EULEX-in, që të rikujtojmë misionin e tyre, obligimet e tyre, detyrat e tyre dhe që të jemi ne iniciatorë të projekteve.

E katërta është fuqizimi i shtetit. Në këtë drejtim ne jemi të vetëdijshëm për disa mangësi. Thamë, e kemi ndërtuar sektorin e sigurisë ashtu siç e kemi ndërtuar shkallë-shkallë dhe kurrë nuk e kemi pasur pronësinë mbi këto projekte, gjithmonë kemi pasur mentor, kemi pasur mentor me agjenda të ndryshme, kemi pasur mentorë që një sy gjithnjë e kanë mbajtur çka thotë Beogradi për këtë punë. Tani, me vendimin e Qeverisë kemi filluar rishikimin strategjik të tërë sektorit të sigurisë me qëllim që në vitin e ardhshëm ta kemi një sektor të sigurisë, të një shteti funksional, të një shteti normal, me të gjitha institucionet e sigurisë mirë të koordinuara, me të gjitha kapacitetet për të cilat kemi nevojë dhe cilat mund t'i përballojmë. Do ta kemi një sektor të sigurisë, sigurisht shumë funksional dhe me kapacitete shumë më të mëdha se sa ai ka sot.

Dhe e pesta, integrimi. Integrimi në radhë të parë në NATO, mandej në Unionin Evropian. Ne ende nuk jemi, është një mungesë e madhe që nuk kemi raporte kotnaktuale me NATO-në ende, raportet tona me NATO-në ende janë të nivelit operacional. Jemi vend i vetëm që NATO na trajton sikur një arenë ku ata bëjnë operacion domethënë paqeruajtës. Për neve është jetik integrimi në NATO, integrimi në NATO apo vendosja e raporteve të partneritetit me NATO-n do të thotë nënshkrimi i marrëveshjes së statusit të forcave të NATO-së në Kosovë, ato marrin obligime, kanë obligime ndaj shtetit me këtë marrëveshje, do të thotë hyjmë nën artikullin e pestë, domethënë të NATO-së, që NATO merr obligimet se çdo partnerë apo anëtar ta mbrojë dhe ta ndihmojë që të jetë shtet stabil funksional e tjerë e tjerë.

Kështu që, shkurtimisht desha të them që nuk është e vërtetë që nuk kemi ide, nuk kemi plane, nuk kemi projekte, është durimi edhe unë e favorizoj durimin, por durimi i përcjell gjithmonë me vendosmëri në radhë të parë dhe me urtësi në radhë të parë. Forca, e thamë të thithë pajtohemi, nuk është përgjigje, forca është mjeti i fundit dhe krejtësisht i fundit, por është mjet, është mjet dhe forca duhet të përdoret, kur nuk e kemi përdorur as në luftë ndaj ndaj qytetarëve as kurrë ndaj komunitetit dhe kur nuk duhet ta mendojmë që të përdoret, por vetëm ndaj atyre që e shkelin ligjin, janë pengesë e funksionimit të shtetit, rendit, ligjit atje. Ne nuk mendojmë që të përdorim forcë dhe ajo forcë të trajtohet si forcë okupuese.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Zoti Memli Krasniqi, e ka fjalën.

MINISTRI MEMLI KRASNIQI: Faleminderit shumë!

I nderuar kryesueses,
Nënkryetar,
Të nderuar deputetë,
I nderuar kryeministër,
Ministra,

Ngjarjet e fundit në veriun e vendit tonë kanë qenë të shqetësuara për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe padyshim që këto ngjarje kanë ndikuar drejtpërdrejt edhe për çështjet me të cilat ballafaqohemi edhe ne. Në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ne gjatë gjithë kësaj periudhe, jemi munduar që disa çështje që ndërliken, veçanërisht me pjesën e trashëgimisë kulturore të vendit tonë, t'i trajtojmë dhe gjithsesi që kemi hasur në probleme me të cilat jemi ballafaquar edhe në të kaluarën. Përkundër kësaj, ne kemi vazhduar që përmes bashkëpunimit të

drejtpërdrejtë me qytetarët në atë anë, jo vetëm me shqiptarët, por edhe me qytetarët e komuniteteve të tjera, të iniciojmë disa procese të cilat në të kaluarën kanë munguar, përkundër faktit që disa nga obligimet tona që dalin edhe nga pakoja e Ahtisarit, veçanërisht nga aneksi 5 i kësaj pakoje që ndërlidhen me mbrojtjen, ruajtjen e trashëgimisë kulturore, por edhe me promovimin e kësaj fushe të rëndësishme, ne kemi iniciuar një varg çështjesh që ndërlidhen edhe me investimet konkrete në këtë fushë edhe në veriun e vendit tonë që, mund t'ju them kjo ka ndodhur për herën e parë.

Padyshim se edhe ndikimi apo përzierja e strukturave paralele të cilat ende vazhdojnë të jenë një barrë për të implementuar projektet konkrete të cilat ane i kemi edhe si pjesë strategjisë sonë, ne e kemi arritur që të ndikojmë drejtpërdrejt tek pjesa që ndërlidhet me programin tonë që kemi filluar për herë të parë vitin e kaluar e që ka të bëjë ëme programin ndërhyrjeve emergjente. Andaj, edhe vitin e kaluar edhe këtë vit ne po vazhdojmë me këtë program i cili nuk është një program i drejtuar vetëm në një komunitet apo një tjetër, por që mëton që t'i bëjë bashkë të gjitha palët në mënyrë që përmes trashëgimisë kulturore dhe përmes restaurimit të objekteve të caktuara, përmes promovimit të këtyre restaurimeve, të ndikojmë te krijimi i një fryme tjetër dhe tek angazhimi apo përfshirja e qytetarëve të nacionaliteteve të ndryshme në një fushë e cila për fatin e keq të gjithëve, në të kaluarën është përdorur si një fushë e cila i ka ndarë njerëzit, si një fushë e cila është përdorur edhe për arsye politike derisa qasja jonë që nga fillimi ka qenë që përmes trashëgimisë kulturore, përmes diverzitetit, ne duhet ta shfrytëzojmë këtë si një pikë e cila na bashkon.

Jemi edhe në proces të krijimit të disa projekteve të reja të cilat po ashtu ndërlidhen me krijimin e kësaj fryme dhe veçanërisht sot në Ditën Ndërkombëtare të Trashëgimisë, që është 18 prilli, kemi promovuar edhe një videospot senzibilizues dhe promovues...guidë arkeologjike, ku përfshihen edhe të gjitha lokacionet arkeologjike të Kosovës, duke përfshirë edhe ato të veriut të vendit...

(Ndërhyrje nga salla)

E merr fjalën herën tjetër, unë të kisha lutur që të mos më ndërprehsh, se unë nuk të ndërpreva, bile pata arsye të të ndërprejë një dhjetë herë, por sido që të jetë, pak edukatë kisha kërkuar!

Andaj, qasja jonë përkundër vështirësive, përkundër kundërshtimeve, përkundër ndikimit të strukturave paralele, të mbështetura drejtpërdrejt nga Beogradi, është që ne bashkërisht me qytetarët, duke i anashkaluar edhe këto probleme apo ndikime, të krijojmë një qasje të re, një frymë të re duke shfrytëzuar edhe këto fusha të cilat realisht ndoshta nuk lidhen drejtpërdrejt me aspekte të sigurisë për çka janë organet kompetente, por për të krijuar një frymë të re të bashkëpunimit, një frymë të re të tolerancës edhe në pjesën veriore të vendit.

Normalisht, unë ju kuptoj juve, se me siguri që as kultura, as sporti, as trashëgimia s'ju duken të rëndësishme, por ju kisha ftuar me pa si pak më të rëndësishme, sepse edhe tash janë të rëndësishme. Veriu i vendit është pjesë e Kosovës, në veri të vendit zhvillohen edhe ngjarje kulturore, edhe ngjarje sportive, ka edhe trashëgimi kulturore, andaj nëse kemi një debat për veriun e vendit, ma merr mendja që përveç për politikën sigurisë, ne duhet të flasim edhe për problemet të trashëgimisë kulturore. Juve mund t'ju duket minore, por kjo është një punë e

përditshme me të cilën merremi ne, dhe me të gjitha këto probleme me të cilat ne ballafaqohemi, ma merr mendja përkundër mungesës së interesit nga ana e juaj, ne jemi të obliguar t'i njoftojmë tek e fundit deputetët tjerë që iu intereson ose opinionin publik. Dhe, duke shfrytëzuar që kjo seancë që sot është thirrur për të biseduar për veriun e vendit, atëherë unë e pash të arsyeshme t'ju shpjegoj se në veriun e vendit tonë ka probleme edhe të trashëgimisë kulturore, por që ne po mundohemi përkundër këtyre vështirësive dhe problemeve, bile kisha me thënë ndoshta edhe një mungesë të interesit më të përgjithshëm për këto fusha, që t'i bëjmë disa hapa që ndoshta s'janë bërë në të ardhmen dhe për të cilat shpresojmë bashkë edhe me partnerët ndërkombëtarë, me të cilët jemi në partneritet për një numër shumë të madh të këtyre projekteve, të ndryshojmë situatën dhe në këtë dialog me qytetarët, ndoshta të krijojmë një frymë të re të bashkëpunimit, të tolerancës dhe pse jo të ndryshojmë situatën edhe në terren. Ju faleminderit!

Po e përsërisë, shpresojë që në të ardhmen keni me filluar edhe ju kundërshtarët e këtyre çështjeve, të merreni ngapak edhe me kulturë edhe me sport dhe me trashëgimi sepse realisht edhe këto janë pjesë të rëndësishme, bile për një parti që pretendon me pasur njëfarë karakteri nacional, ma merr mendja që kultura dhe trashëgimia do të ishin shumë më lartë në listën edhe të interesimeve të juaja. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Për procedurë, e ka kërkuar zoti Ismet Beqiri fjalën!

ISMET BEQIRI: Ju faleminderit, zoti nënkryetar!

Unë ju kisha lutur që, si kryesues të respektohet një rend e jo nga 3 ministra me fol dhe të mos iu jipet deputetëve rasti të flasin. Edhe ata kanë mundësi me fol sigurisht. Nuk është sot ndonjë raport i punës i Qeverisë, në do pjesë e kanë kënaqë, veç po na tregojnë se çka po bën ai për pjesën veriore për trashëgimi.

Dhe, po ju lutem, është shumë serioze. Debatin e kemi pranuar, normalisht jeni edhe ju këtu, por po ju lus që deputetët, ne e kemi dorëzuar edhe listën zoti nënkryetar i Kuvendit. Dhe, nuk është në rregull që të shkojnë tre ministra të flasin një pas një, e deputetëve të mos iu jipet fjala.

Prandaj për hir të korrektësisë, unë nuk mundem me e dirigjuar se si flet një ministër ose një deputet. Është e drejtë e tij, ose a e sheh të arsyeshme tash me dal me na treguar edhe gjëra të tilla. Sigurisht, është problem dhe e drejtë e tij. Por ajo që po kërkoj në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, të respektohet një rend dhe t'iu jipet hapësirë deputetëve ta thonë mendimin e tyre. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Të faleminderit për vërejtjet.

Unë, do të thotë në marrëveshje me kërkuesit e debatit dhe duke pasur parasysh interesimin edhe të Qeverisë për të debatuar dhe duke falënderuar për prezencën kaq të madhe të të gjithë ministrave, pothuaj se jam detyruar që t'ia kufizoj të drejtën Qeverisë që e ka bërë kërkesën që t'i fusë dy ministra dhe katër përfaqësues ose pesë, sipas paraqitjes së grupeve parlamentare me renditje për të raportuar.

Strategjia e Qeverisë nuk është punë e imja. Ata e kanë bërë strategjinë për të sqaruar deputetët dhe opinionin dhe është e drejtë e tyre që të diskutojnë konformë kërkesave. Ju faleminderit! Për replikë, zoti Memli Krasniqi e ka kërkuar fjalën.

MIISTRI MEMLI KRASNIQI: Ju faleminderit!

I nderuar, zoti Beqiri! Se a e kemi kënaqë a nuk e kemi kënaqë, ma merr mendja do të vlerësohet në fund nga qytetarët e Kosovës. E për sa e keni kënaqur ju, sepse ti ke pasur në pozicionin ku jam unë zakonisht të partisë tënde dhe lexoni gazetatat, për ditë po ju kallxojnë sa mirë keni punuar në të kaluarën.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Kundër-replikë zoti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Por, kjo e tregon nivelin tuaj, sepse ti merresh me gazeta. Që besa, këtu edhe nuk mund të përjashtohet mundësia e stimulimit të shkrimeve të tilla, edhe nga dikush prej jush, por është problem tjetër ky.

Mos tento me devijuar debatin, se çka kemi bërë ne, e çka jeni duke bërë ju, mos u ngutë se ndoshta nuk ke me i pritë as gazetatat, por më herët të vjen rendi edhe ty.

Por, po ju lus se unë, kërkova për procedurë dhe ti mos u merr me LDK-në. Unë nuk fola për diçka tjetër, përpos asaj që të respektohet procedura dhe të flasin edhe deputetët e Kuvendit të Kosovës. Ndërsa për të tjerat kur të doni, kur të doni ju personalisht, e bëjmë debatin.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Xhevahire Izmaku.

XHEVAHIRE IZMAKU: Ju faleminderit, kryesues!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të respektuar kolegë deputetë,

Kësaj radhe, në këtë seancë të jashtëzakonshme, të iniciuar nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike dhe të përkrahur edhe nga deputetët subjekteve të tjera, na bashkoi Mitrovica, ajo plagë e rëndë që ende po na rëndon çdo ditë e më tepër, edhe pas 13 vjetëve liri të pjesës tjetër të Kosovës.

Situata e tensionuar edhe tani me tendencë të përshkallëzimit në Mitrovicë, vazhdoi të jetë e tillë që nga përfundimi i luftës në Kosovë. Që nga ajo kohë, shqiptarët e kësaj pjese jetojnë nën terrorin serb, nën rrahje, tortura, vrasje, e dëbime nga strukturat paralele serbe të përkrahura drejtpërdrejt nga Qeveria e Beogradit, e që kanë për qëllim pastrimin e territorit përmes dëbimit të shqiptarëve nga ajo pjesë e Republikës së Kosovës dhe kjo nuk është risi dhe e panjohur për ne....

A mund të vazhdoj, kryesues, se nuk po dëgjoj kurrgjë prej zhurme?!

KRYESUESI: Ti vazhdo! Veç dua që të mos nervozohen deputetë sepse transmetimi do të jetë deri në fund, pra derisa të kryhen diskutimet. Mos me shkruani SMS për fjalë! LDK-ëja i ka përcaktuar njerëz, vetëm me vendim tjetër mund të ndryshohen. Edhe PDK-ja i ka të caktuar. Të tjerët janë të paraqitur në listë dhe sipas radhës, do ta marrin fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKU: Të nderuar deputetë,

Shqiptarët e asaj pjese të Republikës së Kosovës, janë duke mbijetuar me një heroizëm të paparë dhe pa kurrfarë sigurie për familjet e tyre tash e 13 vjet. Edhe kjo situatë nuk është e panjohur për ne. Që 13 vite janë bërë me dhjetëra protesta dhe demonstrata, me thirrje që ajo pjesë e Kosovës duhet të jetë e lirë dhe e integruar me pjesët e tjera të vendit dhe të gjitha këto thirrje i kanë dëgjuar dhe heshtur të gjitha misionet ndërkombëtare që kanë vepruar dhe janë duke vepruar në Kosovë. Pra, edhe kjo situatë nuk është e panjohur për ne.

Të nderuar kolegë deputetë,

Rënia e heroit Enver Zymberi, në mbrojtje të kufirit të pjesës veriore të Kosovës si dhe vrasja e fundit e Selver Haradinaj, është thirrja më e fuqishme që mund t'i bëhet t'i bëhet këtij Kuvendi, neve si përfaqësues të zgjedhur të popullit, presidentes së vendit, Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe të gjitha institucioneve tjera të Republikës pa e harruar këtë rast edhe Akademinë e Shkencave të Kosovës, që t'i bashkojnë mendjen dhe punën, t'i bashkojmë të gjitha energjitë pozitive e kombëtare duke i adresuar një pikë të vetme: Shtrirjen e sovranitetit shtetëror në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Dhe kjo mund të bëhet, duke lënë në një anë emocionet dhe ndjenjat partiake që në këtë rast mendoj se duhet të jenë krejtësisht të padukshme nga interesi kombëtar.

Mos i drejtoni sulmet kah Qeveria e Republikës së Kosovës, nuk mjaftojnë. Pra, kjo Qeveri, mendoj, nga të gjitha qeveritë e tjera, është duke e bërë të pamundurën ta shtrijë sovranitetin edhe në atë pjesë të territorit, ashtu siç jam e bindur se ne kemi përgjegjësi dhe duhet të thirremi me një zë të përbashkët të vetëm dhe shumë të fuqishëm - pozitë e opozitë: të thërrasim bashkësinë ndërkombëtare, SHBA-në, BE-në dhe gjithë botën demokratike që të bëjë presion dhe t'ia ndalë privilegjet Serbisë, derisa qeveria e Beogradit t'i shpërbënë strukturat paralele dhe të heqë dorë nga territori i Republikës së Kosovës.

Të nderuar kolegë deputetë,

Nuk dua të besoj që dikush nga ky Kuvend do ta shfrytëzoj tragjedinë e asaj pjese të shqiptarëve të Kosovës për ngritje politike. Dhe nëse dikush ka vendosur ta bëjë një gjë të tillë, sugjeroj të ndërpres para se të filloj, dhe krejt tjetër terren, mendoj se është ai ku mund të fitohet në politikë.

Këtu ka nevojë për më shumë unitet kombëtar, andaj duhet të jemi bashkë. Mitrovica pret shumë nga ne dhe ne mund ta ndihmojmë vetëm të bashkuar dhe më racional në këto kritika. Unë besoj te angazhimi i Qeverisë, sikur e besoj shqetësimin dhe përgjegjësinë e secilit prej jush në këtë Kuvend.

Edhe një herë, si deputete e këtij Kuvendi, kërkoj nga Bashkësia Evropiane, veçanërisht nga misioni i EULEX-it, t'i kryejë obligimet e veta për të cilat ka marrë një mandat para se qytetarët e këtij vendi dhe institucionet të humbin besimin e plotë në këtë mision. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputetja Osmani, e ka fjalën.

VJOSA OSMANI: Ju faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Dua ta filloj sot këtu me një fjali të një gjyqtari ndërkombëtar nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë i cili e tha këtë në rastin e shqyrtimit të Kosovës, dhe tha se: Një shtet që nuk është në gjendje të mbrojë të drejtat dhe liritë themelore të qytetarëve të vet, e humbë të drejtën të thirret në sovranitet dhe në integritet territorial.

Ai gjyqtar, edhe pse vinte nga një shtet që nuk e ka njohur Kosovën, në fakt e kishte fjalën për Serbinë kur e tha këtë.

Ta përkthejmë këtë në situatën e Kosovës. Qeveria e cilësoi 25 korrikun si kthesë historike. Tha nuk ka kthim prapa dhe tërheqje nga veriu. Deklaratat e kryeministrit, ndër të tjera përfshinin:

Nën një: Me 25 korrik është varrosur ëndrra e Serbisë,

Nën dy: Çështja e veriut ka marrë fund me 25 korrik,

Nën tre: Pas një 25 korrikut, Kosova ësh ndryshe,

Nën katër: Pas datës 25 korrik, situata në veri të vendit ka ndryshuar dhe është hapur kapitull i ri për vendosjen e rendit dhe ligjit dhe, përfundimisht,

Nën pesë: Nuk tërhiqemi nga veriu i vendit.

Këtë e tha kryeministri kosovar me 18 gusht. Këto retorika i dëgjuam si refrene të korit gazmor çdo ditë për një kohë të gjatë.

Pyetja që duhet ta bëjmë ne sot është: Çka ndryshoj me 25 korrik?

Përgjigjen më të mirë na e dha Serbia duke marrë jetën e një bashkëvendësit tanë, Selver Haradinaj, duke plagosur familjarët e tij dhe duke vazhduar politikën e spastrimit etnik në veri. Mos t'i përmendim edhe arrestimet që ndodhën kohëve të fundit dhe si u kundër përgjegjës Qeveria e Kosovës ndaj kësaj? Me asgjë! E bëri atë që e ka bërë me 25 korrik. Pikërisht asgjë!

Në fakt i vetmi zyrtar i PDK-së, që e tha të vërtetën këto ditë, lidhur me qasjen e Qeverisë ndaj veriut të vendit, ishte kryetari i Komunës së Mitrovicës i cili ju tha qytetarëve: mbrohuni vet sepse ne nuk do t'ju mbrojmë! Ai ua tha të vërtetën se çka mendojnë zyrtarët e PDK-së për jetën e qytetarëve në veri të Mitrovicës. Ai iu tregoj se sa vlen jeta e tyre për këtë Qeveri që po e shohim ne sot këtu, për ata njerëz që qe 13 vite po e bëjnë pikërisht atë që nuk po e bënë Qeveria, do të thotë mos të tërhiqen nga veriu.

Qeveria e Kosovës, ka dështuar në menaxhimin e situatës në veri. Kjo duhet të thuhet troq, duhet të thuhet qartë dhe Qeveria duhet të marrë përgjegjësi edhe morale edhe politike për këtë dështim.

Rezoluta e Kuvendit e 28 korrikut, disa ditë pas aksionit që po përmendet, kërkoi nga Qeveria, dhe po e përsëris - nga Qeveria, jo nga dikush tjetër, që të përdorë autoritetin e vet kushtetues për ta shtrirë sovranitetin në veri.

Këtë kërkesë s'ia drejtoi as EULEX-it, as KFOR-it, por Qeverisë dhe duke pasur parasysh që EULEX-i vazhdimisht po deklaronte që nuk ka qasje veprimi në Serbi, natyrisht që kjo do të thotë që është plotësuar ajo që u tha nga ministri Rexhepi më herët që, në qoftë se nuk reagojnë as KFOR-i as EULEX-i, atëherë do të vepron Policia e Kosovës.

Nuk kanë reaguar as KFOR-i, as EULEX-i, prandaj ka ardhur koha që zoti ministër edhe të tjerë që janë këtu nga Qeveria, që Kushtetuta e Kosovës, dokumenti themelor bazik që ka epërsi mbi çdo marrëveshje që ju e nënshkruani me këdo qoftë, qoftë edhe me KFOR-in, të respektohet nga preambula e saj. Dhe çka thotë preambula? Thotë: Ne qytetarët e Republikës së Kosovës, përfshirë edhe ata në veri që nuk e paskan vlerën e njëjtë të jetës sikur ne këtu, thotë: ne qytetarët e Republikës së Kosovës po ia besojmë jetën tonë shtetit tonë, jo KFOR-it, jo EULEX-it por shtetit tonë.

Thuhet, në nenin 125: Institucionet e sigurisë së Kosovës, mbrojnë sigurinë publike dhe të drejtat e njeriut. Jo KFOR-i, jo EULEX-i, institucionet e sigurisë së Kosovës.

Thuhet në nenin 121: Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë a e njeriut.

Pra, duhet të largohemi nga ajo logjikë që ta gjuajmë topin në fushën e tjetërkujt, që ta gjuajmë fajin tjetërkund, por përfundimisht ka ardhur koha që institucionet e Republikës së Kosovës të tregojnë vendosmëri, të marrin përgjegjësi dhe ta kryejnë punën e vet, punë jo që ne si deputetë po i themi ta kryejmë por që e kanë sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Është absolutisht e papranueshme që përderisa kemi forca policore prej 8.000 vetash, krejt çka Qeveria i kushtoj veriut këto ditë, janë dy njerëz dhe 5 minuta, sot po thuhet 15 nga koha e tyre.

Por, të nderuar deputetë, në veri po ndodhë spastrimi etnik. Pikërisht ai spastrim etnik që ka ndodhur në përmasa shumë më të mëdha përpara, po ndodhë sot, po vazhdon më ngadalë në përmasa më të vogla, por përmasat nuk e përcaktojnë seriozitetin e krimit. Është i njëjti krim, është spastrim etnik. Dhe mungesa e qasjes njerëzore ndaj problemeve të qytetarëve në veri, është ajo që po mungon.

Tmerri dhe pasiguria, që të gjithë ne e kemi përjetuar, në vitet e 90-ta, atje po përjetohet që 13 vite dhe më tregoni cili prej jush nuk e keni parë vetveten, fytyrat e qytetarëve të veriut këto ditë që intervistoheshin nëpër media. Atje po shkelet liria e lëvizjes, liria e fjalës, liria e shkollimit, por mbi të gjitha e drejta në jetë. Dhe po kthehem këtu te ajo që e tha gjyqtari në GJND: cila është ajo qeveri që nuk mund të mbrojë jetën, dinjitetin e qytetarit dhe të drejtën në liri dhe në siguri, të drejta këto të garantuara me Kushtetutë të Kosovës.

Përderisa qytetarët tanë të veriut, po jetojnë në këtë ferr, procesi i dialogut Prishtinë – Beograd, është shndërruar në fontanë dëshirash për Serbinë, dëshira këto që me mburrje po plotësohen nga Qeveria e Kosovës. Dëshirat e Serbisë ia kanë zënë vendin nevojave të qytetarëve tanë.

Favoret ndaj Serbisë ia ka zënë vendin mbrojtjes së jetës të qytetarëve tanë dhe zbatimi i Kushtetutës së Serbisë ia ka zënë vendin zbatimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Kjo është situata dhe në qoftë se po pritet ende që të plotësohen kushtet tjera për të vepruar, atëherë unë besoj që është gabimi më i madh që e kanë bërë ndonjëherë institucionet e Republikës së Kosovës. Nuk do të veprojë KFOR-i, nuk do të veproj EULEX-i, iniciativën duhet ta marrin institucionet e Kosovës, natyrisht në bashkëpunim me miqtë tanë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Replikë ka kërkuar ministri Rexhepi.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Ju faleminderit, i nderuari kryesues!
Do të koncentrohem vetëm në një koment ose një kërkesë që e bëri zonjusha Osmani.

Natyrisht që ne e kemi cilësuar si akt terrorist, se edhe metoda edhe mjetet, edhe qëllimi edhe rrezikimi i përgjithshëm, si tillë edhe e kemi trajtuar.

Mirëpo, nëse kërkohet që pa hetimet paraprake për këtë të dërgohen njësitë speciale në pjesën veriore, kundër kujt duhet t'i dërgojmë, pa e ditur, kundër njerëzve apo çka?

Prandaj ju, që e dini shumë mirë edhe si juriste, duhet me qenë pak të matur në këto veprime të tilla.

Natyrisht që hetimet janë duke u bërë, është rast, akt terrorist. Hetimet janë të përbashkëta dhe kur dihen dorasit, bashkërisht me mekanizmat ndërkombëtar, do t'i ballafaqojmë me drejtësinë. Por nuk shikojmë me paragjykim të motivit.

(Ndërhyrje)

Jo, jo! Nuk është në paragjykim të motivit. Nëse duhet, pa e ditur ende kush e ka bërë një diçka të tillë, e me çua njësinë speciale kundër qytetarëve, atëherë e kemi gabim zonjushë.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Kundër-replikë, deputetja Vjosa Osmani.

VJOSA OSMANI: Zoti ministër, ajo që unë dhe të gjithë, ne po besojë po kërkoj këtu, është siguri edhe mbrojtje për qytetarin. Mbrojtje, ta mbron qytetarin, sepse sikur të kishte ekzistuar niveli i sigurisë për cilin ju po flisni, ata njerëz nuk ishin vra as nuk kishin jetuar në këtë ferr që po jetojnë.

Dhe ju pyetët, kë me e arrestuar? Para syve të policëve tanë janë demoluar pikat statike nga qytetarë, dhe ata policë e kanë parë kush i ka demoluar. Vërtetë aty ka qenë shumë e qartë, edhe drejtësia për të cilën ju e përmendët që unë e di, kërkon që krimi që zihet në flagrancë, të dënohet menjëherë.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka zoti Kurti.

ALBIN KURTI:

Deputetë të Kuvendit të Kosovës!

Qeveria e Kosovës dëshiron unitet të spektrit politik në këtë Kuvend, për dy arsye.

Së pari, unitet pas mosveprimit qeveritar për Mitrovicën dhe për kidnapimet në kufijt e Kosovës nga xhandarmëria dhe policia e Serbisë.

Dhe, së dyti, unitet para ndonjë gjesti të ardhshëm qeveritar në veri, të ngjashëm me atë të 25 korrikut, në mënyrë që t'i hapet rruga bisedimeve me Serbinë për veriun e Kosovës, fillimisht të kamufluara si bisedime me përfaqësuesit e serbëve atje.

Ne nuk mund t'i besojmë kësaj Qeverie e cila e përdor nacionalizmin dhe patriotizmin për t'i lehtësuar bisedimet me Serbinë dhe për t'i shitur ndërmarrjet e Kosovës.

Neoliberalizimi dhe gjeopolitika janë emra të tjerë për neokolonializmin. Mirëpo, emrat e rinj, siç e dimë, nuk janë gjëra të reja.

Neokolonializmi ekonomik, sot po quhet neoliberalizëm, kurse neokolonializmi politik po quhet gjeopolitikë. Nëpërmjet neoliberalizmit plaçkitet pasuria publike e kombëtare dhe dobësohet shoqëria, kurse nëpërmjet pikëpamjes gjeopolitike ruhet stabiliteti në Ballkan në kurriz të Kosovës dhe shqiptarëve.

Kjo Qeveri po e përdor nacionalizmin dhe luftën çlirimtare, në njërën anë për t'i lehtësuar bisedimet me Serbinë që ndodhen përbrenda logjikës gjeopolitike, ndërsa në anën tjetër për ta lehtësuar shitjen e ndërmarrjeve publike fitimprurëse të Kosovës.

Sa për ilustrim, Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës ia vunë emrin "Adem Jashari" për ta shitur më kollai e më shpejt, kurse autostradës ia vunë emrin "Ibrahim Rugova" për të vjedhur më kollai dhe më shumë.

Nacionalizmi dhe patriotizmi i kësaj Qeverie, janë lubrifikantë për neokolonializmin. Kjo është arsyeja politike dhe konceptuale pse Qeveria e Kosovës nuk bën të përkrahet as kur është aktive, se jo më kur është pasive.

Mirëpo, edhe arsyeja politike dhe operacionale, na thotë të mos e përkrahim Qeverinë në gjestet e ardhshme që orvatet t'i shesë si aksione përmes mediave të saj.

Pikërisht pse është paralajmëruar Serbia që do të ketë intervenim në veri, tash nuk duhet të ketë intervenim. Sepse Serbia është mobilizuar dhe ka plan për strukturat e saj, për dallim nga Qeveria e Kosovës, që thotë se do ta përsëris 25 korrikun kur bëri një gjest pa strategji dhe mandej u zmbraps.

Kjo Qeveri e paralajmëroi një përsëritje të intervenimit të 25 korrikut. Ky paralajmërim vetëm sa e përgatit dështimin e ndërhyrjes dhe jo ndërhyrjen si të tillë.

Edhe me rastin e kidnapimeve në Dumnicë, edhe me atë të dërgimit të dy policëve në një konteiner statik në veri të Mitrovicës, u dëshmuua që kjo Qeveri po e organizon dhe planifikon dështimin, pra se këto dështime janë dështime me paramendim.

Planin 14 pikësh për veriun që shkurtimisht e paraqiti Visari, as nuk mund të zbatohet e as nuk bën ta zbatohet kjo Qeveri. Sepse kjo Qeveri është Qeveri e improvizimeve, jo e planeve. Sepse kjo Qeveri pranoi fusnotën që na e konteston shtetësinë dhe e hoqi fjalën Republikë nga emërtimi i shtetit. Sepse kjo Qeveri u mor vesh me Serbinë për pikat kufitare të Kosovës që tash e tutje janë vetëm pika kaluese ku s'kalon dot sepse të arreston Serbia kur t'i teket asaj. Sepse kjo Qeveri e imponoi në këtë Kuvend kundër-mocionin kundër reciprocitetit me Serbinë.

Gjëja më e mirë që mund të bëjë kjo Qeveri është të jep dorëheqje e jo të intervenojë në veri. Aktiviteti i kësaj Qeverie është bërë edhe më i dëmshëm sesa pasiviteti i saj.

Ne nuk mund t'i besojmë pra premtimeve më të reja të kësaj Qeverie përballë përvojës të gjatë dhe thellësisht të hidhur që kemi me të.

Thirrja te Plani i Ahtisarit është bërë e kotë. Insistimi te Plani i Ahtisaarit është sikurse dikur insistimi për autonominë e 74-shit si qëllim. Para një çerek shekulli, pikërisht ata që ishin për republikë e mbronin më së shumti autonominë. Ngjajshëm, sot, pikërisht ata që janë për bashkim kombëtar e mbrojnë më së shumti Republikën. Ata që ishin për autonomi s'e mbrojtën dot as autonominë. Sot, ata që janë vetëm për Republikë, s'e mbrojnë dot as Republikën dhe po heqin dorë prej saj.

Plani i Ahtisarit është keqkuptuar rregullisht dhe masivisht. Edhe këtu dëgjuam deputetë duke thënë që ne e pranuan Planin e Ahtisarit. Ne nuk e pranuan Planin e Ahtisarit. Ju e pranuat Planin e Ahtisarit si ofertë për Serbinë, të cilën ajo s'e pranoi. Plani i Ahtisaarit ishte ofertë për ta kënaqur Serbinë. Serbia mbeti e pakënaqur, Serbia vazhdon të jetë e pakënaqur, prandaj po përgatiten oferta shtesë për të. Pra, Plani i Ahtisarit nuk ishte ofertë e zgjidhje për Kosovën për të cilën thuhej që e ka statusin e padefinuar, por ai ishte ofertë e zgjidhje për Serbinë, propozim për Serbinë për ta kënaqur atë.

Qasja e këtillë e Planit të Ahtisaarit e mundëson tejkalimin e tij. Kjo është arsyeja pse kur dikush thotë që Plani i Ahtisarit është vija e kuqe, në fakt, s'e kupton se çka po thotë.

Dialogu në Bruksel, i filluar para se më shumë se një viti, e ka dëshmuar që vijë e kuqe është veçse Kushtetuta e Serbisë. Secila marrëveshje në Bruksel është formuluar dhe përpiluar me kujdes në

mënyrë që opozita në Serbi të mos ketë rast për Gjykatën Kushtetuese atje. E dihet që në Kushtetutën e Serbisë shkruan që Kosova është pjesë e Serbisë.

Marrëveshja në Bruksel me Serbinë për pikat kufitare që u degraduan në pika kaluese dhe për fusnotën që realisht na kthen te negociatat e Vjenës të vitit 2006, paraqesin tradhti ndaj shtetit të Kosovës që e keni shpallur të pavarur mu në këtë sallë para më shumë se katër vjetëve.

Kjo tradhti ndaj shtetit të Kosovës prej Qeverisë dhe Kryeministrit të Kosovës e ka trimëruar dhe inkurajuar Serbinë që të tregojë se Kosova nuk ka as kufij, dhe as Mitrovicë!

Këtë Qeveri dhe këtë Kryeministër dikush edhe mund ta amnistojë pse nuk e ndihmoi shtetin e Kosovës dhe kombin shqiptar. Por askush, asnjëherë nuk mund ta amnistojë pse e ndihmoi armikun tonë, shtetin e Serbisë.

Duke iu falenderuar kësaj Qeverie dhe këtij Kryeministri, Serbia e fitoi statusin e vendit kandidat për BE. U ndryshua emri i shtetit të Kosovës në bashkëpunim me Serbinë, dhe u faktorizua Serbia rreth Kosovës e në Kosovë.

Krimet fizike dhe konkrete të Serbisë janë pasojë e këtij krimi politik të Qeverisë. Njëkohësisht, ato janë mënyra se si Serbia tregohet falenderuese dhe mirënjohëse për koncesionet që i ka fituar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka zoti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Kjo seancë ashtu siç është thirr, ashtu dhe do të përfundojë. Jo serioze është thirr, jo serioze do të përfundojë.

Po e them për arsye se në vetë faktin që në ora 14,00 është thirr, e jo më herët, kur deputetët mund të diskutojnë gjatë tërë ditës, tash lihet për pasdite, ndoshta telenovelat mund t'i shikojnë qytetarët, e nuk kanë nevojë me na shikuar neve.

Është po ashtu kërkesë e deputetëve që kryeministri të jetë prezent këtu dhe t'i drejtohet Parlamentit, normalisht, për situatën e jashtëzakonshme që ekziston në komunat: Leposaviq, Zubun Potok, Zvečan dhe pjesën veriore të Mitrovicës. Por, normalisht kur Qeveria nuk ka

zëdhënës, sepse pa zëdhënës është edhe deri me tani, ka kush e kryen detyrën e zëdhënësit, si zakonisht, dhe në prezencën e kryeministrit, raporton.

Po ashtu, meqë kryeministri nuk i drejtohet parlamentit të Kosovës që në start, ua shpërndanë ministrave që ata të mos flasin për programet konkrete të tyre se çka kanë bërë në këto komuna, të cilat kanë qenë realizimet, a është shtruar një rrugë, a është bërë një shkollë, a është ngritur një ambulancë, a është bërë një veprim praktik për ata qytetarë, sepse janë në territorin e Republikës së Kosovës, pavarësisht nga nacionaliteti.

Këtu kemi fjalë të çuditshme, që absolutisht nuk lidhen me programet dhe me investimin e tyre në një pjesë të territorit të Republikës së Kosovës. Dhe, nuk bëhet pa qëllim, normalisht, sepse duhet debati të shkojë deri në absurd, sa të iu merret hapësira edhe deputetëve, që të mos kenë mundësi ose të heqin dorë nga fjalët e tyre, sepse çka i flet ti një Qeverie, e cila nuk i obligohet Parlamentit. Përkundrazi, vazhdimisht Qeveria del se e dirigjon Parlamentin. Dhe, një Qeveri e papërgjegjshme, normalisht që nuk mund të kuptojë se i dedikohet këtij Parlamenti, i jep përgjegjësi këtij Parlamenti, i raporton këtij Parlamenti.

Ne e kemi theksuar sa herë, që katër vjet me radhë: le të zbatohet Kushtetuta e Republikës së Kosovës, le të zbatohen ligjet e Republikës së Kosovës, le të zbatohet Rezoluta e cila është nxjerrë si obligim për ta zbatuar kjo Qeveri. Le të zbatohet strategjia, e cila ka pas afat 6 muaj - Strategjia për sigurinë, e tash jemi në muajin e shtatë, që në vend se Qeveria të jep llogari këtu për punët që i ka bërë në aspektin e sigurisë, këtu tash na tregon se ka me u bë rishikimi i strategjisë, para se të japë raport se çka u bë pra, me strategjinë e mëhershme.

Po ashtu, kur Kuvendi ose komisionet parlamentare duan ta ndihmojnë Qeverinë që të zbatojë Kushtetutën, të zbatojë ligjet, të ketë rregull në këtë vend, përkundrazi kemi deklarata, thotë, se në fund të fundit si japin llogari as komisioneve të Kuvendit as këtij Kuvendi, sepse e kanë një shuf të cilit i japin llogari duke qenë mbret i këtij vendi, sepse vetëm vendimet e tij vlejné dhe nuk vlejné vendimet e këtij Kuvendi ose dokumentet që i prodhon ky Kuvend.

Është nxjerrë një rezolutë, që të raportohet këtu mbi bisedimet. Asnjëherë nuk është raportuar këtu në tre muaj, siç parasheh rezoluta, në mënyrë që si deputetë të kemi një dokument, mbi të cilin mund të thirremi. Ne nuk i dimë as dokumentet, të cilat janë bërë, janë prodhuar si marrëveshje, të cilat janë quajtur konkluzione, për t'i ikë përgjegjësisë në Parlament.

Dhe, çka ka fituar Kosova? Kosova ka fituar vrasje të qytetarit dhe të policit, ka fituar përdhosje të uniformës, ka përfituar shembje të një pike, e cila vendoset për të mbrojtur qytetarët, si polici që e ka për obligim. Kemi po ashtu, burgosje të njerëzve në Serbi. Kemi zbrazje të territorit, sepse shqiptarët nga pjesa veriore janë kah ikin, sepse s'po ka kush t'i mbrojtë. Se iu është thënë që nëse mbroheni vetë mirë, nëse s'mundeni, institucionet nuk po munden t'ju mbrojnë. Këto institucione janë themeluar që t'i mbrojnë qytetarët.

Dhe po ashtu, kemi gjobitje të qytetarëve të Preshevës, Bujanocit e Medvegjës, të cilët në vend se t'iu mundësohet lëvizja më e lirë, tash përkundrazi ne i kemi kufizuar. Ata nuk mund të vijnë sa herë të duan, për arsye se duhet të ndërrojnë tabela, sepse një pjesë e tyre jetojnë në komuna të Kosovës, duhet po ashtu të paguajnë taksa, të cilat janë të larta edhe i kemi paralizuar, në vend se

t'ju ndihmojmë. Unë s'po e di tash, me çfarë logjike mund të thirremi në këto bisedime? Edhe po shkohet edhe më tutje, sa zoti Stefanoviq thotë: Status special për veriun! Domethënë, po deklaroi ai, i cili deri sot ka qenë në bisedime me Kosovën në raportin e ndryshimit të çështjeve, të cilat kanë qenë të kontestueshme në mes Kosovës dhe Serbisë.

Dhe po ashtu, këtu kemi deklarime të çuditshme! Thonë, nuk përdorim dhunë, dikush po kërkon dhunë. Po ju lutem, ne po themi zbatoheni Kushtetutën dhe ligjet. Kurrkush s'po thotë as ashtu, as kështu. Tjetër fjalor nuk është kah përdoret këtu. Dhe dikush po do me ju justifikua tash, me përdorë dhunë ndaj qytetarëve. Kush ka thënë ndaj qytetarëve? Dhuna ndaj qytetarëve të veriut po përdoret nga bandat, nga krimi, nga institucionet e Serbisë, të cilat janë instaluar.

Cili është obligimi i institucioneve të Kosovës? Është që, ata që po ushtrojnë dhunë në veriun e Kosovës, t'i godasë dhe të mos i lejojë që në një territor të shtetit sovran të veprojnë grupe kriminale dhe banda, të cilat e frikësojnë qytetarin.

Përkundrazi, ne po themi: urdhëroni, zbatoheni ligjin dhe Kushtetutën, siguron qytetarët atje që të jetojnë të qetë, sepse janë nën terrorin e bandave, të cilat i ka imponuar një shtet tjetër.

Dhe po ashtu, kemi tash hyrje të autoriteteve të Serbisë, për shkak të fushatës që bëhet në veriun e Kosovës. Dhe, e dini cili është tash arsyetimi ose alibia, për të mos vepruar? Se ata po hyjnë përmes rrugëve alternative!? Domethënë, mbasi s'po hyjnë përmes rrugëve zyrtare, në pikë kufitare, ata mund të shëtisin kah të duan në territorin e Kosovës!

Kjo është edhe për Qeverinë, kaq serioze. Kjo është edhe për EULEX-in, KFOR-in, e instrumentet tjera, sepse ata në mes të qytetit janë kah qëndrojnë. Ata po mbajnë fushatë me qytetarët dhe janë publikë dhe kurrkush s'shkon t'i kapë e t'i qesë jashtë territorit ose t'i arrestojë, sepse paskan hyrë kontrabandë e kontrabanda nuk duhet të preket, sepse ajo duhet të lejohet të veprojë, meqë nuk ka të bëjë me hyrjet legale dhe të ligjshme!

Dhe, për fund, më lejoni që t'ju them se - kësaj Qeverie s'kemi çka t'i japim tjetër. Unë s'di çka mund t'i japim më shumë, përveçse t'ua fotokopjojmë edhe një herë Kushtetutën, rezolutat e nxjerra në këtë Parlament, strategjinë e cila është përpiluar pikërisht nga kjo Qeveri, e që nuk është zbatuar, dhe kurrgjë tjetër. Ose, në të kundërtën, kjo Qeveri le të tregojë se nuk i përgjigjet Parlamentit, nuk iu përgjigjet qytetarëve të Kosovës, s'ndjejnë asnjë obligim dhe atëherë qytetarët le ta marrin situatën në dorë, sepse kjo Qeveri qenka e pafuqishme për të bërë veprime të duhura institucionale në këtë vend. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Deputeti Jeton Svirca, e ka fjalën!

JETON SVIRCA: Falemnderit, i nderuari nënkryetar!

I nderuari kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të gjithë e dimë se gjendja në veri është shqetësuese dhe e papranueshme për të gjithë qytetarët e vendit. Andaj përshkrimi i gjendjes nga ana ime, është e panevojshme.

Si deputet i kam disa kërkesa e rekomandime, të cilat do t'ua prezantoj dhe sigurisht që i keni dëgjuar, por kërkoj që së bashku t'i realizojmë.

- Të kemi unifikim të gjithë faktorit politik, të kemi një platformë politike, një strategji, që do t'ia prezantojmë bashkësisë ndërkombëtare, prej të cilës do të kërkojmë mbështetje dhe përkrahje aktive për veprim në veri.
- Në koordinim dhe bashkëpunim në mes të KFOR-it, EULEX-it dhe Policisë së Kosovës, të forcohet siguria në vend.
- Në veri të vendit të hiqen barrikadat, të vendoset rendi dhe siguria për të gjithë qytetarët, pa vonesa.
- Të përmbushen obligimet që dalin, pra nga Pakoja e Ahtisaarit, për pjesën veriore.
- Të zbatohen marrëveshjet e arritura, pra të zbatohet reciprociteti i plotë në marrëdhëniet bilaterale, posaçërisht në tregti, në komunikacion dhe në lëvizje të qytetarëve.
- Të organizohen zgjedhjet për pushtetin lokal nga institucionet tona.
- Me ndihmën e Bashkësisë Ndërkombëtare, të ndërpritet financimi i strukturave paralele serbe.
- Qeveria e Serbisë, sipas informatave, ka investuar rreth 350.000.000 në vit për serbët e Kosovës, që të mos kyçen në strukturat e shtetit të Kosovës. Kjo pra, duhet të ndërpritet.
- Qeveria e Kosovës të ndajë një fond të veçantë dhe ministritë të koncentrohen me plane e projekte të zbatueshme për veriun e Kosovës.
- Banorët e veriut të trajtohen në mënyrë speciale, t'iu jepen ndihma sociale të gjitha familjeve, të cilat banojnë atje.
- Të shtohen investimet për rindërtimin e shtëpive për ata banorë që kthehen për të jetuar në veri.

Të nderuar kolegë deputetë,

Qeveri e nderuar,

Për çështjen nacionale pra, duhet të jemi të bashkuar dhe të veprojmë në mënyrë praktike dhe në këtë drejtim bashkësia ndërkombëtare duhet të na përkrahë dhe të na ndihmojë më shumë.

Për fund, shpresoj se fjalët të cilat i themi ne sot këtu në seancë, të mos jenë vetëm citime tona, por të bëhen edhe vepër. Ju falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Fjalën e ka zonja Trajković!

RADA TRAJKOVIĆ: Da li može da me ona zameni, pošto je ona po strukturi, a ja posle nje?

KRYESUESI: Može, može!

RADA TRAJKOVIĆ: Hvala, velika!

KRYESUESI: Atëherë, fjalën e ka deputetja Mikiq!

VESNA MIKIĆ: Hvala predsedavajući!

Uvaženi poslanici,

Dame i gospodo,

Danas smo se okupili ovde da bi raspravljali o severu Kosova i verujte mi da sam na trenutak pomislila da se nalazim u Parlamentu Beograda, jer se više puta pomenuo Beograd, Srbija, srpski narod, srpska zajednica nego li problemi na severu, problemi na celokupnoj teritoriji Kosova.

Gospodo, problem na severu Kosova je sam po sebi. Tačno je da je politički velik, ali taj problem se neće rešiti na ovakav način.

Problem Kosova, tojest severa Kosova je ništa drugo nego do kopije vaše, tojest kopije albanske zajednice 90-tih godina.

Verovatno se sećate da ste 90-tih godina gotovo pune dve decenije ignorisali sistem Republike Srbije, ali ste zato koristili sve benifite poput dečjih dodataka, plata, penzija, i tada je bilo sve u redu. A sada, odjednom, kada se neko drugi našao na većem mestu, to izaziva problem.

Najmanje će vam poslužiti ukoliko pribegnute nasilnom rešavanju problema na severu. Kao što sam pročitala u članku juče, da će se čak pribeci sili kao i da se mobilizuje policija i bezbedonosne službe da se deluje na severu. Jer verujte mi, to će ići na vašu štetu, jer ste svih ovih godina u očima međunarodne zajednice, u očima Amerike, KFOR-a, Evropske Unije, bili žrtve. A sada ste se odjednom, preko noći transformisali u ulogu dželata. Pa zamislite kakav ćete utisak ostaviti u njihovim očima. Ne mislite valjda, da ćete izgubiti benifit kod međunarodne zajednice pa da se stvari okrenu na vašu štetu.

I naslušala sam se ovde iz ovih monologa, svega i svačega. Ali nikako da čujem neki konkretan predlog rešenja tih problema na severu.

Svi ovde pričamo o neakvim akcijama, kao da se ne radi o ljudima, kao da se radi o ne znam, ne znam o čemu zaistam kao da to nisu ljudi - živa bića, već da su to predmeti. Problem se ne rešava nasilnim putem. Problem se mora rešiti za govornicom i za stolom.

A neko je rekao odavde od poslanika, da se ne treba pregovarati sa Srbijom. Ne da se ne treba pregovarati, već se verovatno na ovakav način i ne može pregovarati.

Verovatno će se umesto albanske strane tražiti da se oko problema sa severom razgovara sa međunarodnom zajednicom, da vas predstavlja neko od međunarodnog faktora. Baš zbog ovakvog

izliva besa i zbog ovakvog pucanja ili ponižavanja srpskog naroda i srpske zajednice, vi ovde, u ovom domu vredate kompletan srpski narod, i krivite samo Srbiju i srpsku zajednicu.

Problem nije u Srbiji. Problem je ovde. Problem je na Kosovu! Problem je u kriminalu, u korupciji, koji nas okružuje.

I verujte mi, čak je i ministar rekao, sa njim se naravno neću složiti kada je kazao da je situacija na celokupnoj teritoriji Kosova relativno mirna ako isključimo sever Kosova. Nije istina, gospodine ministre. Situacija nije mirna u opšte, pogotovo za srpsku zajednicu.

Ja ću samo navesti primer Srpske zajednice u opštini Ranilug. Tamo nema korupcije i kriminala! Opština Ranilug važi za jednu od najboljih novih decentralizovanih opština u svom radu. Ali vi ste gospodine ministre, ne znam iz kojih razloga, poslali vašu policiju, to jest policiju iz, kako se zove, i ne znam ni ja sama verujte - pograničnu, pripadnike zelenih linija da 24 časa na ulazu u opštini Ranilug zaustavlja stonovništvo, lokalno stanovništvo, pretresa i vrši takvu premetačinu i zastrašuje srpsku zajednicu. Ne znam zaista, koji je povod za takvo delovanje.

Pa verujte mi da ste trebali da povučete te vaše patrole i da ih dovedete ovde u ovom domu, iz razloga što upravo ovde u Vladi Kosova i ovom domu ima više kriminala i korupcije, negoli na celoj teritoriji Kosova i Metohije.

Ja ću na kraju samo da kažem i da se obratim ženskom delu u ovom domu, da ih samo pitam: da li su spremne da rađaju i da neguju svoju decu da bi njihovi životi bili izloženi u nekom novom sukobu i da izgube svoju decu?! Mislim da nijedna žena nije spremna da podrži nasilan način rešavanja problema.

Nas ovde čini 30% i tih 30% trebalo bi da podigne glas protiv bilo kog načina nasilnog rešavanja problema.

Za svaki problem postoji rešenje ali je potrebna samo dobra volja. Vi očigledno, koliko god se trudili tu dobru volju ne pokazujete. Čak bi se možda i sever Kosova, svojevolejno integrisao u ove institucije, ali vi niste dali dobar razlog i dobar povod. Najgori i veoma loš primer smo mi, nove decentralizovane opštine, tako što zakoni koji se tiču Srpske zajednice koji dolaze ovde kroz Skupštinsku proceduru, bivaju osakaćeni. Znači, ne onako kako stoji u Ahtisarijevom planu, već onako kako odgovara vladi. I po ko zna koji put je dokazano da na žalost, vlast i u politici pobeđuje većina, a ne inteligencija i pamet.

Ja se nadam da će u nekom drugom sazivu doći neki novi i neki pametni ljudi, koji će voditi razumnu politiku, koji će se ponašati isto i jednako prema svim zajednicama na Kosovu. Tek tada može zaživeti neki zajednički suživot, da se poboljša kompletna slika celokupnog kosovskog društva.

Na kraju ću samo da kažem da od svih poslanika iz albanske zajednice koji su danas govorili, najbolju ocenu je o celokupnom problemu na Kosovu i o kompletnom društvu na Kosovu, dao gospodin Ardian Gjini. Svaka čast i respekt za takvu percepciju okolnosti i problema u kojima se celokupno društvo nalazi. Hvala vam!

KRYESUESI: Falemnderit! Zoti Bedri Hamza e ka fjalën!

BEDRI HAMZA: Falemnderit, zoti kryesues!

I nderueri zoti kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar ministra,

Deputetë të nderuar,

Nga diskutuesit paraprakë u diskutua zbatimi i ligjit. U diskutua dhe u ngritën problemet reale ekzistuese.

Nuk do të flas për zhvillimet dhe veprimet, që do të por që kanë ndodhur. Pas datës 25 korrik, në vendkalimet kufitare 1 dhe 31 i kemi prezentë doganat e Kosovës.

Doganat kanë qenë prezentë edhe në të kaluarën, por kanë qenë doganat e UNMIK-ut dhe sot i kemi prezentë doganat e Republikës së Kosovës.

Në atë pjesë ka vazhduar shtrirja e institucioneve të Kosovës. Ka vazhduar shtrirja dhe prezenca edhe me probleme të Administratës Tatimore të Kosovës, ku në kuadër të këtij institucioni ka inspektorë nga komunitetet që jetojnë në Kosovë. Ka edhe serbë të cilët punojnë në këtë institucion dhe e kryejnë punën e tyre në përputhshmëri dhe në zbatim të ligjeve të Kosovës.

Kanë ndodhë investime në veri. Sot është duke iu ofruar numri i qindra shtëpive të rindërtuara në atë pjesë, në Lagjen e doktorëve, Kroi i Vitakut dhe në pjesë tjera. Kanë ndodhur investime milionëshe, në rrugët fshatrave që shtrihen në komunën e Zveçanit, në Zhazhë, Kelmend dhe Boletin, ndërtimi i ujësjellësit. Ka ndodhë ndërtimi i rrugëve, ndriçimit publik, ujësjellësit, shtëpive, në Lagjen e Doktorëve. Ka ndodhë ndërtimi i rrugës dhe projekteve tjera në Suhodoll, Gushavc, Vinarc dhe Çabër.

Ne përveç Ligjit të Buxhetit, pra duke e zbatuar Ligjin për menaxhimin e financave të pushtetit lokal, ku bëhet ndarja e buxhetit për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, në bazë të formulave të granteve, kemi dashur që të gjithë qytetarët, pa dallim etnie, t'i trajtojmë dhe të kontribuojmë në përmirësimin e cilësisë së jetesës së këtyre qytetarëve, përmes USAID-it dhe donatorëve tjerë. Nga buxheti i Republikës së Kosovës ne kemi ndarë miliona euro investime.

Sigurisht se gjithmonë ka vend për më mirë dhe më shumë, por përkushtimi dhe puna e Qeverisë së Republikës së Kosovës do të vazhdojë në përmirësimin e cilësisë së jetesës për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Dhe, igurisht se zbatimi i ligjit duhet të jetë prioritet dhe ne do të vazhdojmë me përkrahjen për investime të projekteve të reja në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, pa dallim për të gjithë qytetarët e Kosovës, a janë ata të përkatësisë shqiptare, serbe apo të ndonjë komuniteti tjetër, që jeton në atë pjesë.

Prandaj, mos të flasim se nuk kanë ndodhë veprime pozitive gjatë këtyre viteve. Vetë prezenca e Doganës së Republikës së Kosovës në vendkalimet kufitare 1 dhe 31 tregon shtrirjen e sovranitetit, prezencën e shtetit të Kosovës në gjithë territorin. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Fjalën e ka deputeti Ramiz Lladrovci!

RAMIZ LLADROVCI: Falemnderit, nënkryetar!

Për ta lehtësuar punën e kësaj seance të jashtëzakonshme të Kuvendit, unë po e dorëzoj diskutimin tim me shkrim, sepse edhe nuk kam me thënë diçka më shumë se sa që u tha deri më tani. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Zoti Ferati e ka fjalën!

SADRI FERATI: Falemnderit, i nderuari kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Jemi dëshmitarë se situata në veri të Kosovës, dhe sidomos në pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës vazhdon të jetë e rëndë dhe komplekse.

Do të ju përkujtoj edhe një herë vetëm mbrëmjen në mes të 3 dhe 4 shkurtit, kur u torturuan dhe u vranë dhjetëra shqiptarë e dhjetëra të tjerë u plagosën dhe u depërtuan, pra u larguan nga shtëpitë e tyre mbi 10 mijë shqiptarë nga ajo pjesë e qytetit të Mitrovicës.

Fillimisht, janë arrestuar si të dyshimtë disa qytetarë të asaj pjese, por, në rrethana asnjëherë të shpjegueshme kanë ikë nga burgu dhe ata apo dikush tjetër, që janë vrasësit, po shëtisin të lirë. Dhe, mund ta merrni me mend se cila është pra, perspektiva e asaj pjese, kur kriminelët shëtisin të lirë.

Në interesimet e vazhdueshme të institucioneve qendrore dhe lokale, atëherë nga UNMIK-u vazhdimisht kemi marrë të njëjtën përgjigje: “Kjo është përgjegjësi e jona, ju vazhdoni me obligimet e juaja, sepse ne do ta tejkalojmë këtë situatë dhe situata është stabile.”

Dhe, cila është ajo situatë stabile, që edhe sot e kësaj dite ne po e shohim? Është vazhdimisht një degradim i situatës atje. Një forcim i atyre strukturave, i atyre grupeve të cilët vazhdimisht ushtrojnë terror mbi qytetarët e Kosovës në atë pjesë.

Pra, jemi dëshmitarë që gjatë këtyre 13 vjetëve vazhdon një situatë përafërsisht e njëjtë, me disa oscilime dhe më mirë kisha mund të them, atëherë kur po lodhen, po pushojnë dhe po kthehen po vazhdojnë me të vjetrën.

Vetëm të jeni dëshmitarë, kur dëgjohen alarmet e sirenave, tri sirena në tri vende, në një kilometër katror, dhe thirrja për grumbullim, rezistencë dhe sulme dhe mund ta merrni me mend se cila është jeta e qytetarëve, sidomos e qytetarëve jo serbë në atë pjesë.

Po dua të theksoj se jo vetëm qytetarët shqiptarë i nënshtrohen atij sulmi dhe atij represioni. Të jeni të bindur se atje, secili që mendon ndryshe, në krahasim me këtë grup të njerëzve që është mbi ligjin, po ashtu, janë të rrezikuar. Kemi rastin e tentim të atentatit në deputetin Miletqi, kemi rastin kur hidhen bomba dhe “koktele molotov”, nga të gjithë ata të cilët dëshirojnë ta dëgjojnë edhe zërin e Prishtinës, dëshirojnë të bashkëpunojnë me institucionet vendore dhe ndërkombëtare për ta diskutua një perspektivë dhe për të definuar se kjo gjendje nuk krijon perspektivë për askënd. Pra, as për qytetarët e komunitetit serb në atë pjesë.

Prandaj, atje kemi të bëjmë me grupe që vrasin dhe i terrorizojnë qytetarët. Këto grupe mbrohen dhe përkrahen nga Beogradi dhe strukturat e instaluara në atë pjesë.

Unë kam përshtypje se atje janë humbur të gjitha fijet e kontrollit dhe të veprimit të gjithë akterëve, që janë përgjegjës për progresin në atë pjesë.

Unë mendoj se veriu i Kosovës po e sfidon funksionalizimin dhe zhvillimin e shtetit të Kosovës dhe perspektivën e qytetarëve të Kosovës.

Prandaj, pa humbur shumë kohë, mendoj që Policia e Kosovës, gjithsesi në bashkëpunim me KFOR-in dhe Policinë e EULEX-it duhet të mbrojë jetën e qytetarëve atje. Të krijojë një ambient të sigurt për ekzistencën e tyre.

E them këtë gjithsesi për arsye se në ngjarjet e fundit ne e pamë se angazhimi i vetëm policëve, do të jetë i pamjaftueshëm dhe i gabueshëm, për dy arsye:

E para, se është një kapacitet i pamjaftueshëm, që të përballohet me ato masa, të cilat ftohen në mënyrë të organizuar dhe dihet nga cili alarm, dihet se na cili vend, se kush i aktivizon dhe kush i komandon ato.

Nga ana tjetër, kemi një ambient dyshues, pra luhatja e një besimi se një polic i Kosovës mund të jetë i arsyeshëm në një moment, i cili nuk mund ta mbrojë as vetveten e lëre më qytetarët atje.

Prandaj, domosdoshmërisht, bashkërisht me KFOR-in dhe EULEX-in duhet të sigurojmë jetën e qytetarëve dhe të bëjmë patrullime të vazhdueshme, për ta krijuar një ambient që qytetarët të ndihen të lirë dhe të sigurohet lëvizja e qytetarëve.

Gjithsesi, të rritet sundimi i ligjit dhe sa më shpejtë të funksionalizohet sistemi i drejtësisë atje, mendoj në gjykatat, prokuroritë dhe në gjithë mekanizmin përcjellës. Të sigurohet një mbështetje financiare për familjet e asaj pjese, sidomos të Kodrës së Minatorëve, të cilët në mungesë të lirisë së lëvizjes nuk mund të punësohen, ndërsa gjendjen materiale e kanë shumë të vështirë dhe është e domosdoshme që të krijohet një fond që atyre, që pa fajin e tyre nuk mund të punojnë, të iu jepet një mbështetje financiare deri në përmirësimin e kësaj situate, e më tutje.

Qeveria shumë shpejt duhet ta bëjë publike planin e veprimit, që i dedikohet integritetit të asaj pjese të Kosovës, duke filluar nga sensibilizimi i asaj situate, nga denoncimi dhe komprometimi i sjelljeve të Beogradit dhe strukturave që ushtrojnë dhunë mbi qytetarët, t'i informojmë mirë qytetarët se çka ofron, se për cilat të drejta, se cili është shteti i Kosovës dhe unë mendoj se kemi mjaft për të treguar, ngase Kosova është shpall shtet i të gjithë qytetarëve të saj, që iu siguron barazi për të gjithë qytetarët e saj, mundësi të barabarta dhe perspektivë të barabartë.

Të jeni të sigurt se një numër i madh i qytetarëve atje, i ndikuar nga një indoktrinim njëzetvjeçar nuk është mirë i njoftuar për këtë. Pastaj, të stimulohet ushtrimi i përgjegjësiave të ministrive sektoriale, që ata të jenë prezentë atje dhe të japin kontributin e tyre.

Gjithashtu, që të pengohet shumë shpejt dhe rreptësisht, secilido krim ekonomik, sepse përveç dëmit që i bën buxhetit të Kosovës, ato përfitime nga ky biznes prapë mbesin në duar të atyre të cilët do ta përdorin për fuqinë dhe ushtrimin e dhunës së mëtejme nga se krimi i organizuar në atë pjesë është mirë i lidhur edhe me politikën ditore dhe mirë i lidhur me atë pjesë ekstreme, të cilët vërtetë e mbajnë në duar situatën atje, fatkeqësisht, por kjo është e vërteta. Të bëjë promovimin e të gjitha vlerave dhe gjithë arritjeve pozitive të Kosovës, në pjesën tjetër të Kosovës.

Unë pajtohem me ata që thonë se tani komuniteti serb, në pjesën tjetër të Kosovës, çdo ditë e më tepër po e bën një avancim dhe po ndodhë një integrim, ku nuk është mjaft, por sukseset janë evidente. Dhe, unë mendoj se shumë qendra, të cilat dyshojnë, nuk janë mirë të njoftuar se tani në prag të Prishtinës qytetarët janë të lirë, e kanë komunën e tyre, i kanë marrë përgjegjësitë e tyre, bien vendime të mira dhe i kontribuojnë jetës së qytetarëve. Dhe, për gjithë këtë afirmim duhet kërkuar një shpjegim. Por, edhe se cili është problemi që qytetarët e komunitetit serb, që kanë filluar të akomodohen e të integrohen dhe kanë filluar me e pa shijen e zhvillimit në Kosovën tonë, kurse e njëjta nuk mund të jetë edhe në veri?

Atëherë, përgjigja do të jetë: Kjo është pasojë e ambicieve joreale, që ata po e ndërtojnë në atë pjesë, një veprim destruktiv i Beogradit dhe krimi që po dominon në atë pjesë. Përndryshe, shumë më lehtë do ta kenë ata që të jetojnë mirë se sa serbët në pjesën tjetër të Kosovës, që megjithatë kanë filluar me e shënuar një progres edhe më tutje.

Dhe, unë besoj se të gjitha këto që u thanë, po që se realizohen me përpikëri, në rend të parë nga KFOR-i, EULEX-i, nga Policia e Kosovës dhe nga Qeveria e Kosovës, do të jenë hapa të parë të cilët do të mundësojnë fillimin e një progresi, krijimin e një ambienti që më tutje të organizohen zgjedhjet e lira dhe nga atje, pastaj, do të dalin struktura legjitime dhe të përgjegjshme për të mundur me e integrua atë pjesë të qytetit dhe për të mundur me e normalizuar jetën në tërësi, në Kosovë. Ju falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Zoti Konjufca e ka fjalën!

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës!

Qeveria e Republikës së Kosovës i pati filluar negociatat me Serbinë në mars të vitit të kaluar, me tri arsyetime, të cilat po ua përkujtoj, nëse i keni harruar.

E para, se kështu po i normalizon marrëdhëniet me Serbinë.

E dyta, se në fund Serbia do të na pranojë si shtet, dhe

E treta, motoja e famshme e Edita Tahirit, se kështu shpërbëhen strukturat kriminale të Beogradit në Kosovë.

Zonja Tahiri na pati thënë po ashtu, se futnota 1244 do të shkrihet si “fluskë bore”, por në të vërtetë ato që janë tretur krejtësisht, janë këto tri premtime, që i përmenda, të dhëna nga politikanët tanë qeveritarë.

A më thoni, deputetë të nderuar të Kuvendit të Kosovës, se cilat janë rezultatet konkrete të negociatave dhe çka ndodhi me këto premtime të dhëna? Të shkojmë me rend!

E para, ishte normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë. Për çfarë normalizimi të marrëdhënieve na flet kryeministri dhe zonja Edita Tahiri, kur Serbia vetëm për një muaj na i ka arrestuar policët tanë brenda territorit të shtetit, po arreston shqiptarë në Merdare, ish ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të akuzuar nga Serbia për krime lufte. E ka arrestuar dhe ende po e mbanë në burg sindikalistin Hasan Abazi, i ka paralajmëruar për t'i mbajtur zgjedhjet e saj të paligjshme në Republikën e Kosovës, dhe jo vetëm kaq!

Të gjitha marrëveshjet e kësaj Qeverie me Serbinë në Bruksel, janë shembull tipik i jonormalitetit të marrëdhënieve. Jo vetëm që marrëdhëniet me Serbinë i kemi jo normale, por me negociata, ky jonormalitet është normuar.

Si mund të quhen këto negociata normalizim i marrëdhënieve me Serbinë, kur të gjitha marrëveshjet e arritura janë të njëanshme.

Qeveria ka heqë dorë nga sovraniteti në të gjitha marrëveshjet e arritura, duke filluar prej targave të automjeteve e deri të futnota.

Normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë nuk mund të bëhet duke e lejuar Serbinë, që ta ruajë Kushtetutën e vetë, e Kosovës duke i kërkuar që të përshtatet vazhdimisht. Ky është institucionalizim i marrëdhënieve jonormale, që i kemi me Serbinë.

Arsyeja e dytë, që u pat përmendur atëherë, ishte se në fund Serbia do të na pranojë si shtet.

Sa ai përket Serbisë, ajo nuk po ndryshon edhe përkundër iluzioneve të Qeverisë dhe të Bashkimit Evropian.

Pa e kushtëzuar hyrjen e Serbisë në BE, me njohjen e pavarësisë së Kosovës, Serbia kurrë nuk do të heq dorë nga Kosova. Ndoshta Serbia nuk do të heq dorë nga Kosova edhe atëherë kur të kushtëzohet dhe ndoshta më parë do ta braktisë edhe BE-në, por së paku le ta paguajë çmimin.

Serbisë nuk duhet t'i thuhet: ose BE-ja ose Kosova, sepse ajo gjithmonë thotë Kosova. Serbisë duhet t'i thuhet ose BE-ja ose asnjëra.

Kështu siç po shkon, duke ia mundësuar moton Tadiqit - edhe Kosovën edhe BE-në, ne jemi si popull dhe si shtet ata që po e paguajmë çmimin, që do të duhej ta paguante Serbia, në të vërtetë.

Në këtë mënyrë edhe po ia mundësojmë fitoren e zgjedhjeve Tadiqit, edhe ruajtjen e strukturave kriminale brenda Kosovës, edhe negociatat për veri, edhe statusin kandidat për BE, edhe po i mirëmbajmë ambiciet hegjemoniste të shtetit serb, në këtë mënyrë. Kjo është një politikë e mbrapshtë, prej të cilës veç po humbim vazhdimisht.

Hajde diqysh do të ishte e kuptueshme, nëse dikush bënë kompromise, ashtu që këto të përkthehen në hapa konkretë që e ndryshojnë Serbinë. Por, në njërin anë të pajtohesh ta dëmtosh vetveten me futnota e me marrëveshje të njëanshme, e në anën tjetër Serbia t'i arreston policët brenda shtetit dhe t'i vret qytetarët me sulme terroriste, këtë me të vërtetë nuk e bën asnjë qeveri në botë, asnjë qeveri normale, përpos Qeverisë tonë.

Ky është shpërblimi pra që po na e sjell Qeveria jonë, me negociata me një shtet i cili nuk e merr vesh dialogun, e na ka treguar edhe në të 99-tën, që nuk e merr vesh dialogun, as nuk e ndryshon qëndrimin ndaj shqiptarëve, pa e ndryshuar ne qëndrimin si institucione ndaj kësaj Serbie armiqësore.

I treti arsyetim, kur patën hyrë në negociata, pra pat qenë motoja e famshme e Edita Tahirit, se kështu do të shpërbëhen strukturat kriminale të Beogradit në Kosovë!

Zonja Edita Tahiri pati thënë se prej 1 nëntorit të vitit të kaluar, nuk ka struktura të paligjshme të Beogradit, në Kosovë.

Unë e shtroj pyetjen: Kush e vrau Selver Haradinajn? Pra, pyetja: Kush e vrau Selver Haradinajn?

Jo vetëm që Selver Haradinaj u vra nga strukturat kriminale të Serbisë në veri, por ai madje u vra edhe me sulm terrorist. Me këtë sulm nuk është mësyre vetëm familja Haradinaj, po secili prej nesh si qytetarë të Republikës së Kosovës. Dhe, të gjithë jemi të indinjuar nga ky terrorizëm. Të gjithë, përveç kësaj Qeverie.

Jemi mësuar shpesh nga këta qeveritarë ta dëgjojmë atë recitimin e famshëm, “ju nuk jeni më patriotë se ne”, “ju nuk e doni Kosovën më shumë se ne”, por patrioti vepron, nuk reciton. Lëreni patriotizmin tuaj, të cilin dini ta tregoni vetëm me mburracakëri e propagandë kundër opozitës. Patriotizmi tregohet ndaj Serbisë, jo ndaj opozitës.

Këtu, më herët patëm rastin ta dëgjojmë edhe zotin Kuçi bile, i cili tashmë nuk qenka këtu, që ia nisi me të flet për një shpërngulje imagjinare të serbëve me traktorë në veriun e Kosovës.

Unë kisha thënë, leni këto shpërngulje imagjinare të serbëve me traktorë, po unë po ju informoj për një shpërngulje jo imagjinare, por reale të qytetarëve shqiptarë nga veriu i Mitrovicës, më saktësisht nga zona e tre rrokaqiejve. Deri pardje janë shpërngulë realisht, 40 familje shqiptare nga zona e tre rrokaqiejve e veriut të Mitrovicës. T’u ndihmohet atyre dhe t’u sigurosh atyre siguri, ky është patriotizëm i vërtetë.

Edhe diçka, sa i përket policëve të arrestuar, për të cilët është folur shumë, të cilët na i arrestoi Serbia. Dikush edhe mund t’iu bie atyre në qafë, sa i përket syçeltësisë dhe kujdesit, por unë atyre nuk iu vë faj aspak.

Çka kanë faj ata të shkretit, që e kanë pa në televizor këtu në Parlament Bajram Rexhepin apo kryeministrin tonë, që na flasin për Serbinë evropiane dhe fqinjësor?

Çka kanë faj ata, që e kanë pa në Bruksel Edita Tahirin, që buzëqesh për zemërsisht me Boris Stefanoviçin?

Ata djem kanë ecë shirë, të relaksuar me fjalët e Edita Tahirit dhe kryeministrit në kokë dhe e kanë gjetur veten në një spektakël poshtërues përgjegjësinë kryesore për të cilën duhet me e mbajtur politika zyrtare, e jo ata.

Politika është llogaridhënie, përgjegjësi dhe hierarki. Kjo që na ka ndodhë është pasojë e një politike, e cila nuk po do me i çelë sytë, edhe përkundër poshtërimeve të vazhdueshme, që po na i bën Serbia.

Ata që u poshtëruan atë ditë, nuk ishin vetëm policët, si të tillë. Atë ditë u poshtërua Republika e Kosovës.

Dhe, në fund, ajo që ishte vërtetë e turpshme në krejt këtë ngjarje, mbetet porosia e pushtetit për policët e rrëmbyer, që pas lirim të mos flasin asgjë.

A më thotë dikush, a ka turp më të madh se sa polici i rrëmbyer, nga frika se mos e humb vendin e punës, në pyetjen e gazetarit se: si kanë kaluar në Serbi, të kidnapuar, i frikësuar se mos po thotë diçka që nuk i pëlqen Qeverisë, thotë: “Kemi kaluar shumë mirë atje në Serbi!”.

Këtij poshtërimit po i ndihmon edhe Qeveria jonë, e cila me këtë politikë, policisë dhe Republikës po ia humb fytyrën, kurse Serbisë po ia shpëton fytyrën.

Prandaj, sot e tutje kësaj Qeverie nuk do t’i kërkojmë asgjë. Nuk do t’i themi bën kështu ose bën ashtu, për sa kohë që e vetmja gjë e mirë, të cilën ajo mund ta ofrojë është vetëm një: dorëheqja e saj!

KRYESUESI: Edhe nja dy vjet e gjysmë i ka mandat! A ka dikush i AAK-së, që do me marrë fjalën? Po m’duket s’ka të paraqitur.

(Ndërhyrje)

Jeton Svirca, ka folur. Atëherë fjalën e ka, Rada Trajković!

RADA TRAJKOVIĆ: Poštovani kolege poslanici,

U ovom teškom trenutku, za sve nas, kada nažalost imamo ubijenog čoveka i povređenu decu, očekivala sam da svi budemo na nivou zadatka u smislu oduzimanja argumenata ekstremistima da nastave nešto što je udaljavanje zajednice Srba i Albanaca na prostoru Kosova i Metohije.

Ja bih jako volela da znamo ko je počinio taj kukavički čin i da danas on bude izveden pred licem pravde.

Ja, odavno sam u politici i potpuno pripadam ljudima koji se bore za teritorijalni integritet ovoga prostora. I potpuno želim iskreno da vam kažem i da dobijem podršku odgovornih ljudi u ovom Parlamentu, za nešto što je projekat za koji se borim. Taj projekat podrazumeva da isti stepen samostalnosti ili autonomije severa, moraju da dobiju svi Srbi na prostoru Kosova i Metohije.

Ne ulazim u to, kako će se dogovoriti ali ne može se praviti diskriminacija između Srba ispod Ibra i Srba iznad Ibra.

Najbolja preporuka za integraciju severa Kosova i Metohije, svakako bilo bi sprovođenje ili primer sprovođenja plana Ahtisarija ispod Ibra.

Ali tu imamo mnogo problema! Koliko pre dva dana, neko je želeo da skine sa pečata Đenerala Jankovića - ime Đeneral Janković i ostavi samo Hani i Elezit. Koliko juče, prekjuče na kancelariji gospođe predsednice, očekivala sam da piše „Kancelarija“ ali piše „Ured“, što je isto nešto što udaljava od jezičke ispravnosti i poruke Srbima da je to i njihova kancelarija.

Strukovno, mnogi novinari Srbi su se okupili da zajedno urade Zakon o informisanju, da zajedno budu aktivni učesnici donošenja zakona i dogovora sa albanskom većinom, ali mi smo dobili zakon koji je potpuno u suprotnosti onoga što je bio njihov rad i što je bila preporuka gospodina Ahtisarija. I to prelazi da bude kontinuitet usvajanja zakona, koji se izmenjuju da to postaju surogat zakoni iz programa Ahtisarija a ne zakoni, na osnovu koga je i proglašen ovaj Parlament kao nezavisni.

Isto tako, žao mi je što gospodin Bajram Redëpi nije tu, ali za mesec dana uhapsiti 20-toro Srba u pomoravlju. To je zaista mnogo i za mnogo veći prostor, a ne za prostor Kosova i Metohije od 10.800 kvadratnih kilometara.

Tih 20-toro Srba, od kojih neki su do te mere maltretirani, gde je i omdbucman izdao saopštenje i izjavio da je korištena prekomerna sila iako nisu pružali otpor a lekarskim pregledom je utvrđeno da su do te mere bili pretučeni da pojedini imaju perikardialni ili ja bih kazala problem narodski „izliva oko srca“, u smislu kao posledica korišćenja prekomerne sile u tom predelu. Drugi je imao fisuru na tri rebra. Nigde treće dete, sin uhapšenog, bačen je na stomak i gažen nogama, gde ima povrede i po celoj površini zadnjeg tela.

To su jezive stvari, koje su se dešavale i uvek uz nešto što je korišćenje psovka i govora da se revanširaju za ono što je uradio Slobodan Milošević, koji je mrtav i koji i vlast Srbije, koja već 14 godina ne funkcioniše na ovom prostoru.

Brzo ću završiti! Juče sam čula gospodina Kučija, koji je poslao jednu zabrinjavajuću poruku Albancima. I to mi je bilo, ovako, potpuno teško. Kazao je: izbegavajte da koristite put koji vodi ka severu preko ostatka Srbije.

Prateći situaciju u regionu, shvatila sam strah mnogih mojih prijatelja Albanaca, koji su mi kazali: „Znaš Rado, danas baš se osećamo loše! Eto ne smemo... Zamenik premijera je kazao da je nesiguran put prema Srbiji, prema Makedoniji se jako mnogo komplikuje situacija, ne smemo ni prema Makedoniji“.

Oseća se da nosioci ideje „velike Albanije“ a koji postoje i u ovom Parlamentu, moraju da shvate da su im Srbi koji su u ovom Parlamentu njihovi partneri, da se zajedno borimo za očuvanje teritorijalnog integriteta, jer veliki projekti nose za sobom i izolacije.

Gde će sada albanci sa Kosova? Makedonijam na jedan način destabilizovana! Srbijom plaše! Crna Gora, koliko juče čujem, nezadovoljna je reciprocitetom u smislu protoka robe.

Jednom davno, na jednom zajedničkom putu Edite i mene u Londonu, ona je govorila o nemogućnosti života Albanaca sa Slovenskim narodom. I meni je to uvek bilo nekako, i kažem kako to: ne možemo da živimo?

Zato mislim, svi zajedno nalazimo se u jednom vrlo odgovornom trenutku da budućnost naše dece ne bi bila kao što je prošlost naša, moramo biti dovoljno zreli i podržati pre svega dogovor o regionalnom predstavljanju i zamolila bih premijera Tačija, i zamolila bi Beograd u isto vreme - da ne budu im važne toliko šta će pisati „fusnote“ - da ne napuštaju regionalne sastanke, jer regionalni sastanci su ustvari ono što treba da nas približi i ono što treba da neutrališe eksremizme i polako da rešavamo svakako i problem severa, jer on je očigledan, na jedan miran način kako su to ovde imali snage da iznesu pojedini predstavnici Albanaca koji mi daju nadu da možemo svi zajedno da nećemo odgovore na zaista jedan suživot i na jednu budućnost koja će biti od koristi za sve nas, tako da svi zajedno možemo da se krećemo i ka severu i ka jugu. Da ne bude put Albanaca sa Kosova slobodan samo prema Albaniji, jer i ona ne znam, u kom trenutku će ipak okrenuta svojim problemima i svom multietničkom sastavu severa i juga kazati nemojte da nas destabilizujete, jer i vi sa severa, ili sa Kosova, ili iz Makedonije - vi ste faktor destabilizacije, a mi želimo da živimo u miru.

Toliko za danas. Hvala što ste bili tolerantni da me ne upozoravate na ustav! Mislim da sam imala slobodu govora, i hvala još jedan put!

KRYESUESI: Falemnderit! Fjalën e ka Hamza Balje! Ne, prvo Emilija Redžepi pa ti!

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem se predsedavajući!

Uvažena gospodo - Vladini predstavnici,

Kolege poslanici,

Poštovani građani,

U ime Bošnjačke zajednice, koja živi na teritoriji severno i južno u Mitrovici, osuđujem svaki incident koji se događa sa bilo koje strane a ide na štetu gubitka života, maltretiranja i ekstremističkih napada.

Jedno se društvo temelji na demokratskim principima, a to su sloboda govora i kretanja, sloboda poštovanja vrednosti i normi svih građana bez obzira na nacionalnu i versku pripadnost i jezik u kojem ti ljudi govore.

Pozivam u ime Bošnjačke zajednice, koja živi na teritoriji opštine Mitrovica na mir, na toleranciju, uspostavljanje dijaloga, zajedničkog suživota svih građana, bez upotrebe nasilja i sile, jer samo na taj način mi mladi u kosovskom društvu vidimo našu zajedničku budućnost i perspektivu. Zahvaljujem se!

KRYESUESI: Falemnderit! Ministri Rashiq!

NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsedavajući!

Poštovani premijeru,

Zamenici premijera,

Ministri kolege,

Dame i gospodo - narodni poslanici,

Kao što znamo, mislim da problem Mitrovice i sever Kosova je jedan od tih problema, verovatno koji će morati dugoročno da se rešava.

Na ostalim delovima Kosova, kao što znate ima, jednostavno, ima jedna reakcija gde je proizvela sa druge strane lančane reakcije, odnosno sprovođenja...

(Reagim...)

Regjia a ka mundësi për përkthim!

KRYESUESI: Ju lutem, për përkthim!

NENAD RASHIĆ: Kao što rekoh, jedna možda nepromišljena reakcija u jednom određenom momentu je proizvela jedan lanac tih negativnih reakcija i podizanja tenzija, koje su se na žalost desila. I te tenzije uvek utiču najdirektnije na Srbe, pogotovo koji žive južno od Ibra i bez obzira da li je taj incident se desio na severu, se desio na jugu ili bilo gde drugde na Kosovu, uvek ima negativne posledice po Srbe baš koji žive u unutrašnjosti Kosova, i po srbe koji žive južno od Ibra.

Kao što rekoh, ta negativna reakcija koja je izazvala lančane reakcije posle toga, mislim da više neće tako nešto da se desi, a pogotovo što znajući da verovatno da i te kako god nazvali mi - recipročne mere, ili bilo kakve druge mere, će verovatno da budu završene posle negde u drugoj polovini maja, prema tome to će verovatno da bude u jednom kraćem roku i samim tim će taj naš problem podizanja tenzija po meni, bez potrebe, biti rešen.

Što se severa tiče, svi znamo da je to jedan nasleđen problem. I mi kao Vlada nismo ga do sad dobili u ruke, nego to je ono što postoji od 99. godine. Faktički postoji jedan vakum koji je tu bio stvoren još od tad. Manje više znamo svi zbog čega stvar je ovako, možda zbog neprincipielnog delovanja određenih institucija, bilo da su domaće, bilo da su međunarodne, ali sad se taj problem nastavlja, on nastavlja da postoji onako pošto je posle tog određenog vremenskog perioda, jednostavno i navika ljudi je postala da oni jednostavno nemaju, da kažem tako, neke ambicije ili želje da budu posebno aktivni deo kosovskog društva.

Sve ono što je dosad urađeno tamo, i mi kao Vlada što smo uradili, ja govorim i u svoje ime, kao ministar, je uvek bilo na osnovi fer ponude: šta možemo mi da uradimo da bi njihov život, život građana na severu učinili srećnijim?

Zločin koji se dešava, koji se desio, uz moje iskrene saučešće porodici Haradinaj, mora da ima počinioaca. Svaki zločin i zločinac ima ime i prezime. To ne može da bude jedna cela zajednica, to ne može da bude grupa ljudi, koja se okarakterise kao jedan određeni narod, nego svaki ima svoje ime i prezime.

I mi nikad, pogotovo poslanici, ne bi trebali da koristimo jezik, koristimo reči generalizovanja krivice, odnosno generalizovanja krivice jednog naroda koji živi tamo. Baš, naprotiv mi bi kao što i stara poslovice kaže da je „strpljenje majka mudrosti“ - trebali da budemo baš mudri.

I verovatno, najodgovornije i najadekvatnije mesto, gde bi trebali da budemo mudri svi mi, je baš Parlament.

Ja sam inače nedavno bio i na severu, i apsolutno uz punu odgovornost, mogu da vam kažem da ljudi tamo imaju iste probleme kao što imaju ljudi na jugu. Apsolutno, sa socijalne ekonomske strane, apsolutno isto. Čak šta više, ako moje mišljenje možete da prihvatite kao tačno, ja mislim da je socijalna slika teža i gora na severu nego što je ovde. A naravno da uvek postoji jedna određena grupacija, koja može da manipuliše, da ih nazovem „jadnim ljudima“, jer verovatno kada morate trbuhom za kruhom, odnosno zbog interesa preživljavanja svoje porodice da se bavite raznim poslovima, onda i samo to delo je, da kažem, malo obrazloži zbog toga što se radi o interesu porodice. Ali slika ljudi tamo je, verujte mi, ista ili čak možda i gora nego ovde. I na tom... što sam bio, samo su tražili osnovne stvari koje za život znače: posao, socijala, pomoć i čak sam bio zapanjen koliko je njih bilo zainteresovano za osnovni nivo humanitarne pomoći, za brašno, šećer, zejtin i osnovne stvari.

Naravno da ja, i kao odgovoran u tom slučaju, i kao institucija, mogu da ponovim samo jednu stvar: Da mi, na način koji trebamo da prodremo kod njih treba uvek da bude od baš tih ljudi, kojima stvarno treba nešto, kojima treba ono što mi možemo da pružimo, naravno u dugoročnom periodu. I mi, kao i svi odgovorni ljudi bi trebali u početku da to radimo na način gde nema postavljanja politike ispred svega ostalog nego baš na protiv da idemo od onog osnovnog, prema politici: Bottom up! Znači da ide od osnovnih potreba koje život znače, prema dodatnim elementima koji bi u hijerarhiji mogle da znače nešto. Znači samo na osnovu onih osnovnih stvari koje možemo da pružimo jer to njima i treba i na takav način bi trebali da se predstavljamo.

Nama jednostavno treba za sever dugoročna politika. A da bi ostarili dugoročnu politiku, znate i vi sami, da će nam trebati vremena. I bez obzira što mogu delimično da razumemo određeni broj poslanika, koji misle da to treba raditi energičnije, dinamičnije, opet se vraćam na onu staru izreku koji sam već rekao – strpljenje je majka mudrosti.

Pa ukoliko hoćemo stvarno da predstavljamo jednu demokratsko društvo, a ja sam apsolutno siguran da svako od nas hoće, onda stvarno trebamo da imamo strpljenja, treba da imamo mudrost i treba da imamo dugoročnu politiku koja će stvarno jednog dana da pokaže tim ljudima da su oni dobro došli u demokratsko društvo kao što kosovsko hoće i može da bude. A da bi to dokazali, treba prvo mi sami da budemo strpljivi, mi sami da privučemo te naše građane i da kažemo: OK! Vi ste dobro došli, budite deo nas, ono što je naše, to je i vaše, onaj kolač koji imamo, mi ga delimo sa vama; Jer ako ne stvorimo poverenje, koje se tek tako ne daje, nego mora da se stvara, džabe ćemo mi da kritikujemo koliko hoćete. I svi ako budemo kritikovali, i Vlada, i opozicija, i svi poslanici – opet to nam ne rešava problem.

Mora da budemo fer, otvoreni prema njima, da ponudimo ono što imamo. Da damo kao privilegiju, kao beneficija biti deo kosovskog društva.

I ja sam siguran da 90% ljudi na severu Kosova misle apsolutno isto kao i ja, kao i vi, da trbuhom za kruhom svako od nas radi ono što je u najboljem interesu svoje porodice.

Kaže se da u modernoj politici nema iznenađenja! Znači, u trasiranju puta, ako je naš strateški interes Evropska unija, svi znamo koje su vrednosti Evropske unije – multi-etničnost mora da bude sloboda kretanja, sloboda govora, sloboda izražavanja i svi se slažemo oko toga, siguran sam. Ali, zato, opet kažem, u modernoj politici nema iznenađenja. Ako je taj put iztrasiran ne možemo mi, i mislim bilo bi politički neodgovorno da mi to jednom seancom, jednom sednicom Parlamenta da menjamo, kako mislimo da je ad-hok za situaciju. Ne! Mi, naš put ka Evropskoj uniji, mora da bude jasan i uvek da dokazujemo da smo mi na istom putu.

A ukoliko stalno menjamo naše načine i izražavanja, ukoliko menjamo i taj odnos naš prema nekom određenom delu Kosova, mi samim tim izlazimo iz tog našeg evropskog koloseka. Znači, ozbiljna politika nalaže zrelost. Na vama, pogotovo na svim političkim partijama, ne samo na poziciji. I na opoziciji, čak šta više, po meni je i veća politička odgovornost. Jer, stvarno bi bilo krajnje vreme da u nekim momentima, u nekim pravcima delovanja treba...

(Nderprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe një minutë, ia mundësoni ta kryejë fjalën!

NENAD RAŠIĆ: Stvarno treba da ima jedan konsenzus, jedna zrelost, jer možda mi kao partije koje činimo poziciju možemo da obrazložimo svoja dela na različite načine, jer imamo mehanizme moći ali je najbitnije da i vi razumete da mi te mehanizme usmeravamo u pravom smeru, da mi mehanizme usmeravamo za dugoročnost Kosova, za njegovu dugoročnu politiku koje će kroz određeno vreme da pokaže svoje prave rezultate. Moramo da budemo tolerantniji i da razumemo druge. I da tu toleranciju da bi smo stvorili, moramo pre svega mi prema drugima da se ponašamo tolerantni. Hvala, puno!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Mujota, e ka fjalën!

FEHMI MUJOTA: Faleminderit, i nderuari kryesues!

I nderuar kryeministër,

Zëvendëskryeministra,

Anëtarë të kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Debati i sotëm, i orientuar kryesisht në çështjet e sigurisë në veri, është natyrisht brenga kryesore por është edhe momenti që tregohet se cilët janë hapat që janë marrë për qytetarët në pjesën veriore dhe përgjithësisht në Republikën e Kosovës, por duke mos selektuar në kuptimin nacional, por duke çuar porositë e qartë për secilin. Dhe unë besoj shumë se deputetja Rada Trajković në fund të fjalimit të saj, me mirësjellje iu drejtua Parlamentit dhe kryesuesit të seancës që pati mirëkuptim për përdorimin e termave jo kushtetues, por vërtet kjo është një porosi e keqe që mund të dërgojë një deputet apo deputete nga Parlamenti i Kosovës për qytetarët e Republikës së Kosovës, e posaçërisht për qytetarët të përkatësisë nacionale të cilës i takon ajo vetë.

Dhe, të nderuar deputetë,

Në qoftë se do të bisedohej në këtë mënyrë, atëherë sigurisht se qytetarët që mezi presin të dëgjojnë programet e Qeverisë, qëndrimin e Kuvendit, të institucioneve të vendit përgjithësisht, të

institucioneve të sigurisë, të KFOR-it, të EULEX-it për mirëqenie të qytetarëve të Republikës së Kosovës, do të merrnin porosinë e gabuar.

Prandaj, kujdes për secilin deputet që të mos dërgojë porosi të gabuara në drejtim të gabuar dhe të kemi një qasje e cila sigurisht do të na sjell në një situatë jo fort të favorshme politike.

Në këto vite të fundit, Qeveria e Republikës së Kosovës ka i bërë përpjekjet e veta për të siguruar për qytetarët e vendit, e posaçërisht për qytetarët në veri të Mitrovicës për qarkullim të lirë, përkatësisht për të mundësuar transportin rrugor dhe hekurudhor.

Njëri nga deputetët, më duket zotëri Visari, përmendi se një nga propozimet e Vetëvendosjes është çështja e transportit të qytetarëve në pjesën veriore. Atëherë, unë po ju bëj me dije se, nëse keni lexuar me vëmendje buxhetin e miratuar në Parlamentin e Republikës së Kosovës, mund të shihni se në vitin 2011 janë shpenzuar, hiç më pak se 1.050.000 euro për transport rrugor dhe hekurudhor për qytetarët e Republikës së Kosovës, me theks të veçantë në pjesën veriore. Dhe, po kaq, më tepër se 1.000.000 shpenzohen për këtë vit, të miratuar në këtë Parlament të Republikës së Kosovës.

Gjithashtu, rreth 1.000.000 euro vitin e kaluar dhe në këtë vit, shpenzohen për mirëmbajtje të rrugëve në pjesën veriore të Mitrovicës dhe po aq, mund të ju them, për investimet që i përmendi ministri Hamza, është edhe ndërtimi i rrugës nga Stan-Tërgu – Melenica dhe Vllahia në gjatësi prej 8.8 kilometrave, e cila është në ndërtim e sipër dhe deri tash janë investuar rreth 1.260.000 euro.

Gjithmonë ka nevojë për më tepër dhe kjo është shumë e qartë dhe sigurisht se orientimi në investimet kapitale për ndërtimin e rrugëve është vazhdimësi e programit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, edhe e Ministrisë së Infrastrukturës, por mbi të gjitha, duhet të mbisundojë siguria dhe sundimi i ligjit në pjesën veriore, me përgjegjësi e drejtpërdrejtë, që në këtë rast është e EULEX-it e KFOR-it dhe natyrisht edhe e Policisë së Republikës së Kosovës, do të mundësonin investime edhe më të fuqishme. Dhe, në këtë rast, mund të ju them se Parlamenti i Kosovës në secilin moment e sheh të udhës që të bëjë investime shtesë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministria e Infrastrukturës në planin e ndërtimit të infrastrukturës rrugore në pjesën veriore është e gatshme t'i përgjigjet interesave të qytetarëve të asaj pjese.

Prandaj, edhe një herë po ju them që porositë të cilat dërgohen nga ky vend do të ishin shumë më të mira, shumë më të drejta, shumë racionale dhe shumë stabilizuese të shkojnë në drejtim të zhvillimit, të respektimit të integritetit territorial të Republikës së Kosovës dhe të respektimit të dinjitetit të secilit qytetari të këtij vendi. Faleminderit!

(Drejton mbledhjen, kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi)

KRYETARI: Faleminderit! Kryeministër, a e do fjalën?

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuari kryetar!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

I nderuari shef i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, faleminderit për këtë mundësi për të debatuar, e sa është interesimi për të debatuar, prej atyre që bënë zhurmë të madhe, shihet tash kur

nuk janë të gatshëm për të vazhduar debatin dhe sa kanë qenë të interesuar për dy policët dhe vrasjen kriminale të Selver Haradinajt, prandaj bojkoti ndaj këtij debati, është thjesht një thikë pas shpine pas gjithë asaj zhurme politike që e kanë bërë këto ditë, duke pretenduar për të terrorizuar qytetarët e Republikës së Kosovës, një terrorizim ky politik elektoral.

Prandaj, më lejoni, të nderuar deputetë, që të ju drejtohem edhe me shqetësimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për situatën e tensionuar në veri të vendit.

Unë i kuptoj shumë ndjenjat dhe mocionet e njerëzve. I kuptoj edhe reagimet emocionale të disa deputetëve, por natyrisht, ishte një mundësi e mirë për të ballafaquar argumentet dhe kundër-argumentet, prandaj edhe kjo ikje nga Parlamenti është ikja thjeshtë duke mos pasur argumente për tu ballafaquar, u larguan, uroj që të kthehen.

Dëshiroj të ju drejtohem të gjithë juve, deputetë të nderuar dhe qytetarëve të vendit dhe të ritheksoj se integriteti territorial i Republikës së Kosovës është i pacenueshëm. Kosova është një dhe e pandarë.

Ne do ta ndërtojmë Kosovën demokratike dhe shumetnike, ndërsa problemi i vendosjes së rendit dhe ligjit në veri është një problem kompleks, të cilin ne duhet ta zgjidhim vetë, së bashku duke vendosur një dialog konstruktiv me qytetarët tanë që jetojnë atje.

Natyrisht se i kisha disa pyetje edhe për dy grupe parlamentare të opozitës, që u larguan tash, në mungesë të argumenteve. Natyrisht, ato pyetje do t'i ruaj, por do të jenë ballafaqese para qytetarëve të Kosovës, në veçanti në raport me Serbinë.

Dhuna është e papranueshme dhe e dënueshme për të gjithë. Më lejoni të rikujtoj se Serbia është ajo e cila e ka përdorur forcën dhe dhunën kundër shqiptarëve të Kosovës për një shekull të tërë. Millosheviqi e ka bërë të njëjtën gjë për një dekadë të tërë. Ka vrarë mijëra shqiptarë të pafajshëm. Dhe, se cili ka qenë rezultati i një veprimi apo politike të tillë? Rezultati është Kosova e pavarur dhe sovranë! Millosheviqi ka vdekur dhe i turpëruar, në sy të gjithë botës demokratike, për shkak të akuzës së Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

Pra, ky është suksesi i politikës së Serbisë, i bazuar në përdorim të forcës dhe dhunës. Ndërsa sot, për fat të keq, Serbia ende vazhdon me avazin e vjetër. Serbia, ende nuk është shkëputur nga e kaluara e saj gjenocidale. Serbia ende provokon sovranitetin tonë dhe rendin tonë kushtetues.

Po ne e dimë që kjo politikë, që për momentin po e zhvillon Serbia kundër Kosovës, është politikë dhe qasje e papërgjegjshme, është qasje antidemokratike, antievropiane dhe antipërditë.

Bashkimi Evropian dhe NATO është duke parë nga afër një qasje të tillë të Serbisë ndaj Kosovës. Janë dëshmitarë të kësaj qasjeje sepse janë të pranishëm në Kosovë dhe janë të pranishëm në veri, ku për çdo ditë i përjetojnë veprimet kriminale të orkestruara nga Serbia.

Deputetë të nderuar,

Unë ju siguroj juve edhe si kryeministër, e dua t'i siguroj të gjithë qytetarët e Kosovës se pavarësia dhe sovraniteti ynë është i përhershëm. Prandaj, unë si kryeministër, nuk e kam ndërmend që të adaptoj politikën e njëjtë të përgjegjshme që përdorë Serbia kundër Kosovës dhe nuk mund ta autorizoj përdorimin e forcës dhe dhunës për të nënshtruar një pjesë të caktuar të qytetarëve të Kosovës, të komunitetit serb, që jetojnë në veri të Kosovës për shkak se ata për momentin, për shkak të arsyeve të njohura, nuk i njohin dhe respektojnë institucionet legjitime të Kosovës.

Unë mendoj se qytetarët e Kosovës, dhe të gjithë Ballkanit, kanë përjetuar mjaft dhunë, krime dhe trauma. Mjaft dhembje e plagë janë shkakuar. Ne, si liderë të përgjegjshëm e kemi për detyrë ta mbyllim këtë kapitull të hidhur të dhunës dhe luftërave, e jo ta përsërisim të njëjtin kapitull.

Unë jam i përcaktuar që në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin ndërkombëtar: Bashkimin Evropian, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, EULEX-in e NATO-n dhe të krijojmë një situatë normale edhe në veri të vendit, të krijojmë besimin dhe mirëkuptimin tek qytetarët e Kosovës atje ku qytetarët ende janë të manipuluar nga Serbia, të zhvillojmë një dialog konstruktiv të brendshëm me përfaqësuesit e qytetarëve që jetojnë atje me e qëllim që ata të kuptojnë se vendosja e rendit demokratik atje, vendosja e sundimit të ligjit, nuk nënkupton pushtimin e tyre nga shumica shqiptare, nuk nënkupton asimilimin e gjuhës dhe kulturës së tyre. Mirëpo, nënkupton integrimin e tyre në shoqërinë tonë, nënkupton një jetë më të mirë, shkollim më cilësor dhe investime socio-ekonomike.

Kjo është politika dhe qasja që unë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës po përdorim në raport me zhvillimet në veri të vendit. Ndoshta nuk tingëllon shumë "patriotike" në thonjëza apo kuptimin elektorale opozitar, sikur thirrjet opozitare, të disa prej tyre, për përdorimin e forcës, e ndoshta nuk është edhe shumë populiste edhe kjo që po them, por është pozicioni më i përgjegjshëm. Por unë jam i bindur se është çështje e përgjegjshme, rationale e cila i garanton Kosovës ruajtjen e tërësisë territoriale të saj dhe integrimin në Bashkimin Evropian e në NATO.

Unë jam i bindur se Kosova e pavarur dhe sovranë, e anëtarësuar në Bashkim Evropian dhe në NATO është pikërisht vizioni i qytetarëve të Kosovës, të cilën unë do ta ndjek dhe realizoj bashkërisht me ju pa asnjë hezitim.

Të nderuar deputetë,

Unë do të dëshiroja që edhe ata që thirmin për përdorimin e forcës, disa të opozitës, të jenë tash brenda këtu e të ballafaqohen me argumente, por pasi që janë përcaktuar për të qëndruar në korridore, është zgjidhje e tyre. Gjithashtu, edhe për zhurmën që e kanë bërë rreth zhvillimeve të reja dhe terrorit psikologjik që e kanë bërë tek qytetarët me deklaratat e tyre nxitëse ndëretnike, të ishin brenda dhe të ballafaqohemi me argumentet.

Dëshiroj të theksoj dhe tu drejtohem të gjithë qytetarëve se kidnapimi i dy policëve të Kosovës në territorin e Kosovës ka qenë veprim i dënueshëm nga të gjithë prej institucioneve të Kosovës, të qytetarëve të Kosovës dhe gjithë botës demokratike. Por, në të njëjtën kohë, dua të sqaroj se ky veprim cenues i Serbisë në raport me Kosovën është vazhdimësi e një politike të mentalitetit të Slllobodan Millosheviqit, por dua të sqaroj para të gjithë qytetarëve të vendit se ky veprim në territorin e Kosovës ka qenë dashur dhe ka qenë rekomandim i qartë për të respektuar Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës në plotni. Dhe çka nënkupton respektimi i Kushtetutës dhe ligjeve? Ai që

cenon vetëm një centimetër të territorit të Republikës së Kosovës ta marrë përgjigjen e merituar! Xhandarmëria serbe ka pasur uniformë, policët tanë kanë pasur uniformë. Xhandarmëria serbe ka qenë e armatosur, tanët kanë qenë edhe më të armatosur dhe armatim edhe më bashkëkohor. Kjo është përgjegjësia e institucioneve të Kosovës. Prandaj edhe xhandarmëria serbe e ka merituar përgjigjen kushtetuese dhe ligjore dhe kjo është thirrja ime për të gjithë policët që janë në zonat kufitare me Serbinë, që të mos jenë të befasuar, sepse policia e Serbisë udhëhiqet prej njeriut më të afërmit e Slllobodan Millosheviqit. Prandaj, cenimi i tërësisë territoriale të vendit tonë duhet ta merr përgjigjen kushtetuese dhe ligjore.

Sa i përket vrasjes kriminale të Selver Haradinajt, duke shprehur ngushëllimet më të thella familjes Haradinaj dhe gjithë qytetarëve të Kosovës ndaj kësaj vrasje kriminale, dua të theksoj se ka qenë një vrasje që i ka prekur të gjithë, e dënueshme nga të gjithë, por në të njëjtën kohë Qeveria e Kosovës ka qenë afër familjes dhe do t'i kryejë të gjitha obligimet që dalin kushtetuese dhe ligjore.

Ne jemi duke bashkëpunuar ngushtë me autoritetet e EULEX-it e KFOR-it që e vërteta e këtij akti kriminal të zbardhet, por nuk mund të pajtohem me disa zëra opozitarë që drejtuan gishtin kundër një komuniteti të caktuar në Kosovë se ka gisht në vrasje. Kjo nxitje e dhunës ndëretnike, nxitje e tensioneve ndërqytetore dhe pretendim për të përsëritur atë që nuk do të duhej përsëritur në Kosovë – viti 2004. Është një pretendim i pa përgjegjshëm, sepse nuk mund të flet politika kur është duke edhe në procesin e hetimit, është duke punuar drejtësia, nuk mund të jetë politika për akte të tilla para drejtësisë, por kjo zhurmë elektorale në dëm të familjes Haradinaj, është një papërgjegjësi e plotë edhe qytetare edhe politike, mund të them edhe me pasoja të cilat realisht, më në fund, i menaxhuam por do të duhej që kjo çështje të tejkalonte interesat elektorale dhe të punojmë bashkërisht për tejkalimin e gjendjes dhe assesi të mos pretendohet që mbi viktimat e pafajshme të akteve kriminale të pretendo dikush të fitojë ndonjë votë. Kjo është e papranueshme edhe për vullnetin e qytetarëve të Kosovës edhe për vizionin euro-atlantik të institucioneve të Kosovës.

Në njërën anë këta njerëz, të politikës opozitare, disa prej tyre, akuzojnë një komunitet të caktuar të Kosovës. Ulu, ulu Ahmet! Ballafaqohemi me argumente! Tash mos ikni, mos u largoni dhe mos u ligni.

(Ndërhyrje)

Në njërën anë këta zëra, të shkëputur nga realiteti i Kosovës, akuzojnë një komunitet të caktuar në Kosovë për aktin kriminal në familjen Haradinaj, ndërsa në të njëjtën kohë ndodh skenari i njëjtë i sulmit apo fushatës dhe propagandës ndaj shqiptarëve në Maqedoni për shkak të vrasjes së 5 qytetarëve maqedonë. Do të thotë, në një formë a formën tjetër, është një skenari i njëjtë por me akuza në adresa të ndryshme, por që kanë ra në grackë të njëjtë.

Për Qeverinë e Kosovës dhe institucionet e Kosovës, ka qenë e dënueshme, është e dënueshme dhe natyrisht se pagja dhe stabiliteti edhe në Kosovë, edhe në Maqedoni janë jetike për gjithë paqen në rajon. Por, në asnjë rrethanë, për asnjë incident apo vrasje kriminale nuk duhet t'i japim konotacion politik apo etnik. Kjo është e rrezikshme për vendin tonë, për të ardhmen tonë, për paqen, stabilitetin dhe bashkëpunimin regional.

U fol këtu edhe për vizitën në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por do t'i ftoja që së paku për SHBA-të mos të flasin ata që s'mund të hyjnë në SHBA – në Shtete të Bashkuara të Amerikës, deputetët e rendit të parë që ishin këtu, të dytë, të tretë. Prandaj, nuk mund të flasin për diçka të tillë, kur edhe s'mund të udhëtojnë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe ata e dinë pse nuk mund të udhëtojnë. Ndërsa, në anën tjetër, donë ta mësojnë, jo Qeverinë dhe neve të gjithëve, por duan t'u japin rekomandime edhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, edhe NATO-s e Bashkimit Evropian se si me u sjellë në Kosovë.

Sa i përket zgjedhjeve të pretenduara të Serbisë, e them edhe një herë dhe do të dëshiroja të ishin këtu kjo pjesa e opozitës që është duke keqinformuar opinionin publik dhe të ballafaqohemi me argumente me ta. Unë këtu e kam planin e dokumentit Ahtisari jo për tu mburrur sepse është kompromisi që e ka bërë ky Parlament por të gjithë në Parlamentin e Kosovës që janë, në një formë, a formën tjetër, së paku de jure e kanë pranuar dokumentin e presidentit Ahtisari. Të gjithë, pa dallim – pozitë dhe opozitë! Dhe, prej këtij dokumenti del edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Pretendimin e Serbisë për të organizuar zgjedhje në Kosovë e kemi koordinuar ngushtë me komunitetin ndërkombëtar që ky pretendim të dështojë. Ky pretendim i agresionit të Serbisë, jam i bindur se do të dështojë, dhe nuk do të lejojmë as organizimin e zgjedhjeve nga Serbia, as lokale, as parlamentare, as presidenciale. Por në të njëjtën kohë, e drejta e dyshtetësisë, është e garantuar me dokumente ndërkombëtare për Kosovën dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës për të marrë pjesë në votim, por jo të organizuara nga Serbia në territorin e Republikës së Kosovës.

Dhe ky vendim, për të mos u organizuar zgjedhje të Serbisë në Kosovë është vendimi i parë pas 13 vitesh, por do të lejohet mundësia e votimit elektronik apo me postë përmes OSBE-s – e qytetarëve që dëshirojnë të votojnë.

Ndërsa, sa i përket dyshtetësisë, ju e dini, ka këtu edhe deputetë, disa janë këtu e disa nuk janë këtu, që kanë votuar dhe janë pa edhe në televizione duke votuar në Tiranë duke marrë pjesë në votimet, sepse janë edhe shtetas të Shqipërisë, janë edhe shtetas të Kosovës. Prandaj, nëse ndonjë deputet ka marrë pjesë në ndonjë votim diku atëherë një gjë e tillë nuk mund t'i mohohet një qytetari të ndonjë komuniteti tjetër. Natyrisht se dikush mund të thotë që – mirë, këta kanë shkuar e kanë votuar në Tiranë dhe ai qytetar që dëshiron të shkojë mund të shkojë të votojë në Serbi, por nuk e kemi ambasadën e Beogradit ende në Kosovë, besoj se pas njohjeve reciproke, se do të ndodhin, do ta kemi edhe ne ambasadën tonë në Beograd dhe ambasadën e Serbisë në Kosovë.

Gjithashtu, këtu më tepër nga opozita është shfrytëzuar për ta akuzuar Qeverinë, jo për të folur për tejkalimin e gjendjes në veri për të gjetur një zgjidhje integruese, por u drejtua vetëm akuza në drejtim të Qeverisë. Unë ju them se ballafaqimin Qeveria dhe koalicioni qeverisës do ta ketë me këta opozitarë në vitin 2014, dhe atë në fund të vitit 2014, kështu që herët e kanë filluar fushatën.

U diskutua këtu edhe për një plan politik me Serbinë! Unë nuk e di, ndoshta Ismeti e di që partia e tij u pajtua për dialog politik për veriun, megjithëse nuk besoj fort që i kanë treguar të gjitha. E gjithashtu edhe partia pas Vetëvendosjes që ishte, edhe ata e dinë dhe do të dëshiroja që të ishin këtu, ta kenë ballafaqimin me mua dhe t'i shikoj e të më shikojnë në sy, nuk besoj se do të kishin mundësi me u shikuar në fytyrë, sepse ata e dinë që unë e di edhe për Ismetin edhe për partinë e

Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, e di edhe se si janë pajtuar. Edhe ata e dinë kundërshtimin dhe refuzimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Ndërsa, për Vetëvendosje, gjithashtu e kam pyetjen: le të tregojnë takimet që i ka zëvendëskryetari i Albin Kurtit me ministrat e Boris Tadiqit. Takimet, që Ardiani i di shumë mirë. Po, nuk është këtu. Faleminderit shumë! Takime, të fshehta!

KRYETARI: Regjia, regjia, ju lutem!

HASHIM THAÇI: Sa për korrektësi, para opinionit publik! Takime, të fshehura, por gjysmë të hapura. Se, edhe disa deputetë të mazhorancës, e dinë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Të lajmëruar për debat i kemi edhe 8 deputetë. Unë fjalën ia kisha dhënë deputetit Agim Kuleta.

AGIM KULETA: Faleminderit, zoti kryetar!

Më në fund më erdh rendi me e marrë fjalën, por nuk e di nëse ka mbetur edhe ndonjë ministër, ndoshta zoti Buja s'e ka marrë fjalën sot, nëse është i interesuar!

Atëherë, në momentin kur u vendos për këtë seancë të jashtëzakonshme, mua në fakt mu lindën dy dilema, e para të vi a mos të vi fare në këtë seancë dhe e dyta të diskutoj apo jo. Dhe, të dyja këto dilema e kishin të njëjtin shkak, sepse kjo seancë e jashtëzakonshme si edhe shumë të tjera të ngjashme, për mua dhe subjektin të cilin e përfaqësoj, pra Lëvizjen për Bashkim, janë joserioze e për më tepër i konsiderojmë dhe si farsë. Dhe i konsiderojmë të tilla për dy arsye: e para, është motivi mbi të cilin bazohen këto kërkesa për seanca të jashtëzakonshme lidhur me çështjen e veriut.

Motivi kryesisht po buron jo nga vullneti, jo nga vullneti dhe dëshira e mirë për të ofruar një zgjidhje për problemin e veriut, por po buron nga pasioni gjithnjë më i zjarrtë i luftës midis subjekteve politike në betejën politike për pushtet. Dhe e dyta, është politika sipërfaqësore e cila po ndiqet ndaj gjendjes në veri.

Ne si Kuvend po nxitemi të mbajmë seanca të jashtëzakonshme kur po ndodh ndonjë incident në veri, dhe në këtë mënyrë po krijohet përshtypja sikur këto incidente po shkaktojnë gjendje të jashtëzakonshme. Në fakt, realiteti është krejtësisht tjetër dhe është gjendja e jashtëzakonshme e cila ekziston që pas përfundimit të luftës, ajo e cila po i shkakton këto incidente të vazhdueshme. Prandaj, ne vazhdimisht po merremi me pasojat dhe jo me shkaktarin e problemit.

Gjithashtu, është iluzion të pritet që me veprime spektakulare siç janë seancat e jashtëzakonshme, e po ashtu edhe me veprimet e tipit të 25 korrikut të zgjidhen problemet, që kanë të bëjnë me veriun.

Seancat e jashtëzakonshme, kemi qenë dëshmitarë, po prodhojnë vetëm rezoluta boshe, të pazbatueshme dhe nuk po krijojnë zgjidhje të cilat priten prej tyre.

Gjithashtu, edhe intervenimi i tipit të 25 korrikut nuk është veprim që do të prodhojë rezultate dhe zgjidhje, por do të vazhdojë të prodhojë heronj, ndërkohë që Kosova nuk ka nevojë për heronj të tjerë por ka nevojë për zgjidhje të problemeve.

Atëherë, si të nisemi drejt kësaj zgjidhje, për të cilën ka nevojë Kosova? Fatkeqësisht atë që duhet bërë në këtë situatë, tingëllon prapë, të jetë e jashtëzakonshme sepse është fjala për një instalim të dialogut midis subjekteve politike, të cilat do të hartonin një platformë për zgjidhjen e problemit shqiptar-serb. Dhe, pas hartimit të kësaj platforme, ajo të sillet në Kuvend dhe në një seancë të rregullt të miratohej si e tillë dhe të autorizohet kryeministri për zbatimin e saj.

Në këtë drejtim, ne si Lëvizje për Bashkim, në ditët e ardhshme në kutitë e të gjithë deputetëve do t'ua dërgojmë një platformë të cilën e kemi hartuar për zgjidhjen e problemit shqiptar-serb dhe kërkojmë nga të gjithë deputetët që të ta trajtojnë atë me seriozitetin e duhur dhe ta pranojnë si një përpjekje dhe vullnet të mirë të Lëvizjes për Bashkim për ta hartuar një platformë të përbashkët mbi të cilën do të vepronte Kosova. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Nëse jeni dakord, propozuesi e ka të drejtën për 5 minuta, nëse ka diçka, apo po e përfundojmë debatin, apo të vazhdojmë.

(Ndërhyrje)

Atëherë, e ka fjalën deputeti Hydajet Hyseni!

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje deputetëve, madje edhe atyre me të cilët nuk mund të pajtohem me atë që e thanë!

Përshëndetje kryeministrit dhe ekipit të tij qeveritar!

Do të dëshiroja që të ishin këtu edhe opozita dhe së paku të ishim bashkë edhe në mbylljen e këtij debati, të cilin edhe e kemi iniciuar praktikisht bashkërisht.

Unë e kam nënshkruar edhe njëërën nismë, edhe tjetrën, i bindur që së paku një situatë e tillë, një brengë e tillë na bashkon.

Jam i zhgënjyer që e shoh se deri edhe kjo nuk arrin t'i reduktojë pak motivet partikulariste dhe ndjehem keq. Nuk mund të luftohet për pushtet me raste si ajo që ka ndodhur në veri dhe po ndodhë gjithandej dhe rrezikon të thellohet edhe më shumë. Nuk mund madje as të përfitojë ndonjë komunitet me politizim të theksuar të situatave që dëmtojnë secilin.

Ç'është e vërteta, debati rrëshqiti prej asaj që ishte edhe motivi i nismës dhe nuk është mirë që çështje serioze si gjendja në veri të diskutohen ose nga rasti në rast ose të merret rasti si pretekst dhe pastaj të futet në atë thes gjithçka.

Sulmi mbi familjen Haradinaj duhet dënuar dhe unë befasohem kur dëgjoj ndonjë diskutues, dhe nuk më pëlqen të vlerësoj diskutimet, por që iu bën thirrje nënave që të veprojnë si nëna, kurse vetë nuk merr guximin së paku të distancohet nga një sulm ndaj një familjeje të tërë. Dhe mendoj se ajo që do ta bënte veçanërisht të rëndë, është pikërisht kjo: sulm ndaj një familjeje të tërë, edhe ndaj fëmijëve.

Unë do ta dënoja këtë akt, pavarësisht ku ndodhë, edhe sikur të ndodhte në cepin më të skajshëm të botës, edhe sikur të ndodhë në familjen e armiqve të Kosovës do të duhej dënuar. Prandaj, mendoj që dënimi nuk duhet të ndajë atë që ka ndodhur në familjen Haradinaj me aktin që i ka ndodhur qytetarit serb që u sulmua vetëm se i kishte bërë një vizitë familjes shqiptare, me aktin që ndodhi në Karadak të Shkupit e që të gjitha ato do të duhej të mos kishin ndonjë lidhje dhe unë uroj që të mos kenë ndonjë lidhje, por kur dëgjoja këtu ndonjë politizim me njëfarë malicioziteti për izolimin e Kosovës, duhet të jem i lirë ta them: mu ngjall dyshimi mos ka edhe ndonjë lidhje midis gjitha këtyre.

Ata që e dëshirojnë izolimin e Kosovës, përvoja ka dëshmuar që janë në gjendje edhe të prodhojnë situata të tilla. Dhe, natyrisht të digjen edhe vet në to. Kush i bën varrin fqinjit, si thonë, bie vet në të.

Kosovës i duhet një qasje tjetër. Dhe unë kam qenë i bindur që ky Kuvend mund ta kishte një debat të shkurtër, ndoshta vetëm me disa diskutime të shfave të grupeve parlamentare, që të dënonin dhunën, të dënonin terrorizmin në tërësi, të thonin ndonjë rekomandim të përbashkët si kontribut në parandalimin e fenomeneve të tilla dhe jam i sigurt, gjithçka do të ishte ndryshe.

Po u kthjem në një, praktikisht, fushatë kundër Qeverisë dhe unë, edhe pse i përkas koalicionit qeverisës, megjithatë jam i prirë ta kuptoj opozitën kur edhe priret nga motive të tilla. Për ta vënë këtë në plan të parë, mendoj që nuk i ndihmon as atyre.

Megjithatë, a ka vend për t'i bërë vërejtje Qeverisë? Mendoj, po! Nuk i duhet Kosovës në këtë situatë një qasje çfarë e kemi, me fjalë kallaballëk, me fjalë të mëdha babush e pastaj veprimet kurrkund, me ministra që dalin dhe bëjnë analiza gazetareske, me prirje që shkojnë prej një skaji në skajin tjetër me deklarata dhe asnjëherë as tjetrës nuk i dalin pastaj zot. Sidomos kur kanë përvojë mjekësore, duhet ta dinë që nëse antibiotiku nuk është në masën e duhur, ka efekte kundërprodhuese. Plaga që shpupurishet e nuk do, e ka melhemin duhur - vetëm acarohet. Sidomos kur është edhe diagnoza e nxituar dhe e gabuar, mund të kthehet edhe në problem serioz për shëndetin. Mendoj se gabime të tilla nuk duheshin bërë.

Ne nuk i kemi vënë gishtin në plagë në problemin e veriut. Këtu u tha se është problem politik. Kishte edhe reagime. Unë mendoj që ndoshta s'është ky rasti, por nëse do të duhej hapur debati për problemin e veriut, do të duhej vënë, si të thuash in media res - ç'është problemi i veriut? Dhe të shtrohet ashtu siç është: është problem politik, i politizuar, i instrumentalizuar. I instrumentalizuar një pjesë e një komuniteti edhe ashtu të instrumentalizuar, dhe është për të ardhur keq, në dëm të tij, siç ka qenë në të kaluarën por edhe përgjigja jonë mendoj se ka qenë ngapak e strucit që e fut kokën nën zallë duke menduar që kalon rreziku, që e nënçmon sëmundjen edhe ajo vjen e trashet dhe ka munguar qasja adekuate.

Nuk është për ta anashkaluar edhe qëndrimin e partnerëve ndërkombëtarë, të cilëve ne, gjithmonë iu jemi mirënjohës dhe e shprehim këtë mirënjohje, por gjithë në bisedat interne që kemi jemi të pakënaqur me qasjen e tyre në veri.

Nuk është në rregull edhe referenca Ahtisari, siç u tha, e vetmja ofertë, si e vetmja alternativë, si zgjidhja më e mirë, e tjera. Dhe, përsëri, nuk është e singertë! Vetë Ahtisari e ka thënë se është një

kompromis i dhimbshëm për popullatën shumicë dhe mendoj që nuk mund t'i bëhet vërejtje kësaj qasje. Ka alternativa më të mira dhe oferta më të mira për komunitetin shumicë. Dhe, nëse flasim hapur, inkurajimi i një qasje të skajshme, e krijon edhe hapësirën edhe për qasje të tjera edhe të tjerat. Nuk mund të ketë standarde të ndryshme në zgjidhjen e problemeve që janë ekuivalente, janë të njëjtshme. Është problem politik veriu, po është problem politik edhe Presheva, është problem politik edhe gjithë Lugina e Preshevës dhe njëra nuk mund të zgjidhet ndryshe, nga që zgjidhet tjetra. Dhe mendoj se Kosova nuk ka asnjë arsye që t'i druaj qoftë debatit, qoftë dialogut parimor. Le të zgjidhet parimi dhe jam i sigurt që do të ketë pastaj edhe për të pas paq në të mirën e të gjithëve.

Dokumenti i Ahtisarit është kompromis i dhembshëm! Çdo përpjekje për të shkuar përtej tij, e prish kuptimin e tij. Futja e kriterit etnik në një pjesë të Kosovës, jo vetëm që imponon të njëjtin kriter edhe në pjesë tjera të ngjashme me veriun e Kosovës, por i humbë kuptimin edhe zgjidhjes kompromise të vetë Kosovës për të cilën ne jemi përcaktuar dhe qëndrojmë në këtë kompromis, në këtë qëndrim.

Praktikisht është modus vivendi më i përshtatshëm për momentin, por nuk është zgjidhja më e mirë. Nuk mund të ketë zgjidhje etnike në një pjesë dhe zgjidhje kozmopolite në pjesën tjetër. Dhe mendoj se këtë duhet ta kenë edhe partnerët tanë. Nuk mund të inkurajojnë edhe pavarësinë e Kosovës dhe integrimin në Evropë dhe të inkurajojnë po ashtu një pjesë të Kosovës që të ndahet nga Kosova dhe të integrohet me një shtet që praktikisht instrumentalizon po nuk qanë kokën për ta. Nuk mund të shkelet edhe gasi i makinës - marshit, edhe të shkelet freni!

Kështu ndodhë, ajo e 2004-it! As atë 2004-shin ne nuk e kemi analizuar siç duhet dhe e interpretojmë dhe përdorim ndonjëherë jo në mënyrë adekuate. Ka qenë pikërisht kjo qëndrim ambiguent edhe i partnerëve ndërkombëtarë, që ka krijuar atmosferën e bllokimit që do të shpërthente keq. Nëse nuk shtrohet në mënyrë institucionale, në mënyrë sistemore siç duhet zgjidhja e një problemi, ajo merr edhe rrugë të tjera dhe ne e kemi parë disa herë në përvojën tonë.

Prandaj, pikërisht, që të mos ndodhin situata të tilla, që të mos flasë rruga, që të mos flasin manipulantët e dallaveraxhinjtë, e tjera, do të duhej institucionet të ngritën në nivelin e duhur. Partnerët tanë do të duhej ta kuptonin seriozisht edhe seriozitetin e problemit dhe të siguronin zgjidhje adekuate në të mirën e të gjithë qytetarëve në Kosovë, në të mirën e të gjitha komuniteteve në Kosovë, në të mirën e gjithë vendeve të rajonit tonë, për të cilat ne do të dëshirojmë të jetojnë në paqe, dhe ne të jetojmë me ta në paqe. Por nuk ka mundësi që Kosova përsëri të bëhet objekt i bakshisheve, allishverisheve, në dëm të së ardhmes së vet. ...

(Ndërprerje nga regjia)

(Diskutime, të dorëzuara me shkrim)

RAMIZ LLADROVCI:

I nderuari kryetar,

I nderuar kryeministër, kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Paraprakisht më lejoni ta përshëndes iniciativën, moti të nevojshme, për seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për të diskutuar çështjen e veriut të vendit.

Kjo seancë flet për përgjegjësinë që ndiejmë secili prej nesh, si të zgjedhur të qytetarëve të Kosovës. Përveç ngjyrymeve politike që përfaqësojmë, ne, në radhë të parë përfaqësojmë interesin vital të vendit tonë, e sidomos atë të atyre në veri të vendit.

Iniciativa e PDK-së është shumë e qëlluar, ashtu siç ishte i qëlluar, konsideroj unë edhe propozimi i liderit të Vetëvendosjes, kolegut tonë Albin Kurti, që për çështjen e veriut duhet unitet mbarë kombëtar.

Por, është për keqardhje fakti që, duke u thirrur në këtë unitet, ditë më parë Grupi i Vetëvendosjes e përdori këtë kauzë të rëndësishme dhe jetike, për përfitime politike.

Spektakli i pak ditëve më parë, me parullën e madhe të ekspozuar në Kuvendin e Kosovës, në këtë sallë, me emrat e dy të rënëve në veri, policit Enver Zymberi dhe qytetarit Selver Haradinaj, ishte abuzim direkt me ndjenjën e familjarëve të tyre, të qytetarëve tanë ne veri dhe të të gjithë neve.

As Enver Zymberi e as Selver Haradinaj nuk ranë për t'u bërë argument abuzimi politik nga cilido subjekt politik. Ata ranë në krye të detyrës për një kauzë, për një çështje të pazgjidhur tash e 13 vjet – veriun e Kosovës.

Andaj, ju lutem, t'i ndalim spektaklet me gjakun e të rënëve, me sakrificën e qytetarëve tanë. Ne, si deputetë, nuk jemi të thirrur këtu për parulla, por për të propozuar veprime konkrete në zgjidhjen e çështjes së veriut dhe të problemeve të qytetarëve tanë.

Të nderuar kolegë,

Temës rreth veriut të vendit duhet t'i qasemi me shkallën më të lartë të seriozitetit. Këtu nuk duhet të bëjmë vetëm llafe e debate, por të vijmë te përfundime të sakta dhe konkrete, e pas seancës t'i hyjmë praktikisht punës për zgjidhjen e çështjes në veri përfundimisht, si institucione të Kosovës, konform Kushtetutës dhe ligjeve që na obligojnë dhe bashkë me ndihmën e miqve tanë ndërkombëtarë.

Në këtë aspekt, dua ta përshëndes aksionin e KFOR-it amerikan, të ndërmarrë ditë më parë, për të liruar rrugën në drejtim të tri fshatrave shqiptare të Leposaviqit: Bistricës, Cerajës dhe Koshtovës së Vllahisë.

Shpresoj që ky Kuvend pas këtij debati do të dalë me rekomandime konkrete rreth hapave që institucionet tona relevante duhet të ndërmarrin vis-a-vis tensioneve dhe situatës më të re atje. Këto hapa duhet të jenë të bashkëkoordinuara me KFOR-in dhe EULEX-in dhe brenda mandatit të së cilës palë. Mandatet që kanë institucionet tona dhe ato ndërkombëtare duhet të aktivizohen në funksion të krijimit të një ambienti të sigurt për të gjithë qytetarët dhe në funksion të zbatimit me përpikëri të Planit të Ahtisarit atje.

Në të njëjtën kohë, kërkoj nga ne, nga institucionet e Kosovës, që të bëjmë më shumë në aspektin social, për këto tri fshatra shqiptare në veri të Kosovës. Siç e dini problemet politike atje kanë pas efekt direkt në rritje të papunësisë dhe varfërisë. Qytetarët e kësaj pjese të Kosovës kanë nevojë për ndihma dhe subvencione nga ana e shtetit duke filluar nga ato më themelore.

Në këtë mënyrë dëshmojmë konkretisht se jemi me ta, se po bëjmë diçka për ta.

Të nderuar kolegë,

Derisa krimi dhe kriminelët serbë po na sfidojnë përditë në veri të vendit, ne nuk guxojmë të rrimë duarkryq, asnjë minutë më tej.

Kriminelët serbë, si vegla të qeverisë së Beogradit në veri të Kosovës, po e jetësojnë edhe më tej politikën terrorizuese dhe gjenocidiale serbe në atë pjesë të Kosovës.

Përmes tyre, qeveria serbe po e vazhdon politikën e Millosheviqit, për spastrimin etnik, së paku në veriun e Kosovës.

O sot, o kurrë, duhet të jemi me qytetarët e veriut, drejtpërdrejtë, përmes mekanizmave tanë institucionalë. Këtë na e garanton Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe na e obligon mandati ynë, vota e qytetarit.

Andaj, ju ftoj të gjithëve ta kryejmë këtë përgjegjësi para nesh sot, sa nuk është bërë shumë vonë. Ju faleminderit!

(Ramiz Lladrovci, d.v.)

VALBONA DIBRA: I nderuari kryetar i Parlamentit!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Dua të theksoj faktin se problemi i veriut të Mitrovicës nuk është problem vetëm i kësaj Qeverie. Veriu i Mitrovicës ka qenë problem i të gjitha qeverive të deritanishme, është problem i të gjitha partive politike dhe është në rendë të parë problem i të gjithë neve dhe i të gjithë popullit të Kosovës.

Unë si deputete e këtij Parlamenti, si përfaqësuese e elektoratit që më votoj, i dënoj ashpër të gjitha aktet barbare që ndodhën ditëve të fundit në Mitrovicë. Vrasja e Selver Haradinajt është akt barbar që na preku të gjithëve, e përjetuam rëndë dhe me këtë rast i shpreh ngushëllimet më të përzemërta familjes së të ndjerit. Po ashtu, burgosjet arbitrare të shqiptarëve nga ana e Serbisë me akuza të imagjinuara dhe të pabaza, si dhe ekzistimi i strukturave paralele në veri të vendit dhe aktivitetet e tyre kriminale, janë të papranueshme për të gjithë ne.

Paketa e Ahtisarit është kompromisi i fundit që i është bërë Serbisë dhe si e tillë është zgjedhja e vetme e mundshme për veriun e vendit. Presioni ndërkombëtar në bashkëveprim të ngushtë me

Qeverinë e Kosovës ndaj Serbisë është rruga e vetme që serbët e veriut të Mitrovicës ta kuptojnë sa më shpejt se vetëm jeta në paqe dhe në përputhje të plotë me ligjet e shtetit të Kosovës ju ofron atyre perspektivën më të mirë.

Në kuadër të këtyre përpjekjeve është edhe lajmi shumë i mirë që bë veri të vendit nuk do të ketë zgjedhje lokale.

Ndërsa, zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale janë çështje të Serbisë, ajo mund ta zgjedh kë të dojë për udhëheqës të vetin dhe mund të shkojë kah të dojë: në drejtim të EU-së apo në ndonjë drejtim tjetër, por pa veriun e Mitrovicës. Ju faleminderit!

(Valbona Dibra,d.v.)

AFRIM HOTI: I nderuari kryetar!

Të nderuar deputetë,

Neni 1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës thekson se “Republika e Kosovës është shtet i pavarur, sovran, demokratik, unik dhe i pandashëm”. Ky nën përkufizon shtetin i cili në përbërjen e vetë ka një pushtet sovran të pavarur dhe të mëvetësishëm nga çdo pushtet i çfarëdo shteti tjetër. Rrjedhimisht kjo dispozitë kushtetuese e obligon Qeverinë që me të gjitha mjetet e përcaktuara me Kushtetutë të shtrijë pushtetin në tërë territorin e Republikës së Kosovës, e në veçanti në pjesën veriore të Mitrovicës.

Mungesa e shtrirjes së sovranitetit në atë pjesë të Republikës së Kosovës ka për pasojë ushtrimin e pushtetit të shtetit tjetër fqinjë siç është Serbia nëpërmes strukturave ilegale serbe, të cilat duke kërcënuar, shantazhuar, evakuuar dhe duke vrarë shqiptarët në shtëpitë e veta dëshirojnë të ndjellin frikë me qëllim të pastrimit etnik dhe ndarjes së asaj pjese të territorit të Kosovës.

Një meritë e tillë rreth të gjitha këtyre ngjarjeve i shkon edhe Qeverisë së Republikës së Kosovës duke mos i përdorur mekanizmat e sigurisë të përcaktuar me Kushtetutë që sigurojnë shtrirjen e sovranitetit edhe në atë pjesë të Kosovës. Ndryshe, kjo Qeveri këto mekanizma i përdor shpeshherë kundër kundërshtarëve politik me qëllim të mbajtjes arbitrare të pushtetit. Prandaj, ndarja e veriut apo statusi i veçantë për këtë pjesë është i pashmangshëm nëse merret për bazë bashkëpunimi dhe koordinimi jo i vullnetshëm i një trekëndëshi që përbëhet nga tre faktorë: Qeveria, Bashkësia Ndërkombëtare (BEE) dhe Republika e Serbisë. Faktori ndërkombëtar kërcënon dhe shantazhin, Qeveria negocion dhe bën koncesione, sepse është e korruptuar, e kërcënuar dhe e shantazhuar, kurse Serbia përforcohet brenda Kosovës dhe për më tepër okupon territor që në fund të fundit do të legalizohet me një marrëveshje që do të ketë efekt juridik ndërkombëtar.

Andaj, për të mos ndodhur rrudhja e territorit, personalisht mendoj që Qeveria duhet t’i ndërmarrë këto veprime që shpesh janë thirr nga Lëvizja Vetëvendosje:

1. Duhet t’i ndalojë menjëherë negociatat me Serbinë,
2. Duhet që përmes mekanizmave të sigurisë të përcaktuara me Kushtetutë të shtrijë sovranitetin edhe në pjesën veriore të Mitrovicës,

3. Të funksionalizohen të gjitha institucionet kushtetuese dhe të veprojnë në pajtim me Kushtetutën dhe,
4. Të arrestohen të gjithë kriminelët e strukturave ilegale të Serbisë.

Jam jashtëzakonisht i bindur se veprimet e lartcekura nuk mund t'i ndërmerr kjo Qeveri, sepse logjika e veprimeve të kësaj Qeverie ka tjetër dimension, ka dimension të krijimit dhe zbatimit të politikave nënshtruese ndaj faktorit ndërkombëtar që do të thotë se imiton ato vende që ishin nën protektorat ndërkombëtar e jo imitim i vendeve perëndimore siç thonë disa pushtetarë.

Prandaj, kjo Qeveri nuk mund të përdorë mekanizmat e sigurisë të përcaktuar me Kushtetutë për të vënë nën kontroll territorin e shtetit të Kosovës, duke bërë shkelje flagrante të Kushtetutës me mosveprimin e saj.

Kësisoj shtrirja e kushtetutshmërisë, ligjshmërisë dhe rendit juridik në pjesën veriore të Mitrovicës nuk mund të bëhet me këtë Qeveri, prandaj kjo Qeveri duhet të jap dorëheqje për t'i lënë vend krijimit të një Qeverie tjetër që do të mund të shtrinte kushtetutshmërinë në tërë territorin e Kosovës.

(Afrim Hoti, d.v.)

KRYETARI: Faleminderit! Edhe një herë po ju them se 42 deputetë kanë mbet në sallë. Janë edhe 7 deputetë të lajmëruar. Tash mbetën edhe 6! Nëse vazhdojmë, do të vazhdojmë me kohën për diskutim prej 5 minutash. Pra, po e shkurtojmë pak, se janë shumë 10 minuta.

A jeni dakord, apo po e përmbysim krejt. Shefi juaj, Adem Grabovci, po thotë me e përmbysim krejt.

Atëherë, po shkojmë me rend dhe kush e do fjalën? Fjalën e ka deputeti Adem Grabovci, se desha me ia dhënë fjalën Ganimetes!

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Unë i falënderoj të gjithë kolegët deputetë për kontributin dhe konstruktivitetin e tyre, të treguar me qasjen shumë serioze për një problem tepër serioz që po debatojmë, jo vetëm në këtë seancë por edhe në seanca me radhë.

Ne kemi bërë përpjekje edhe kur ka bë kërkesë Grupi Parlamentar i Vetëvendosjes dhe e ka pas mbështetjen edhe të grupeve të pozitës. Vetëm kemi kërkuar që Grupi Parlamentar, kur të thërret seancën, t'i respektojë procedurat, sepse tregon një respektim, një kulturë institucionale, respekton institucionet e vendit. Në të kundërtën, tregon mosrespekt të vetë institucioneve dhe para se gjithash të këtij institucioni i cili është institucioni më i lartë vendimmarrës.

Në mungesë dhe pamundësi që opozita të thërret seancën, ne kemi dashur që të dëshmojmë gatishmërinë tonë. Kemi pasur besimin në institucionin tonë ekzekutiv – Qeverinë e vendit, se është e gatshme në çdo kohë e në çdo moment të vjen, të debatojmë dhe t'i shprehim shqetësimet tona që e preokupojnë qytetarin e vendit.

Është e pafalshme, e pamoralshme që tragjeditë e familjeve tona, pa marrë parasysh se ku ndodhin në territorin e Kosovës të tentohet të keqpërdoren për vota politike.

Partia Demokratike e Kosovës dhe grupet parlamentare, me të cilat kemi pasur bashkëpunim, i kemi ikur kësaj tentative. Përkundrazi, kemi shprehur gatishmërinë tonë që të diskutojmë dhe të nxjerrim konkludime më të mira, më të drejta dhe që çojnë drejt stabilizimit të gjendjes dhe zgjidhjes së problemit për veriun e Mitrovicës.

Nuk i lejojmë vetvetes, dhe kërkojmë edhe prej të tjerëve – mos të bëjmë përpjekje ta gjejmë fajtorin aty ku s'është. Kërkojmë nga institucionet tona vendore, nga Qeveria e vendit që të veprojnë në përputhje me kompetencat dhe fushëveprimin që e ka. Duhet ta kemi të qartë dhe të kemi guxim të kërkojmë nga institucionet tjera ndërkombëtare të kryejnë dhe përmbushin obligimet e veta, ta përmbushin mandatin e vet për çka janë të thirrura.

Institucionet e vendit dhe ne si deputet kemi për obligim, të gjithë, pa përjashtim sepse jemi përfaqësues të qytetarëve të vendit, të krijojmë kontakte dhe klimë të përshtatshme, që edhe në veri të vendit të fillojnë të veprojnë institucionet e vendit dhe të shtrihet sovraniteti i Kosovës. Atje të kemi ligjshmëri, të kemi kushtetutshmëri dhe të kemi lëvizje të lirë e të sigurt për qytetarët.

Dëshmia më e mirë për këtë është se në pjesët tjera të Kosovës, ku jetojnë minoriteti serb dhe minoritetet tjera, e kemi një jetë të përbashkët. Si shembull le të na shërbejë të gjithëve dhe të gjithë, pa përjashtim, të japim kontributin tonë që edhe në atë pjesë të territorit të ndodhë e njëjta gjë.

Prandaj, unë edhe një herë shpreh zhgënjimin dhe keqardhjen për mosseriozitetin e opozitës, që është dëshmia më e mirë se nuk i ka shqetësuar gjendja e krijuar dhe humbja e jetës së njerëzve, por qëllimi ka qenë përfitimi politik, që prapë po e quaj, është e pamoralshme, është e papërgjegjshme që një gjë e tillë të keqpërdoret për të fituar poenë politike.

Unë, edhe një herë, i falënderoj të gjithë kolegët! Falënderoj Qeverinë që i është përgjigjur kërkesës sonë, për kontributin që e dhanë dhe gatishmërinë, pa përjashtim, të gjithë ministrat që kontribuan në këtë debat.

Kisha propozuar tash që debati të përfundojë dhe edhe një herë falënderoj për të gjithë atë që kemi bërë së bashku. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, kryetar i Grupit të Partisë Demokratike, deputet Adem Grabovci. Pra, po të falënderojmë dhe mirë u pafshim nesër, në seancën e ardhës.

E përgatiti:

Njësia për transkriptim e Kuvendit të Kosovës